

KRIZAT E BOTËS MODERNE

sfidat rajonale dhe globale të
demokracisë liberale kundrejt
fundamentalizmit religjioz

KRIZAT E BOTËS MODERNE

sfidat rajonale dhe globale të demokracisë liberale
kundrejt fundamentalizmit religjioz

**Redaktore e botimit:
Doc D-r Ivanka Dodovska**

KRIZAT E BOTËS MODERNE
**sfidat rajonale dhe globale të demokracisë liberale
kundrejt fundamentalizmit religjioz**

Pjesëmarrësit në projekt:

Ivan Ivanov
Stanislav Cvetkovski
Sara Al Bander
Martin Buzallkovski
M-r Ivana Atanasoska
Liljana Llazarevska
Katerina Neshkova
M-r Marjan Vučković
Xhenur Iseni
Doc. D-r Oliver Andonov

Shkup 2014

IMPRESUM

Titulli:

KRIZAT E BOTËS MODERNE
sfidat rajonale dhe globale të demokracisë liberale kundrejt
fundamentalizmit religjioz

Botues:

Fondacioni Konrad Adenauer, përfaqësia në Republikën e Maqedonisë
Instituti ResPublika

Redaktore e botimit:

Doc. D-r Ivanka Dodovska

Pjesëmarrës në këtë projekt:

Ivan Ivanov
Stanislav Cvetkovski
Sara Al Bander
Martin Buzallkovski
M-r Ivana Atanasoska
Liljana Llazarevska
Katerina Neshkova
M-r Marjan Vučković
Xhenur Iseni
Doc. D-r Oliver Andonov

Recensentë:

Prof. D-r Zllate Dimovski
Doc. D-r Lupço Todorovski
Prof. D-r Zoran Ilievski
Prof. D-r Bistra Netkova

Koordinimi:

Davor Pashoski

Përktheu në gjuhën shqipe:

Ismet Bitik

Dizajni dhe shtypi:

Vinsent grafika

Tirazhi: 100

Publikimi mund të shkarkohet gratis në:
www.kas.de/macedonia

Vërejtje:

Qëndrimet e paraqitura në këtë publikim nuk janë qëndrime të Fondacionit Konrad Adenauer, por janë pikëpamje personale të autorëve.

PËRMBAJTJE

Parathënie	7
Hyrje (<i>Dodovska, I.</i>)	10
Roli i shoqërisë civile në botën bashkëkohore – me vështrim të veçantë mbi Republikën e Maqedonisë (<i>Ivanov, I.</i>)	25
Format e shprehjes religjioze nga shekulli i XIX deri në fund të shekullit XXI në Evropën Juglindore (<i>Cvetkovski, S.</i>)	36
Fundamentalizmi islamik – nocioni dhe domethënia (<i>Al Bander, S. dhe Buzallkovski, M.</i>)	45
Multikulturalizmi (disa çështje dhe sfida themelore) (<i>Atanasoska, I.</i>)	58
Modeli i multikulturalizmit në Republikën e Maqedonisë (<i>Lazarevska, L.</i>)	72
Trajtimi mediatik i islamit radikal si kërcënim për sigurinë (<i>Neshkova, K.</i>)	81
Republika e Maqedonisë – roli i bashkësive fetare në ndërtimin e bashkëjetesës në shoqërinë bashkëkohore maqedonase (<i>Vučković, M. dhe Iseni, Xh.</i>)	96
Përfundim (<i>Dodovska, I.</i>)	104
Punim: Analizë e radikalizmit religjioz si mjet i radikalizmit politik- perceptim i nivelit të ndikimit dhe kërcënimi ndaj sigurisë në Republikën e Maqedonisë (<i>Andonov, O. dhe Dodovska, I.</i>)	109
Biografite e pjesëmarrësve në projekt	120

PARATHËNIE

Ideja për ta hulumtuar problematikën lidhur me kërcënimet bashkëkohore ndaj njerëzimit, buroi nga perceptimi se kjo fushë është jashtëzakonisht deficitare në opinionin bashkëkohor akademik maqedonas. Për këto shkaqe, bashkë me ekipin hulumtues nga Instituti për Hulumtime Politikologjike ResPublika dhe Forumi Politikologjik Maqedonas, të formuar në kuadër të Fakultetit Juridik "Justiniani i Parë" në Shkup, si institute që udhëhiqen nga ana e studentëve të mi më të mirë – studentë në studime pasuniversitare dhe magjistra të studimeve politike (Ivan Ivanov, Stanislav Cvetkovski, Sara Al Bander, Martin Buzallkovski, Mr. Ivana Atanasoska, Liljana Llazarevska, Mr. Marjan Vukçeviq dhe Gjenur Iseni) gjatë disa konsultimeve të mbajtura, konstatuam se në Republikën e Maqedonisë, si edhe më gjerë, në Ballkan, madje edhe në mbarë territorin e Evropës, ekziston një mungesë serioze të qëndrimit kritik të cilin publiku akademik duhet ta ndërtojë, lidhur me gjendjet e krizës dhe kërcënimet serioze ndaj njerëzimit.

Në këtë kuptim, kërkimin intelektual e mishëruam me pluralizmin metodologjik dhe vendosëm të iniciojmë një ndërhyrje pioniere në një fushë tejet multidisiplinore e cila në vetvete ngërthen një segment të madh të: studimeve politike dhe të sigurisë njëlojë si edhe nga fusha e drejtësisë, ekonomisë dhe gjithësesi edhe nga praktika, gjithnjë me qëllim që përmes thithjes së potencialit shkencor, tek hulumtuesit e rinj, të krijojmë një projekt të sistematizuar kërkimor – shkencor të perceptuar nga prizmi i gjeneratës së re të politikologëve në Republikën e Maqedonisë, për faktorët e brendshëm por edhe për faktorët e jashtëm, të cilët e gjenerojnë dialogun ndërretnik dhe ndër-religjioz si në nivelin lokal ashtu edhe atë global.

Do të doja të potencojë se ky hap hulumtues nuk do ta kishte domethënien e plotë pa pjesëmarrjen e kolegëve të mi të dashur Katerina Neshkova dhe Doc. Dr. Oliver Andonov, të cilët e plotësuan perceptimin tonë dhe me ndihmën e të cilëve e thelluam dhe njëkohësisht rrënjësisht e zgjeruam debatin akademik, sa u përket kërcënimeve bashkëkohore ndaj njerëzimit.

E gjithë kjo paraqet një bazë të mirë për sfidën me të cilën u ballafaquam që t'i fitojë strukturat e veta të dukshme dhe njëkohësisht të kontribuojë që të mund të konstatojmë se e zgjedhëm periudhën e mirë kohore për fillimin e hulumtimit.

Duke u nisur nga këto argumente, erdhëm në idenë të hartojmë shtatë perceptime akademike për secilën nga temat të cilat i emërtoam në titullin përfundimtar si: "Krizat e botës bashkëkohore – sfidat rajonale dhe globale të demokracisë liberale kundrejt fundamentalizmit religjioz", si dhe një hulumtim në terren me titull: "Radikalizmi religjioz si instrument i radikalizmit politik", analizuar përmes perceptimit të ndikimit mbi formimin e rrezeve dhe kërcënimeve mbi sigurinë e Republikës së Maqedonisë dhe rajonit. Në kuadër të të njëjtit, secila nga temat është aktuale dhe tejet e veçantë, por njëkohësisht që të gjitha së bashku e bëjnë panoramën e hulumtimit tematik jashtëzakonisht të ndërlikuar. Së këtejmi, kolegët e mi hulumtuan dhe shkruan në këto tema: "Roli i shoqërisë civile në botën bashkëkohore – me vështrim të veçantë mbi Republikën e Maqedonisë"; "Forma të shprehjes religjioze nga shekulli i XIX deri në fillimin e shekullit XXI në Evropën Juglindore"; "Fundamentalizmi islam – nocioni dhe domethënia; "Multikulturalizmi (disa çështje dhe sfida themelore)"; "Modeli i multikulturalizmit në Republikën e Maqedonisë"; "Trajtimi mediatik i islamit radikal si kërcënim i sigurisë"; dhe "Republika e Maqedonisë – roli i komuniteteve fetare në ndërtimin e bashkëjetesës në shoqërinë bashkëkohore maqedonase".

Përmes këtij hulumtimi ideja jonë ishte të krijojmë një pasqyrë më të qartë të ballafaqimit aktiv me të kaluarën, duke e pasur parasysh diversitetin etnik, kulturor dhe religjioz në shtetin tonë, përmes së cilit është i mundur ndërtimi i besimit dhe mirëkuptimit më të madh të ndërsjellë midis grupeve të ndryshme. Atëherë, bëhet fjalë për një qasje akademike dhe para së gjithash shkencore të drejtuar kah formimi i qëndrimeve dhe perceptimeve të njerëzve të rinj, e që në mënyrë të drejtpërdrejtë na çon deri te panorama më e madhe me ngjarjet aktuale botërore nga të cilat rezultojnë kërcënimet bashkëkohore ndaj njerëzimit. Njëherësh, me të njëjtin synojmë të

kontribuojmë në drejtim të aktualizimit të shoqërisë maqedonase për rëndësinë e temave të hulumtimit, të nxisim debat publik dhe të kontribuojmë drejtë rritjes dhe intensifikimit të formave të dialogut midis grupeve dhe bashkësive etnike dhe komuniteteve religjioze në Republikën e Maqedonisë, por edhe më gjerë në rajon.

Është me rëndësi të theksohet se ky projekt hasi në mirëkuptim dhe mbështetje nga Fondacioni Konrad Adenauer në Shkup, gjë e cila për tërë ekipin hulumtues ishte stimulim i rëndësishëm, për çka jemi jashtëzakonisht mirënjohës.

Gjithashtu, dëshirojmë ta theksojmë edhe rëndësinë e mbështetjes së pakursyer të cilën e kishim nga recensentët tanë: Prof. D-r Zllate Dimovski, Doc. Dr. Lupço Todorovski, Prof. Dr. Zoran Ilievski dhe Prof. Dr. Bistra Netkova, si dhe sugjerimet e mirëseardhura dhe një sërë diskutimesh aktive të cilat i patëm me Dr. Sinisha Ivanovski, të cilët këtë ndërmarrje akademike e bëjnë jashtëzakonisht të vlefshme, si për të gjithë ne, që me një entuziazëm të lartë u zhytëm në këtë fushë pamjaftueshëm të ndriçuar, ashtu edhe për publikun më të gjerë shkencor dhe profesional.

01.10.2014
Shkup

Doc. Dr. Ivanka Dodovska

Hyrje

*Deus est in omnibus rebus.*¹

"Religjioni hebraik është një pemë e vjetër nga e cila u rritën dy degë të cilat e mbuluan gjithë tokën, dua të them islami dhe krishterimi; apo akoma më mirë, ajo është nëna e cila lindi dy vajza, ndërkaq ato i shkaktuan shumë plagë, meqë midis religjioneve më të afërta mbizotëron armiqësia më e madhe. Megjithatë, sado keq të kenë vepruar vajzat me nënën e tyre, ajo edhe më tej krenohet me atë që i ka lindur; ajo shërbehet edhe me njërën edhe me tjetrën në mënyrë që ta përfshijë gjithë botën, ndërkaq për vetveten, nga ana tjetër, me pleqërinë e ndershme të saj i përfshin të gjitha kohërat".²

*Charles de Secondat,
Baron de la Brède et de Montesquieu
(1689-1755)*

Ne e dimë se që nga antika, njeriu për nga natyra paraqet "qenie njerëzore", përkatësisht qenie shoqërore, e cila natyrën e vet njerëzore mund ta formojë vetëm në bashkësi me njerëz të tjerë.³ Që atëherë, e deri më sot, nga gjithëpërfshirja e bashkësive njerëzore, pikërisht shtetet, ndërkaq më shumë se dy shekuj edhe kombet, e përcaktojnë historinë bashkëkohore botërore. Përmes etapave historike, paralajmëruesin e botës së re e hasim në problemet e lindjes së civilizimit nga periudha e shekullit XV dhe XVI edhe atë nga feudalizmi dhe monarkia absolute, përmes monarkisë kushtetuese, dhe deri në lindjen e shteteve kombëtare dhe të kombeve, substituti i të cilëve deri në ditët e sotme paraqet një fenomen shumështrësor.

¹ Fjalë e urtë latine: *Zoti është në të gjitha gjërat.*

² Montesquieu, *Letrat perse*, Utopia, Beograd, 1994. f. 110.

³ Aristotel, *Popitika*, Zagreb, 1992. f. 3.

Emëruesin e përbashkët të kombit mund ta gjejmë në elementet themelorë, si vijojnë: lidhjen historike, religjionin, kulturën, gjuhën dhe së fundmi nga rajonet, territoret. Gjithsesi, nuk ka një shembull universal në të cilin janë përfaqësuar të gjitha elementet e përmendur më lartë, por ajo që mbetet si fundament, kur flasim për kombin, në çdo rast, përfshin minimum dy nga elementet e numëruara, përkatësisht historinë dhe religjionin. Këta janë veçanërisht të rëndësishëm, sepse nëse merret parasysh se në epokën e zhvillimit intensiv të teknologjive industriale, në kohën e ndryshimeve shoqërore - ekonomike globale dhe në periudhën e lëvizjeve të mëdha gjeopolitike, ata bënë një ndikim të fortë si një nga përfitimet thelbësore të një shoqërie të zhvilluar, që të ndahet shekullarizmi.⁴ Është shumë e qartë se ky përfitim shoqëror, në masë të madhe, në dy shekujt e kaluar ndikoi si në avancimin e të drejtave të njeriut, ashtu edhe në hapjen e mundësive për zhvillimin e të drejtave individuale përmes së cilave u krijuan kushte për përmirësimin e jetës së individëve në shoqëri. Por, gjithashtu, bëhet gjithnjë e më e qartë se këto botëkuptime për kinse "epokën shekullare" në të cilën mbizotëron arsyeja dhe teknologjia, janë gjithnjë e më të paqarta kundrejt tendencës në rritje të konflikteve të reja dhe të shumëllojshme, si dhe lindjes së formave radikale të reja të manifestimit religjioz në të gjitha religjionet e mëdha të botës, përmes të cilave seriozisht janë vënë në pikëpyetje temat shoqërore të cilat e përfshijë bashkëjetesën dhe tolerancën religjioze.

Duke u nisur nga ky këndvështrim, në mënyrë të pashmangshme duhet të pajtohem me faktin se sot, sfidat janë bërë pjesë e pashmangshme të qenies njerëzore. Ato janë kudo rreth nesh, ndërsa ne i pranojmë përmes marrëdhënies agjile gjatë përdorimit të teknologjisë, në zhvillimin e shpejtë të shkencës, në rritjen e pakontrolluar të popullsisë në botë, e cila mbështetet fuqishëm mbi përkatësinë religjioze dhe etnike, pastaj në politikë, në aleanca dhe

⁴ Nacionin "shekularizëm" i pari e ka vu në përdorim filozofi anglez George Jacob Holyoake. Me këtë shprehje është emëruar lëvizja e cila është angazhuar për reduktimin e domethënies së religjioneve në jetën publike, ndarjen e kishës nga shteti, moslejimin e religjionit shtetëror, e as favorizimin e një religjioni në dëm të një religjioni tjetër, si dhe lirinë e mendimit.

më lartë në "shkallën e mundësive" në kërcënimin permanent nga terrorizmi ndërkombëtar. Varen prej tyre dhe përmes tyre në mënyrë rapide ndryshojnë vlerat tona, pikëpamja jonë mbi veten tonë dhe mbi botën rreth nesh dhe të njëjtët na nxisin të jemi kreativ gjatë zgjidhjes së tyre, ta përvetësojmë përsëri dhe përsëri shkathtësinë e përshtatjes dhe të gjejmë ide të reja me të cilat do të mund të ndikojmë mbi të ardhmen e civilizimit tonë.

Për të gjitha këto arsye, është evidente se edhe një herë në teori u dëshmuua se sa është i rëndësishëm hulumtimi i fenomeneve shoqërore, si një sërë faktorësh me përmbajtje politike dhe historike të cilët përfshijnë në vetvete korpusin e ndikimeve religjioze, kulturore, sociale dhe ekonomike dhe të cilët paraqesin bazament të politikave konkrete dhe marrëdhënieve ndërkombëtare.

Nëse pajtohemi me pohimin e Hendlik se "Historia është pastrimi i provave që e kanë mbijetuar të kaluarën", atë që e kemi sot është – lufta e madhe aktuale politike dhe kulturore në nivel global. Frensis Fukujama, qysh në fund të shekullit të kaluar zëshëm thoshte se: "Demokracia liberale mund të jetë pika e fundit e evolucionit ideologjik të njerëzimit dhe forma e saj përfundimtare e pushtetit njerëzor dhe se si e tillë është padyshim përcaktuesi i fundit për fundin e historisë".⁵ Përgjigjen e kësaj hipoteze, pak më vonë, e shpalosi Hantington, i cili foli qartë për "përplasjen e civilizimeve dhe transformimin e rendit botëror".⁶ Analistët rus, nga ana e tyre, i qëndrojnë fuqishëm pohimit se të gjitha luftërat të cilat kanë ndodhur kohëve të fundit në planetë, ndërsa të njëjtat ne i quajmë etnike, janë shkaktuar nga interesi gjeopolitik i super – shteteve ose të fuqive të caktuara.

⁵ Frensis Fukujama, *Fundi i historisë dhe njeriu i fundit*, Kultura, Shkup, 1994. f. 5.

⁶ Semjuel F. Hantington, *Përplasje e civilizimeve dhe transformimi i rendit botëror*, EvroBallkanPress, Shkup, 2010. f. 14.

Në kontekstin e interesimit tonë të hulumtimit, përkatësisht në lidhje me Rajonin e Ballkanit, por edhe më gjerë, ne e kemi krejtësisht të qartë se megjithatë këtu nuk bëhet fjalë për "përplasje midis civilizimeve" por për "përplasje midis blloqeve religjioze, të cilat nga aspekti i tyre ideologjik – politik janë futur thellë në rrënjët civilizuese të kombeve. Gjithashtu, është evidente se mund të flitet për tendencën e vazhdueshme të këtyre shteteve për vendosjen e një bote unipolare në të cilën ata do ta kenë fjalën kryesore, ndërkaq njëkohësisht edhe tendenca për ta penguar tjetrin që këtë ta realizojë përmes ruajtjes së vazhdueshme të multi-polarizmit dhe sidomos në këtë rast në nivel rajonal.

Duke i pasur parasysh të gjitha këto aspekte, nëse e analizojmë periudhën nga fundi i Luftës së Ftohtë e deri më sot, është evidente se shumë intelektual dhe mbikëqyrës e paralajmërojnë sfidën e radhës me të cilën do të ballafaqohet bota perëndimore. Veçanërisht, pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, pas rënies së murit të Berlinit dhe pas shpërbërjes së federatave sociale të Bllokut Lindor, u shfaq koncepti neoliberal i globalizimit, i cili e projektoi unipolarizmin e marrëdhënieve të shpërndara në rendin ndërkombëtar. Ky sistem, i cili për një numër të konsiderueshëm të njerëzve e përfaqësonte përcaktuesin e fundit në historinë e njerëzimit, deri në fundin e shekullit të kaluar u dëshmuua se në të vërtetë bëhet fjalë vetëm për një të vërtetë ose vetëm për një fuqi të madhe. Dhe, përsëri në histori, përmes tronditjeve të reja të cilat pasuan në planin politik, ekonomik, energjetik, ekologjik dhe demografik, civilizimi u gjend në det të hapur dhe të trazuar, në të cilin në mënyrë të tërbuar u shfaqën dilemat e krizës së përgjithshme shoqërore dhe morale. Nga kjo dinamikë e krizës filloi të skicohet dhe të merr formë bota e re multipolare e cila në mënyrë mjaft suptile i paralajmëroi konfiguracionet e reja të rivaliteteve dhe aleancave në planin ndërkombëtar. Edhe pse kjo sfidë në fillim nuk ishte përfshirë në temën aktuale botërore lidhur me të ashtuquajturën Republika Islamike, si bartëse e vizionit mesianik në botën islame për krijimin e rendit të ri botëror, të ashtuquajtur "xhihad islam", megjithatë i njëjti lëvizte në kuadër të rrezikut nga qasja e grupeve militante deri te armët për shkatërrim në masë, gjë e cila në çdo aspekt

paraqet kërcënim global nga i cili askush nuk mund të kalojë pa pasoja serioze.⁷

Marrë në përgjithësi, e gjithë kjo vë në pah se shkalla e lartë e civilizimit teknologjik, njëkohësisht nuk u jep përgjigje një sërë çështjeve që i japin formë idesë për rëndësinë e mirëfilltë të identitetit bashkëkohor të njeriut, si dhe për krizat të cilat e rrezikojnë të njëjtin, kështu që është e rëndësishme të theksohet fakti se pa kritikën reale në drejtim të rishikimit të shkaqeve, të cilat i nxisin këto kriza, është krejtësisht e palogjikshme të injorohen mundësitë e sprovave të paparashikueshme të cilat rezultojnë nga pakujdesia e këtyllë.

Për këto shkaqe, sa i përket aktualitetit, është evidente se islami edhe më tutje mbetet sfida më e madhe për civilizimin kontemporan evropian, por edhe për atë botëror, megjithatë kur bëhet fjalë për këtë doktrinë religjioze mendojmë vetëm për atë islam i cili bën pjesë brenda kuadrit të projekteve politike – ideologjike, të cilat mbështeten mbi ideologjinë rrënuese të panislamizmit. Me sa duket, është i pamohueshëm fakti se spektri i ndërthurjeve komplekse të marrëdhënieve midis Perëndimit dhe Islamit, është njëra nga sfidat më të mëdha të shekullit XXI. Megjithatë, nëse e parashtrijmë pyetjen: Si erdhi deri te kjo? – gjithsesi se do të vijmë deri në përgjigjen përfundimtare sipas së cilës: ky fenomen religjioz – politik, para së gjithash, është rezultat i zhdukjes së botës bipolare në të cilën i njëjti u përfshi në ndarjen e re ideologjike të botës, apo siç do të konstatojë Bzhezinski në “klimën filozofike e cila doli nga kontrolli”.⁸

Megjithatë, edhe pse të gjithë nuk pajtohen me tezën e tij, është e pashmangshme përshtypja se madje edhe tek skeptikët ekziston dyshimi rreth kohëzgjatjes të këtij “shqetësimi” në rendin global demokratik. Sipas një numri të madh, nëse e marrim për autentike

⁷ Odri Kurt Kronin, Xhejms M. Luds. *Sulm i terrorizmit, elemente të strategjisë grandioze*, NAMPRES, Shkup, 2009. f. 3.

⁸ Zbigniew Brzezinski, *Out of Control: Global Turmoil on the Eve of the 21st Century*. Collier Books. 1993.

tezën themelore të Fukujama për konsumin e alternativave të qëndrueshme të sistemit të liberalizmit oksidental, ata seriozisht e vënë në pah atë se supremacia e demokracisë në përgjithësi do të mund ta rrezikonte ndonjë ideologji me aspirata universale e cila do të ishte e aftë ta fitojë pushtetin në ndonjë shtet të fuqishëm ekonomik ose ushtarak. Nga aspekti praktik, sot, është e pashmangshme se këtë tezë e gjejmë tek ideologjia neo-islamike – përmes aspiratave të manifestuara të saj universale. Së këtejmi, konsideroj se interesimi për islamin dhe për raportin e islamit ndaj demokracisë është teza themelore mbi të cilën do të zhvillohet aktiviteti teorik dhe praktik i epokës sonë.

Nga ana tjetër, është krejtësisht e qartë se për njerëzit, të cilët vijnë nga korpusi i traditës judeo – krishtere, ideja për konfliktin ushtarak si instrument i religjionit nuk duhet të paraqes kurrfarë befasie. Nëse i hedhim një sy Dhiatës së Vjetër do të gjejmë përplot konflikte të përgjakshme të cilat rezultojnë nga natyra religjioze dogmatike. Në majë të piramidës në të vërtetë qëndron postulati që më vonë bëhet i njohur si “michemet mitzvah” ose Lufta e Shenjtë (kjo e nënkupton luftën deri në shfarosje, në kuptimin e plotë të fjalës!). Nga aspekti historik është konfirmuar se dimensionin e ri “michemet mitzvah” është shfaqur kur në tutelën e Perandorit Konstantin, krishterimi u bë religjion zyrtar shtetëror në Perandorinë Romake. Gjithashtu, e kemi të njohur se duke filluar nga Edikti për tolerancë fetare nga Milano në vitin 313 të epokës së re në Perandorinë Romake filloi epoka e re e transformimit të plotë shoqëror – politik dhe kulturor, në të cilën është bërë logjike ajo që ka qenë e domosdoshme, ndërkaq e njëjta është mishëruar në konceptin se detyrë e Zotit është që barbarizmi të konvertohet “me të mirë ose me të keq” brenda kuadrit të mirëfilltë laik dhe fetar të ekumenisë krishtere. Në epokat e ardhshme këto qëndrime kanë marrë forma të reja, me ç’rast kulmin e tyre e arritën në kohën e Luftërave Kryqtare.⁹

⁹ Për Luftërat Kryqtare ekziston një bibliografi dhe burime jashtëzakonisht të mëdha, por këtu e potencoj librin e Thomas Asbridge, *The Crusades, The Authoritative history of the War for the Holy Land*, HarperCollinsPublisher, New York, 2010.

Duke shkruar për pasojat e shkatërrimit të Mbretërisë Perëndimore Romake, Kanegan, në mënyrë eksplicite e thotë këtë, si vijon:

“Zhdukja dramatike e Perandorisë Romake në Perëndim la një boshllëk të madh: shtëpia politike në të cilën me shekuj jetuan miliona njerëz tanimë nuk ekzistonte. Në fund, ajo nuk ishte e aftë ta mbijetojë presionin e dyfishtë, nga njëra anë nga popujt gjerman në Perëndim dhe nga ana tjetër, nga arabët në Jug, fillimisht Pars Occidentis, me Romën ra para fiseve të cilat kishin ardhur nga prapa vijës Rajn – Danubit, ndërsa pastaj një pjesë e madhe nga Pars Orientis, Bizanti – “Roma e Re”, ra nën islam. Nga stuhitë e tmerrshme të shekullit të pestë deri në shekullin e shtatë, lindën tri bota, tri pasardhëse të antikës klasike. Bota greke në Bizant ishte e drejtpërdrejtë, megjithatë në masë të madhe një vazhdim i reduktuar i Perandorisë Romake në Lindje, i drejtuar nga perandori romak dhe duke jetuar sipas të drejtës romake. Bota Latine ka jetuar nën sundimin e mbretërve gjerman, të cilët e përqafuan religjionin romak, megjithatë pak nga kultura dhe akoma më pak nga e drejta. Bota arabe e Islamit, që shtrihet nga Azia përmes Afrikës Veriore deri në Spanjë, nuk kishte trashëguar shumë nga e drejta, e aq më pak nga religjioni i antikës, por një pjesë të madhe nga filozofia antike.¹⁰

Kjo ndarje midis Kishës Krishtere Perëndimore dhe Lindore, në vitin 1054, nga njëra anë e përcaktoi fundin e unitetit në Kishën e Krishtit dhe njëkohësisht, nga ana tjetër, filloi procesi i drejtimeve të reja ideologjike dhe kulturore të cilat në fazat e ardhshme historike do ta krijojnë karakterin e dyfishtë ideologjik në nënqiellin gjeopolitik evropian. Në këtë kuptim, karakteri religjioz i konflikteve të cilat pasuan në epokat e ardhshme e dëshmojnë përshtypjen e pakontestueshme se ideja e Luftës së Shenjtë tek krishterët ka qenë fuqishëm e shprehur dhe të njëjtën e hasim thua se në të gjitha konfliktet lokale ose masive deri në fillimin e Luftës së Parë Botërore.

¹⁰ R. C. van Caenegem, *An historical introduction to western constitutional law*, Cambridge University Press, 1995, f. 34.

Sipas Kreveld: “Në rrafshin deklarativ, lufta religjioze ka mbetur forma më e rëndësishme e luftës në Evropë, madje edhe pas fillimit të epokës së hershme bashkëkohore”.¹¹ Ai, më tej potencon se: “Duke filluar nga Traktati i Vestfalisë, përkatësisht traktati i parë në të cilin është anashkaluar Zoti, njerëzit e Perëndimit, në pjesën më të madhe, e braktisën religjionin, në favor të më shumë shkaqeve iluministe për therjen e ndërsjellë. “Megjithatë, konsideron ai: “në pjesën e botës, kushtuar islamit, e njëjta ka ndodhur shumë më vonë, madje edhe atëherë në një vëllim shumë më të kufizuar.”¹²

Së këtejmi, për ne është krejtësisht e qartë se islami ka më shumë domethënie. Kur flasim për islam, para së gjithash, mendojmë për një sistem të besimeve, riteve religjioze, ideologji, dogma dhe koncepte në kuadrin e religjioneve monoteiste në botë. Sa i përket domethënies tjetër, me nocionin islam e nënkuptojmë civilizimin e krijuar nën ombrellën e këtij religjioni. Me kredon “Kënaqu me pak!” – u krijua botëkuptimi mysliman, i cili nga islami krijoi një bazament që i ka përvetësuar të gjitha shtresat shoqërore, meqë në dimensionin e tij moral ka dhënë këshilla që gjatë jetës të kënaqemi me maturi, megjithatë duke mos iu kundërvënë natyrës dhe duke mos iu referuar asketizmit dhe privimit.¹³ Duke e marrë gjithë këtë në konsideratë, nëse bëjmë një komparacion me kontekstin bashkëkohor dhe domethënien e religjionit islam sot, është e evidente se në konceptin bashkëkohor perëndimor islam, interpretimi i Kuranit, thërret në kthim tek burimi, përkatësisht tek domethënia burimore e islamit dhe tek mënyra e jetesës, e cila ka qenë autentike me atë që është krijuar nga Profeti Muhamed. Kjo kërkesë për bashkim shpirtëror, përkatësisht për bashkim ekleziastik dhe material në kuadër të besimtarëve të komunitetit islamikë mbi-kombëtar i krijoi nocionet e reja terminologjike të njohura si: neo-islamizëm, revivalizëm dhe fundamentalizëm, në të cilat u instaluan disa koncepte të reja të cilat burimisht, në esencën e tyre, nuk i

¹¹ Martin Vam Kreveld, *Transformimi i luftës, interpretimi i sërishëm më radikal i konfliktit të armatosur në Klausevic*, Tabernakul, Shkup, 2009. f. 140.

¹² Ibid.

¹³ Popovska Biljana, *Historia e së drejtës*, pjesa e dytë, “2 Gusht Shtip”, Shkup, 2007. f. 84.

njuh as Kurani, e as burimet e tjera të së drejtës islame (e drejta e Sheriatit).

Teoriticientët të cilët merren me këtë fushë, kanë dyshime dhe mospajtime të mëdha rreth karakterit dhe fuqisë së kësaj dukurie të re të shekullit të ri në kuadër të botës islame. Të njëjtit japin parashikime krejtësisht të ndryshme në lidhje me shkallën e rrezikut të kësaj qasjeje të re të interpretimit të Kuranit dhe ajo që rezulton nga e njëjta ose më konkretisht për të ashtuquajturin "kërcënim islamik".¹⁴

Ajo që jashtëzakonisht na lidh në këtë debat ka të bëjë me faktin se në çdo rast kjo qasje e re, të cilën e kanalizojmë si "fundamentalizëm islamik" ose si "neoislamizëm" është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me demokracinë liberale.¹⁵

Duke dashur që ta krijojmë kartën e boshtit kryesor, rreth të cilës lëvizë ky botëkuptim i ri, është i domosdoshëm zbatimi i metodës historike përmes së cilës do të përpiqemi ta përcaktojmë kufirin në të cilin me të vërtetë puqet demokracia liberale dhe islami. Në këtë drejtim, nëse e marrim parasysh se demokracia e presupozon lirinë dhe barazinë e qytetarëve dhe se e njëjta e shpreh subjektivitetin e plotë politik, lirinë e të menduarit, diversitetin e grupeve politike, ndarjen e religjionit nga shteti, si dhe një sërë të të drejtave grupore dhe individuale, të cilat bëjnë pjesë në spektrin e parimeve ekonomike, politike dhe kulturore, në këtë rast do ta kemi fare të qartë pse është nderur alarmi i dritës së kuqe ndaj fundamentalizmit islam në rritje dhe ndaj krijimit të botëkuptimit perëndimor, i cili ndërton një pasqyrë stereotipe për islamin dhe për myslimanët në përgjithësi si "rrezik nga fundamentalistët militantë".¹⁶

Gjithashtu, nëse i marrim parasysh parakushtet themelore për pozitën e shtetit në shoqërinë globale, me strukturë qytetare, përkatësisht pluralizmin politik, ndarjen e pushtetit dhe pavarësinë

¹⁴ Berman Pol, *Terrori dhe liberalizmi*, EvroBallkan press, Shkup, 2005. f. 125.

¹⁵ Bernard Lewis, *A Historical Overview*, Journal of Democracy, April 1996. f. 54.

¹⁶ Amstrong, Kerin, *Beteja për zotin*, EvroBallkan press, Shkup, 2008. f. 495.

e shoqërisë civile dhe nëse e konfirmojmë se botëkuptimi liberal në mënyrë të theksuar mbështetet mbi individin dhe pronën e tij të garantuar private, si dhe mbi liritë dhe të drejtat e garantuara në fushën politike, atëherë është fare e qartë se shteti bashkëkohor është shtet juridik, i cili është krijuar si rezultat i revolucioneve qytetare në shekullin e XVIII dhe XIX dhe i cili edhe sot e kësaj dite mbindërtohet në mënyrë të vazhdueshme. Për këto shkaqe, në thelbin e konceptit bashkëkohor të shtetit juridik, njeriu, si individ dhe vlerë për vetveten, gjendet në fokusin e shtetit. Universalizmi i vlerave demokratike, e nënkupton angazhimin themelor të konceptit perëndimor. Perëndimi pret se në këtë kuadër do të përfshihen të gjithë. Në këtë totalitet, megjithatë nuk ia dalin të përfshihen në këtë kuadër disa shtete të caktuara, siç është shembulli me Arabinë Saudite, Sirinë dhe me shtete të tjera të Arabisë, në të cilat mbisundon koncepti i sovranitetit të kufizuar. Është evidente se për dallim nga koncepti demokratik për liri dhe barazi të qytetarëve, pa marrë parasysh se për cilën shkollë ose botëkuptim islam bëhet fjalë nuk mund të parashikohet se secili prej tyre në mënyrë eksplicite e vë në pah universalen dhe vendin qendror të islamit në jetën e myslimanëve, meqë burimet e të drejtës islame i rregullojnë në mënyrë të përgjithshme edhe çështjet fetare dhe ato laike. Dhe, akoma më e rëndësishme, në islam dhe në gjuhën arabe, është e panjohur ideja e qytetarisë si subjekt aktiv në një proces politik. Së këtejmi, dallimi është i plotë nëse merret parasysh se në pjesën më të madhe të botës islame nuk ekziston praktika e cila e nënkupton idenë e barazisë së të gjithë qytetarëve para ligjeve dhe as të drejtat politike individuale, ndërkaq të mos flasim fare për vet qytetërimin si vlerë e sovranitetit popullor. Nga tërësia e dallimeve të cilat janë evidente gjithsesi se është edhe lidhja e fuqishme brenda islamit midis pushtetit laik dhe fetar.

"Atëherë, politika reale e "sugjeron" modifikimin e metodave në proceset politike të demokratizimit të shteteve nga bota jo-perëndimore; megjithatë humbja e sovranitetit shtetëror edhe në përmasa më të vogla nuk është demokratizim dhe demokraci, por do të thotë skllavërim modern dhe një lloj i veçantë i skllavërisë.

Mungesa e tolerancës në proceset demokratike globale është një mungesë esenciale e demokracisë; moskuptimi dhe mosrespektimi i traditave dhe kushteve shoqërore të karakteristikave "lokale" është shkak i konflikteve, të cilat në të shumtën e rasteve kanë pasojë tragjike; me fjalë të tjera, bota islame dhe shumë bota të tjera, për çdo ditë dëshmojnë se aktualisht nuk duan më shumë demokraci nga ajo që e kanë."¹⁷

Nëse këtë e shohim me një dioptri më të vogël, padyshim se Ballkani paraqet një kulturë kufitare, në të cilën në masë të madhe janë ndërthurur karakteristikat gjeografike, historike dhe tradicionale dhe me të njëjtat ai paraqet një urë midis Lindjes dhe Perëndimit, midis krishterimit dhe islamit, midis Evropës dhe Azisë dhe në fund të fundit midis intuicionit dhe racios. "Ekspozimi i shteteve të Gadishullit Ballkanik ndaj gjyqit të korrektësisë së re ideologjike të liberalizmit, na e dëshmoi se ky koncept ideologjik arrin që ta sanksionojë mosrespektimin e modelit të multikulturalizmit të Ballkanit. Ose, me fjalë të tjera, përballemi me një amalgam ballkanik të lënë në trysinë e nacionales dhe formave të imponuara politike të multikulturalizmit."¹⁸

Në bazë ë kësaj, do ta theksoja atë se duhet të jemi të kujdesshëm me faktin se në themelin e kombeve të Ballkanit është religjioni si strumbullar dhe si bazë mbi të cilën janë përkufizuar elementet etnike prej të cilave rilindën kombet ballkanike. Marrë në përgjithësi, përkatësia etnike është ngushtë e lidhur me përkatësinë religjioze. Së këtejmi, vlerësoj se është jashtëzakonisht i rëndësishëm konkluzioni i Hantington-it në të cilin ai në mënyrë eksplicite është prononcuar se: "dimensioni kryesor dhe më i rrezikshëm i politikës së re globale që po lind do të jetë konflikti midis grupeve të civilizimeve të ndryshme" ose me fjalë të tjera, konflikti midis doktrinave të ndryshme religjioze - dogmatike.

¹⁷ Ruçnov, Drago, *Gjendja aktuale dhe perspektiva e demokracisë*, Arkivi i Shkencave Juridike dhe Shoqërore, 4, Beograd, 2003. f. 404.

¹⁸ Stojanov, Marjan, *Multikulturalizmi si model i komunikimit kulturor në shoqërinë bashkëkohore maqedonase*, IV-AN Print, Shkup, 2009. f. 31.

Në këtë kontekst, Republika e Maqedonisë është një shtet në të cilin bashkëjetojnë kultura dhe komunitete fetare të ndryshme. Pas shpërbërjes së ish-RSFJ-së dhe pas formimit të shtetit bashkëkohor maqedonas, sistemi juridik dhe politik i saj u ballafaqua me vështirësitë e tranzicionit të cilat i shkaktoi ndryshimi i sistemit shoqëror – ekonomik, lufta për identitet dhe njohjen e shtetit, kontestimi i emrit kushtetues të Republikës së Maqedonisë nga ana e fqinjët jugor, Republikës së Greqisë, numri i madh i refugjatëve nga Bosnja e Hercegovina dhe nga Kosova, si dhe konflikti i vazhdueshëm etno – politik midis maqedonasve dhe shqiptarëve i cili u përshkallëzua në një konflikt të dhunshëm të armatosur në vitin 2001.¹⁹

Të gjitha këto sfidat kontribuuan që në njëzetë vitet e kaluara të hapen çështjet të cilat bëhen tema kryesore dhe sfida të cilat përmbajnë rreziqe dhe kërcënime mbi zhvillimin e shoqërisë maqedonase, ndërkaq ne i evidentuam në disa pika, edhe atë:
1. Roli i faktorëve ekonomikë dhe politikë;
2. Roli i religjionit në shoqërinë maqedonase;
3. Mobilizimi etnik;
4. Ndikimi i mediave;
5. Rëndësia e identitetit kombëtar dhe etnik dhe
6. Roli dhe ndikimi i proceseve të globalizimit.

Këto parametra, në masë të madhe, ndikojnë mbi shoqërinë bashkëkohore maqedonase dhe njëkohësisht janë një tregues serioz për fazat e ardhshme zhvillimore të cilat e kushtëzojnë procesin e stabilitetit, sigurisë dhe integritetit të Republikës së Maqedonisë në nivel rajonal dhe global. Kjo, veçanërisht, nëse e marrim parasysh prezencën e traditave kulturore dhe religjioneve të ndryshme, të cilat ekzistojnë në hapësirën maqedonase dhe të cilat ndikojnë mbi vitalitetin e saj, stabilitetin dhe në përgjithësi mbi ekzistencën e saj. Këta faktorë kanë një ndikim të veçantë mbi ndryshimet e posaçme shoqërore – politike në Republikën e Maqedonisë dhe të njëjtat e tangojnë si aktualitetin ashtu edhe ardhmërinë e saj.

¹⁹ Për këtë shih më shumë tek Arsovski M. Kuzev, S. Damjanovski, R. *Lufta në Maqedoni në vitin 2001*, Matica, Shkup, 2006

Në këtë kontekst, konsideroj se përveç angazhimit të përcaktuar me Marrëveshjen Kornizë të Ohrit nga viti 2001 me të cilën shteti maqedonas u përcaktua për konceptin e shtetit multikulturor qytetar, në thelbin e vet edhe më tutje mbetet korpusi i ndikimeve religjioze të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikojnë mbi etnizimin dhe japin indikacione të disa aspekteve të instrumentalizimit të komuniteteve fetare të cilat është e mundur të kenë ndikim mbi stagnimin e shoqërisë bashkëkohore maqedonase. Për këto shkaqe, nëse merret parasysh se në komunitetet fetare në Republikën e Maqedonisë mbisundon prezenca e kriterit etnik, me çka të njëjtat i nënshtrohen gërshetimit të faktorëve të jashtëm të ndikimit të cilët në të vërtetë i keqpërdorin ritualet religjioze dhe i shndërrojnë në matrica të huaja ideologjike anti-perëndimore. Ky aspekt domosdoshmërisht nuk do të thotë të bëhet funksional, megjithatë njëherësh në asnjë rast, nuk guxon të neglizhohet, meqë mbi të njëjtin ndikon si konfiguracioni gjeopolitik i hapësirës ashtu edhe ekonomia, politika dhe arsimit të cilët njëkohësisht e japin edhe përgjigjen që ka të bëjë me parandalimin dhe luftimin e sfidave të cilat i bartin me vete krizat e botës moderne.

Doc. Dr. Ivanka Dodovska

*Religjioni nga njerëzit e thjeshtë konsiderohet si i vërtetë,
nga të mençurit si gënjeshtër,
ndërsa sundimtarët e konsiderojnë si të dobishëm.*

Seneka

*Nëse fillojmë një grindje midis të kaluarës dhe të tashmes,
do të vërejmë se e kemi humbur të ardhmen.*

Winston Çerçil

Ivan Ivanov
Instituti ResPublika

Ivan Ivanov
Institute ResPublika

***Roli i shoqërisë civile në botën bashkëkohore – me
vështrim të veçantë mbi Republikën e Maqedonisë***

***The Role of the Civil Society in the Modern World –
Special Review on the Republic of Macedonia's Case***

Fjalët kryesore: Shoqëria civile, qytetarë, qytetaria, entosi, demosi, demokracia liberale, tranzicioni, etnizimi, të drejtat kolektive, identiteti, religjioni qytetar, OJQ-izimi.

Key words: Civil society, civic virtue, ethnos, demos, liberal democracy, tranzition, "ethnicization", transition, collective rights, identity, "civic religion", NGOisation.

Abstract

At the end of the 20-th century, civil society as a theoretical and as a normative model was used to interpret the transition from the old totalitarian regimes to democracy in Central and Eastern Europe. On a normative level it was an ideal to which the actors who started the transition to democracy strongly tended toward. On an empirical level it was a set of actors, civil initiatives and activities which were meant to create active citizens, who would engage in the changes in social life, which the transition brought. Their main goal was to create strong civil awareness, as the basis for the creation of the so called "demos". Civil society actually represented a school for all of the non-governmental actors, dissidents and civil initiatives which, while winning the public space were also developing the awareness needed to create negative freedom (freedom from), as a predecessor to positive freedom (freedom for).

This paper aims to give a theoretical elaboration to the phenomenon known as civil society and the challenges that it faces through the consolidation of democracy. We put emphasis on "ethnicization" in particular as a threat to liberal democracy. The paper also emphasizes the major debates and specifics of the civil society in Macedonia.

*

Në fund të shekullit XX shoqëria civile paraqiste një paradigmë të re, me të cilën sqarohej, interpretohej dhe në mënyrë normative pasqyrohej kalimi nga regjimet autoritare dhe totalitare në demokraci.

Nga aspekti socio – lingvistik, duke filluar nga Aristoteli e deri në ditët e sotme, shoqëria civile e nënkupton bashkësinë e qytetit, bashkësinë e të lirëve dhe të barabartëve, e cila nuk mbështetet mbi dhunën dhe tiraninë por mbi parimet e së drejtës. Në bazë të parimeve të tij, sipas së cilave njeriu për nga natyra është qenie politike, ndërkaq polisi objektiv i zhvillimit shoqëror të njeriut, shoqëria civile dallohet nga të gjitha shoqëritë e tjera. Hegel-i, këtë e përkufizon si pjesë të jetës etike, hapësirë midis sferës publike dhe private (hapësirë midis familjes dhe shtetit), e cila është përplot me nisma qytetare, interesa, organizata dhe ngjashëm. Duke e ndjekur linjën e Hobs-it, ai, shoqërinë civile e determinon si një fushëbetë të trazuar të interesave parciais dhe partikulare, të cilat përmes pushtetit suprem publik, siç është shteti, mund të tejkalohen.

Shoqëria civile, si vlerë e civilizimit perëndimor, është bazamenti i krijimit të demokracisë. Transformimi për atë se çka do të thotë në realitet ëndrra perëndimore e nënkupton metamorfozën karakteristike e së cilës është limitimi vetëm në civilizimin perëndimor. Ky është nënqielli në të cilin demokracia i lëshon rrënjët e veta dhe e ka për qëllim ta stimulojë individin që nga nënshtetas të bëhet qytetar dhe ta konstitujë demokracinë. Karakteristikat që janë pasqyrë e krijimit të shoqërisë civile thuaja se çdoherë shkojnë paralelisht me konsolidimin e demokracisë liberale. Përkatësisht,

kjo është në funksion që t'i përgatis qytetarët për ta përfaquar demokracinë. Shoqëria civile, para së gjithash, është kategori morale, abstraksion, që mbështetet mbi ndërgjegjen e qytetarëve lidhur me qytetëtarinë, refleksioni i së cilës është që njerëzit të jetojnë në paqe dhe harmoni, të cilat bazohen mbi tolerancën dhe respektin e ndërsjellë, të udhëhequra nga pluralizmi, participimi dhe vullneti i përgjithshëm.

Vullneti i përgjithshëm është normë e shoqërisë civile. Sipas Kant-it, për shoqërinë civile mund të flasim nëse aktivizohet vullneti i përgjithshëm. Sipas rregullit juridik, vullneti i çdo individi duhet të përputhet me rregullat e përgjithshme dhe me ato të jashtme; prandaj ai njëherësh duhet të jetë edhe vullneti i tërësisë, ndërkaq aktivizimi i vullnetit të përbashkët e nënkupton shoqërinë civile.²⁰

Me shfaqjen e shoqërisë civile në shoqëritë autoritare, vjen deri në gjendjen e zgjimit të frymës së lirisë. Shoqëria civile, hipotetikiqsh krijon liri negative ("liri nga"). Liri nga pushteti absolut, totalitar, pushteti i imponuar. Në këtë hapësirë të krijuar të re dhe të përvetësuar vendoset embrioni për krijimin e demokracisë. Në regjime autoritare ata që e zgjojnë frymën e lirisë janë pararendësit dhe "Prometejtë" e shoqërisë civile. Institucionet e sistemit të vjetër, të cilat kanë qenë tepër të burokratizuara, të korruptuara dhe të ideologjizuara kanë qenë një provokim i mjaftueshëm që të ndihmohet zhvillimi i shoqërisë civile, duke menduar se prej tij do të krijohen struktura të reja dhe se forma ekzistuese do të plotësohet me përmbajtje të re. Me këtë, individët do të ndërgjegjësohen sa i përket qytetërimit, ndërkaq institucionet do të plotësohen me kapacitete demokratike.

Gjatë përkufizimit të shoqërisë civile mund të përcaktohen tri strategji të veprimit: (1) Nëse pushteti është jodemokratik, shoqëria civile është opozitë e pushtetit e cila i kundërvihet me konstruktivitet dhe propozime për avancimin e vlerave demokratike;

²⁰ Kant, Reflexion, 1934, f. 1772-75.

(2) Në kushte kur pushteti është demokratik, shoqëria civile është partnere e pushtetit në realizimin e projekteve dhe nismave të përbashkëta me interes për qytetarët; (3) Situatë ekstreme kur pushteti nuk duron kurrfarë ndikimi dhe as që është në përputhje me interesat e qytetarëve, atëherë shoqëria civile organizohet dhe pretendon të bëhet pushtet. (Solidariteti në Poloni, Karta 77 etj.).

Sot, shoqëria civile ballafaqohet me sfida dhe kërcënime të cilat i bart me vete koha e re, globalizimi dhe rastet kur shtetet kombëtare gjithnjë e më shpesh e humbasin kontrollin mbi territoret e tyre nga: partizimi, komercializimi dhe padyshim etnizimi. Duke e analizuar problemin e etnizimit, shoqëria civile në vend që të krijojë qytetarë individë, krijon individë të cilët janë ithtarë të të drejtave kolektive dhe identiteteve grupore. Përballemi me grupe të individëve, të cilët largohen nga qëllimi që të bëhen qytetarë dhe në plan të parë e vendosin lojalitetin ndaj etnosit të tyre. Kjo mund të përkufizohet si lojalitet primordial dhe kthim në gjendjen e "fiseve të reja" (tribalizëm).²¹

Tek lojaliteti primordial, nuk ka qytetari, ose të mirë të përgjithshme, interes të përgjithshëm dhe vullnet të përgjithshëm. Ekzistojnë interesa grupore. Në shoqërinë civile demokratike grupet vazhdimisht ndryshojnë varësisht nga interesat. Sot, ballafaqohemi me interesa të përhershme grupore meqë lidhen me identitetin. Identiteti, në mënyrën e vet, tërësisht e rrënon politikën liberale e cila mbështetet mbi individët. Liritë individuale dhe të drejtat e njeriut zëvendësohen me të drejta kolektive. I gjithë rendi botëror, pas Luftës së Dytë Botërore, në të vërtetë është vendosur mbi të drejtat individuale, meqë të drejtat kolektive ishin baza për të njëjtat.

Të drejtat kolektive janë të drejta të pjesëtarëve të bashkësive.

²¹ "Përkatësisht si etnikume do t'i shënonim grupet e njerëzve të cilët e përjetojnë vetveten si pasardhës të një bashkësie historike dhe kulturore (më së shpeshti e formuluar me nocionin origjinal e përbashkët), të cilët kanë dëshirë ta vazhdojnë atë bashkësi. Me fjalë të tjera etnikumi përcaktohet përmes dy dimensioneve: si bashkësi historike dhe si specifike kulturore". Dominik Sjnaper, *Bashkësia e Qytetarëve - Drejt idesë moderne për kombin*, Silovo, Shkup, 2003, f. 23

Kjo kështu është e përkufizuar edhe në Kushtetutën tonë. Nuk bëhet fjalë për të drejtat e shqiptarëve, turqve, serbëve apo për të drejtat e ndonjë bashkësie tjetër. Ekzistojnë të drejta të pjesëtarëve të bashkësive²² ose, realizim individual i të drejtave kolektive.

Rilindja etnike, e cila gjithnjë e më shumë dominon në dekadat e fundit ndikon mbi etnizimin e shoqërisë civile. Proces ky i cili kërcënohet që demokracinë ta shndërrojë në etnokrati.²³ Jetojmë në një botë në të cilën gjithnjë e më shumë partitë politike, institucionet, mediat mbështeten mbi bazën etnike. E gjithë kjo e shkakton ballafaqimin me paradoksin. Përkatësisht, nga 196 shtete në botë, prej të cilave 193 janë anëtare të Kombeve të Bashkuara, ekzistojnë mbi 6000 gjuhë dhe rreth 8000 grupe etnike. Kur grupet etnike janë të mendimit se shteti nuk mban llogari për të njëjtët, përkatësisht se i përjashton nga procesi i vendimmarrjes, ata i rreken synimit të krijojnë "shtet" të tyre. Presupozimet janë se duke e ndjekur këtë tendencë, në të ardhmen bota mund të përbëhet nga mijëra shtete të reja. Sipas kësaj, procesi i etnizimit të politikës në të vërtetë është një proces i krijimit të embrionit të shteteve të reja. Përmes etnizimit, shoqëria civile përballet me kërcënimin që ta humbas karakterin e vet. Atëherë, kjo do të ishte "shoqëri fisnore", apo ashtu siç e përkufizon këtë Xhon Kin, shoqëri jocijile. Jocijiliteti, jokorrektësia, mungesa e qytetarisë rezultojnë nga neglizhenca e njërës ndaj tjetrit, ndërsa u njëjti manifeston kujdes vetëm ndaj vetvetes. Me këtë rrënohet marrëdhënia bazike, konsensusi, marrëveshja shoqërore apo siç do të thoshte Ruso, momenti kur nga gjendja e natyrshme kalohet në gjendje qytetare, meqë etno - politika si e këtu në të vërtetë është kthim në gjendjen para-politike.

Shoqëria civile, si element kryesor për vitalitetin e demokracisë, sigurisht se nuk mund të jetë e dobishme nëse nuk ekziston konsensus shoqëror, rreth vlerave themelore, me ç'rast do të

²² Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, Amendamenti 8.

²³ Në vend të "demos", në skenë ngjitet "etnos".

harmonizohen interesat konfliktuale individuale dhe grupore. Në të kundërtën, Kit Vittington pohon se shoqëria civile për institucionet demokratike mund të paraqes sa kërcënim po aq edhe mbështetje.²⁴ Këtë çështje e kritikon edhe Xhon Porter, i cili thotë se organizimi i shoqërisë, në bazë të të drejtave dhe kërkesave të cilat burojnë nga përkatësia grupore, është diametralisht në kundërshtim me konceptin e shoqërisë të mbështetur mbi qytetarinë.²⁵

Shoqëritë bashkëkohore të imigracionit, ballafaqohen me kompleksitetin shoqëror përmes politikës së multikulturalizmit. Ndryshimet në Evropën Lindore, në fund të shekullit XX i zgjuan fiset, përkatësisht identitetet e asimiluara. Kështu që në vend që të përfundojnë në multikulturalizëm (inkluzivitet) përfunduan në entonacionalizëm (ekskluzivitet). Nga ky aspekt, paradigma e shoqërisë civile, në disa nga vende të Evropës Lindore, nuk e arriti qëllimin. Nga nënshtetas nuk krijoi qytetarë individë por pasardhës lojalë të bashkësisë së tyre historike dhe kulturore. Multikulturalizmi në formën e vet burimore është përmbledhje e tolerancës dhe respektit ndaj diversiteteve me qëllim që të realizohet jeta e përbashkët, ndërkaq e gjithë kjo në funksion të ndihmës dhe zhvillimit të demokracisë. Me një strukturë të këtyllë të punëve madje edhe pretencioz, multikulturalizmi është bartës i idesë së pluralizmit, pa të cilin nuk ka demokraci. Megjithatë, konfliktualiteti i multikulturalizmit me demokracinë i referohet etnizimit të demokracisë dhe shoqërisë civile, i cili sipas shumë teoricienëve është një nga sfidat më të mëdha me të cilat përballen demokracitë bashkëkohore.

Këto janë kushtet në të cilat pluralizmi i mirëfilltë politik reduktohet dhe transformohet në pluralizëm etnik. Në situatë të këtyllë, marrim pjesë në kthimin e bashkësisë politike në bashkësi para-politike. Këto janë ato situata në të cilat nocioni shumicë dhe pakicë politike

²⁴ Vukasin Pavlovic, *Civilno Drustvo I Demokratija*, 2004, f. 140.

²⁵ John Porter, *The Measure of Canadian Society*, Carleton University Press, Ottawa 1987, f. 128.

(që në demokraci është një raport i ndryshueshëm), transformohen në shumicë dhe pakicë konstante në kontekstin etnik.²⁶

Shoqëria civile padyshim se ka të bëjë edhe me ekzistimin e shekullarizimit. Duke e parafrazuar Karl Shmit, se politika është teologji e shekullarizuar, ndërsa islami është i inkompatibil me shekullarizmin (me përjashtim të vendeve që kanë themeluar republika shekullare), ku në vend të krijimit të shoqërisë civile krijohen kalifate, shoqëria civile ballafaqohet edhe me një sfidë, këto janë çështje të identiteteve dhe besimeve fetare.

Shoqëria civile, si vlerë perëndimore, nuk mund të përkthehet me terminologjinë islame. Nga ana tjetër, qytetaria, që është një përmbajtje latente e shoqërisë civile mundet, megjithatë këto dy terma nuk janë sinonime.²⁷ Religjioni është pjesë e shoqërisë civile dhe i ekspozohet mënyrës së sjelljes në të.

Atë që Ruso e apostrofon në faqet e fundit të Marrëveshjes Shoqërore, ndërkaq ka të bëjë me religjionin, sot mund ta përdorim dhe parafrazojmë dhe ta vëmë në funksion të problemeve, në bazën e të cilave qëndron identiteti: "Religjioni i monitoruar sa i përket shoqërisë, i cili është ose i përgjithshëm ose individual, mund të ndahet në dy lloje: religjioni i njeriut dhe religjioni i qytetarit. I pari pa tempuj, pa altar, pa rite, i kufizuar në adhurimin e çiltër të brendshëm të Zotit të Madhërishëm dhe detyrimeve të përjetshme morale, është feja e pastër dhe e thjeshtë e ungjijve, teizmit të mirëfilltë, ajo që mund të quhet si ligj i natyrshëm hyjnor. Religjioni tjetër, i kodifikuar në një vend, ia jep perënditë e veta, kujdestarët specifikë dhe mbrojtës të tij. Ka dogma të veta, rite të veta, predikimin e tij të jashtëm të fesë, të përcaktuara me ligje; të gjithë të tjerët jashtë popullit që e respekton, për atë janë të pafe, të huaj dhe barabar; detyrimet dhe të drejtat e njerëzve nuk shkojnë më larg altarëve të saj. Të këtylla kanë qenë të gjitha religjionet e

²⁶ Vukasin Pavlovic, *Civilno Drustvo I Demokratija...*, f. 266.

²⁷ John A. Hall *Civil Society , Theory, History, Comparision...* f. 278.

popujve të parë, të cilat mund t'i përkufizojmë si e drejtë qytetare ose hyjnore të ligjeve".²⁸

Duke i pasur parasysh përparësitë dhe mangësitë e dy llojeve të religjioneve, më konkretisht duke u fokusuar në të dytin, religjionin qytetar, Ruso manifeston gjendje shoqërore e cila është sfida me të cilën sot përballen shoqëritë bashkëkohore, kërcënime këto të cilat tanimë ndihen. Duke i theksuar anët e mira, përmes asaj që religjioni qytetar e bashkon adhurimin në perëndi, me dashuri ndaj ligjeve dhe me vendosjen e tokës si objektiv i respektit, Ruso i determinon aspektet negative:

"Por, nga ana tjetër, ai është i keq meqë mbështetet mbi lajthitje dhe gënjeshtër, kështu që i mashtron njerëzit, i bën naiv dhe bestyt dhe besimin e mirëfilltë e shndërron në ceremoni boshe. Përsëri është i keq kur bëhet ekskluziv dhe tiranik, kur popullin e bën të etur për gjak dhe jotolerant duke ia mësyre vetëm vrasjeve dhe masakrimeve dhe duke besuar se bën akt të shenjtë duke e vrarë atë që nuk i njeh perënditë e tij. Kjo e vë popullin në një gjendje të natyrshme në luftë me të gjithë popujt e tjerë, me ç'rast rrezikohet siguria e tij".²⁹

Sipas kësaj mund të shihet se religjioni qytetar ka pësuar humbje nga religjioni i njeriut, meqë nuk ia ka dalë t'i bind njerëzit që të jetojnë në paqe. Nëse e dimë se në bazën e çdo religjioni është pacifizmi, atëherë sot jemi me të vërtetë shumë larg nga arritja e atij qëllimi. Keqpërdorimi i religjioneve çon në konflikt meqë në bazën e vet e ka besimin dhe jo dijen.

Mund të konkludojmë se kur shpirti i individit është i indoktrinuar dhe i ndotur, ndërkaq me këtë është pozicionuar në rolin e objektit, ekziston rreziku i cili qëndron pezull mbi botën në të cilën jetojmë. Fanatikët religjioz trupin e tyre ua dorëzojnë atyre që ua kanë përvetësuar shpirtin. Në këtë mënyrë, nuk paraqesin asgjë më shumë por rrezik dhe kërcënim për shoqëritë të cilat diferencohen gjithnjë e më shumë në bazë fetare dhe të identitetit!

²⁸ Zhan Zhak Ruso: *Marrëveshja shoqërore*, 1762, f. 122.

²⁹ *Ibid*, f. 123.

Paradigma e shoqërisë civile në Maqedoni u shfaq para shpërbërjes së Jugosllavisë. Për fat të keq, ajo asnjëherë nuk u interpretua si paradigmë e re, si pararendës i demokracisë dhe si një perceptim i ri të botës dhe si mënyrë e re e rregullimit të jetës së përbashkët të njerëzve. Për shkak të pasivitetit dhe dembellëkut intelektual të kreatorëve të opinionit publik, edhe sot e kësaj dite, ka konfuzion sa u përket nocioneve dhe kategorive dhe nuk kuptohet deri në fund esenca e paradigmes.

Tek ne, u pranua nocioni shoqëri qytetare, meqë socializmi, si rregullim shoqëror, paraqiste negacion të shoqërisë qytetare. Megjithatë, përmes interpretimeve të Marksit, Engelsit dhe të tjerëve, shoqëria qytetare është prezantuar si sinonim i shoqërisë borgjeze, shoqërisë kapitaliste, e cila nuk është humane por grykëse, egoiste dhe grabitqare. Nocioni shoqëri qytetare nuk duhet të analizohet nga aspekti semantik. Identifikimi i nocioneve shoqëri qytetare dhe shoqëri civile rezultoi me konfuzion terminologjik. Shoqëria civile paraqet bashkësi të qytetarëve të lirë por jo edhe shoqëri qytetare.

Tek ne, ndryshimet u bënë me inerci. Rënia e regjimit në Evropën Lindore, rezultoi me rënien edhe të regjimit tonë socialist. Në sistemin e ri u kalua menjëherë pa u kuptuar paradigma, se ajo themelohet mbi lirinë dhe mbi individualitetin. Individë të lirë që duhet të jenë qytetarët, të cilët duke i ndjekur interesat e tyre do të bashkohen dhe do t'i artikulojnë përmes formimit të grupeve të tyre (partive) brenda institucioneve. Krahas shkëndijave të para dhe vetëdijes për përvetësimin e lirisë (liri nga), me krijimin e partive politike, në mënyrë të thjeshtë, u okupua hapësira publike dhe nuk u krijua një tranzicion autentik ndaj demokracisë në të cilin rol dominues duhej të kishte shoqëria civile si shkollë e demokracisë. Me fjalë të tjera, nga nënshtetas të socializmit të krijojë individë të lirë – qytetarë. Në vend të metamorfozës ndodhi pseudo-morfoza. Forma e vjetër u plotësua me përmbajtjen e vjetër. Shoqëria civile ishte vetëm një valë e cila i nxiti shpresat dhe pritjet e shumë qytetarëve të cilët më vonë, nga funksionimi i demokracisë, manifestuan dëshpërim.

Në Maqedoni, ngjashëm me vendet e tjera post-komuniste, nocioni shoqëri civile reduktohet në masë të madhe dhe i njëjti u referohet vetëm organizatave joqeveritare dhe fondacioneve. Në të vërtetë, koncepti i shoqërisë civile është shumë më i gjerë dhe i nënkupton të gjitha nismat qytetare, lëvizjet qytetare, asociacionet, varësisht nga ajo se nga cili spektër ideologjik perceptohen. Organizatat joqeveritare në këtë mënyrë e monopolizuan hapësirën e shoqërisë civile. Kur organizatat joqeveritare rriten në mënyrë spontane nga nevojat e qytetarëve ato mirëpritën nga qytetarët. Megjithatë, nëse janë të imponuara ato nuk lëshojnë rrënjë. Funksionojnë derisa ka grante dhe donacione. Në këtë mënyrë ballafaqohemi me fenomenin e OJQ-zimit të shoqërisë civile. Donacionet e huaja, mbase duke dashur ta stimulojnë, e shkatërrojnë vitalitetin e shoqërisë civile, nuk i dhanë mundësi të zhvillohet në mënyrë spontane, ashtu siç ka qenë rasti në shoqëritë e tyre, kur ky proces ka zgjatur me dekada dhe shekuj. Organizatat joqeveritare, në mesin e të cilave ka edhe të atilla që meritojnë respekt dhe mirënjohje, kryesisht u shndërruan në konsumatorë të fondacioneve të huaja. Situata kjo e cila krijon klientelizëm në të cilin forcohen interesat e donatorëve dhe jo të qytetarëve.

Po këto organizata deshën menjëherë ta realizojnë të drejtën e lirisë pozitive, pa e realizuar të drejtën e lirisë negative. Liria negative në Maqedoni u realizua në fund të socializmit përmes shtypit rinor dhe studentor dhe përmes debateve publike. Ata përvetësuan një hapësirë në të cilën u paraqitën njerëz me qëndrime të ndryshme. Në vende të tjera këta ishin disidentët, ndërsa tek ne njerëz të cilët kanë qenë të persekutuar nga regjimi socialist, të cilët përmes mediave të reja hapën shumë tabu tema nga e kaluara e jonë.

Së këtëjmi, gjendjet në ish-vendet socialiste kishin të bëjnë edhe me Maqedoninë. Në Maqedoni po ashtu erdhi në shprehje etnizimi i shoqërisë civile, meqë organizatat joqeveritare më së shpeshti formoheshin edhe mbi bazë etnike. Kjo nuk e rrit vetëdijen e qytetarisë dhe vetëdijen e bashkësisë si tërësi. Kjo e vështirëson dialogun publik i cili më vonë u reflektua edhe mbi punën e institucioneve.

Konkluzion

Shoqëria civile paraqiste një paradigmë të re premtuese, e cila ishte në mbështetje të justifikimit të kalimit nga rregullimet autoritare dhe totalitare në demokraci. Pas valëve të para të tranzicionit një pjesë e shteteve të dikurshme autoritare dhe totalitare gjatë procesit të konsolidimit të demokracisë, si model liberal përballëshin me sfidat joliberalë, si rilindja etnike, nacionalizmi ekstrem dhe fundamentalizmi religjioz. Procese këto të cilët në vend që të çojnë në drejtim të inkluzivitetit (përfshirje në kompleksitetin shoqëror), e potencojnë ekskluzivitetin (përrjashtimin).

Në vend që të ndihmojë për krijimin e demos-it përballët me sfidën e etnos-it, i cili në simbiozë me nacionalizmin shpie në etnocentrizëm, i cili e rrënon shoqërinë civile. Në vend të qytetarisë dhe demos-it kemi kthim në drejtim të marrëdhënies primordiale, përkatësisht elemente të gjendjes para-politike. Institucionalizimi dhe burokratizimi i shoqërisë civile (OJQ-vizimi) ia merr fuqinë jetësore, inovativitetin dhe kreativitetin. Tani, për shkak të kësaj, shoqëria civile shpërngulet në hapësirën virtuale (internet) ku përmes rrjeteve sociale e bën virtuale atë që duhet të jetë e pranishme në jetën reale. Energjia reale, e cila ka mobilizuar pakënaqësi, ka afirmuar dhe iniciuar ndryshime, tani pasivizohet dhe virtualizohet. Iniciativat, bashkësitë dhe fushatat e njëjta, janë gjithnjë e më të pranishme në rrjetet sociale. Jemi dëshmitarë të procesit të globalizimit të shoqërisë civile.

Stanisllav Cvetanovski
Instituti ResPublika

Stanislav Cvetkovski
Institute ResPublika

**Format e shprehjes religjioze nga shekulli i XIX deri në
fund të shekullit XXI në Evropën Juglindore**

**Forms of Religious Expressions from the 19th to the
Beginning of the 21st Century in Southeast Europe**

Fjalët kryesore: Perandoria Osmane, Krishterimi, Islami,
Fundamentalizmi Religjioz.

Key words: Ottoman Empire, Christianity, Islam, religiousfundametnalizam

Abstract

Regarding this paper, our interest will be focused on historical-political analyses of the conditions that caused the emergence of radical Islam in South East Europe. Therefore, our attention is aimed towards the status of Non-Muslims in the Ottoman society, by which we will simply explain the circumstances and conditions that covered the period of the XIX and the beginning of XXI century. Concerning the major processes that occurred in the South East Europe after the First and the Second World War, there were numerous war conflicts, territorial divisions, population displacement, formation and disappearance of numerous alliances and state-building. Numerous conflicts which appeared under the influence of extremist ideologies have occurred in this region.

*

Me hyrjen e Osmanlinjve në Evropën Juglindore në të vërtetë ka hyrë ndikimi islamik. Vendosija e Pushtetit Osman në territoret e pushtuara ka shkaktuar ndryshime politike, ekonomike dhe shoqërore, para së

gjithash si rezultat i ligjeve fetare islame. Falë këtyre ligjeve, popullsia myslimane ka gëzuar privilegje (ka paguar tatime më të ulëta, ka pasur mundësi të punojnë në të gjitha institucionet e shtetit, ka pasur mundësi të shërbejë në ushtri dhe ngjashëm), për dallim nga popullsia jo-myslimane, e cila ka pasur të drejta të kufizuara (për shembull, nuk ka mundur të dëshmojë në gjyq, nuk ka guxuar të mbajë armë dhe ngjashëm). Thënë shkurt, perandoria si mbretëri myslimane, i ka trajtuar në mënyrë të pabarabartë myslimanët dhe miletin e nënshtruar – jomysliman. Së këtëjmi, prijësit osmanë i kanë ndarë njerëzit sipas religjionit të tyre dhe jo sipas përkatësisë nacionale.³⁰ Gjithashtu, pas pushtimit të Ballkanit, Perandoria Osmane ka bërë përpjekje të krijojë popullsi myslimane e cila nga aspekti ideologjik do të lidhet me shtetin e Sheriatit. Kjo ka pasur mundësi të ndodhë vetëm përmes zgjerimit të islamit midis popullsisë lokale jomyslimane.

Nga ana e vet, popujt jomysliman në Perandorinë Osmane janë ndarë në: ortodoksë, gregorianë, armenë, katolikë romakë, hebrenj dhe protestantë dhe të njëjtit kanë qenë nën pushtetin e drejtpërdrejtë të udhëheqësve të tyre religjioz. Feja jomyslimane është toleruar, megjithatë jomyslimanët nuk kanë mundur të mbajnë rroba të bukura, për shembull me ngjyrë të gjelbër, e cila është ngjyrë e shenjtë për islamin. Nëse një jomysliman ka kalëruar në kalë në prezencën e myslimanit, atëherë është dashur të zbres nga kali. Kishat e vjetra janë riparuar, por kisha të reja nuk janë ndërtuar dhe të njëjtat nuk kanë guxuar të kenë kambana. Pjesa më e madhe e popullsisë jomyslimane është marrë me blegtori dhe bujqësi, si pjesë e sistemit feudal. Pabarazia shoqërore dhe neglizhenca morale kanë shkuar dorë për dorë me nënshtrimin ekonomik. Vazhdimisht është bërë diskriminim fetar në të gjitha mënyrat e mundshme. Megjithatë, çdo individ e ka pasur mundësinë t'i bashkëngjitet grupit në pushtet, atëherë kur do ta pranonte islamin.

Një opsion tjetër për përfshirjen aktive në shoqërinë osmane nga ana e jomyslimanëve ka qenë haraçi i njohur në gjak, përkatësisht

³⁰ Për këtë shih më shumë tek Gleni, Misa, *Balkan 1804 – 1999: nacionalizam, rat i velike sile*, Beograd, 1999.

devshirme.³¹ Nga shekulli i XIV deri në fillimin e shekullit XIX, nga familjet jomyslimane është marrë një nga katër fëmijët, nga pesë deri në shtatë vjeç, që t'i bashkëngjiten ushtrisë luftarake të Jeniçerëve, ku janë rritur dhe edukuar në ushtarë fanatikë dhe lojalë.

Gjithashtu, me rëndësi është të theksohet se të gjitha përpjekjet për reforma në Perandori, sa i përket kësaj çështjeje, janë shkelur nga rregullimi i tij teokratik. Me deklaratat solemne të disa sulltanëve të njëpasnjëshëm lidhur me reformat, sipas të cilave të krishterëve u njiheshin të drejtat e njëjta, thua se çdoherë kanë pasur efekte të kundërta. Madje edhe vet reformat të cilat kanë rezultuar nga Hatisherifi dhe Hatihumajuni janë zbatuar me vështirësi.³² Sa për ilustrim, do ta theksojmë atë se ndonëse Haatt-i-Sherifi i Gjylhanit, nga viti 1839, e ka deklaruar principin e ruajtjes së ligjeve, që nënkupton rekomandim për kthimin kah rregullat e Kuranit, madje edhe pse me këtë janë inkuorporuar disa lehtësira për miletin, sistemi feudal mbeti plotësisht i paprekur. Si shembull plotësues për këtë që e thamë më lart, është gjithsesi edhe ai i vitit 1856 kur pozita e Perandorisë sërisht ka qenë e dobësuar dhe kur si rezultat i Luftës së Krimesë (1853 – 1856) është lëshuar një akt i ri reformist, me të cilin është përcaktuar organizimi i brendshëm i Perandorisë Osmane – Hatt-i-Huamajun me të cilin, mes tjerash, sulltani ua garanton të drejtat nënshtetasve të krishterë, megjithatë i njëjti përsëri ka mbetur vetëm në letër.³³

Në kushte të këtylla socio-ekonomike konvertimi “vullnetar” në Islam, për një numër të madh të jomyslimanëve, ishte mënyra e vetme e sigurt që t'i shmangen diskriminimit dhe të fitohet statusi i anëtarit me të drejta të plota në shoqëri. Për këto shkaqe, procesi i islamizimit në Ballkan është zhvilluar gjatë gjithë periudhës së sundimit Osman, ndërsa zenitin e vet e arriti në gjysmën e dytë të shekullit XVI. Përmasa më të mëdha ka pasur në territorin e sotëm të Bosnjë dhe Hercegovinën, Shqipërisë, Maqedonisë dhe Bullgarisë.

³¹ Hammer, von Joseph, *Historija turskog /osmanskog/ carstva*, 3 tom, Zagreb, 1979. f. 299.

³² Biljana Popovska, *Historia juridike – shtetërore*, burime, Shkup, 2005. f. 142.

³³ Ibid. f. 144.

Në këtë gjendje anarkie pasoi shpërbërja e Perandorisë Osmane. Procesi i njëjtë vepron në mënyrë të përsheptuar dhe e përfshinë periudhën e fillimit të Revolucionit Xhon Turk në vitin 1908, deri në ndarjen përfundimtare të Perandorisë në vitin 1922.³⁴

Nga këndvështrimi i sotëm, periudha nga shekulli XX dhe fillimi i shekullit XXI, sa i përket territorit të Evropës Juglindore, është e një rëndësie të veçantë. Të njëjtën e karakterizon një sërë konfliktesh ushtarake, ndarje territoriale, shpërngulje të popullsisë, formimi dhe zhdukja e aleancave të numërta si forma shtetërore.

Së këtëjmi, është me rëndësi të theksohet se, pas Luftës së Parë Botërore, në Perandorinë Osmane pasoi e ashtuquajtura Lufta Turke për Pavarësi (1919-1922). Kjo luftë është zhvilluar nga ana e nacionalistëve turq kundër aleatëve nga Lufta e Parë Botërore, të cilët në fund të luftës dhe humbjes së Perandorisë Osmane e kanë okupuar vendin. Në krye të Lëvizjes Kombëtare Turke është pozicionuar Mustafa Kemal Atatürk.³⁵

Megjithatë, këto procese për vendet e Evropës Juglindore nuk e nënkuptonin edhe fundin e periudhës së bujshme të transformimeve. Me fjalë të tjera, në vitin 1918 u formua Mbretëria e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve, e cila shtrihej në territorin e shteteve të sotme: Maqedoni, Bosnje e Hercegovinë, Serbi, Mal të Zi dhe në pjesën më të madhe të Sllovenisë dhe Kroacisë. Gjatë njëmbëdhjetë viteve të para (deri në vitin 1929) ka qenë e njohur si Mbretëria e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve, ndërsa më vonë (deri në vitin 1941) si Mbretëria Jugosllave.³⁶

Pasoi Lufta e Dytë Botërore, e cila u zhvillua midis Fuqive të Boshtit dhe Fuqive Aleate. Shtetet që i takonin Mbretërisë Jugosllave luftuan në anën e Fuqive Aleate njëjtë sikurse edhe Turqia. Lufta zgjati nga viti 1939 deri në vitin 1945 dhe si rezultat i së njëjtës pasoi krijimi

³⁴ Sidovski K., *Lufta italo-turke (1911-1912)dhe raportet e Italisë ndaj Luftës së Parë Ballkanike, Maqedoni në luftërat 1912-1918*, ASHAM, Shkup, 1991, f. 276-278.

³⁵ Për këtë shih më shumë tek: Kinross, P. Atatürk – *The Rebirth of a Nation*, Phoenix, London, 1995.

³⁶ Për këtë shih më shumë tek: Ivo Banac, *Nacionalno pitanje u Jugoslaviji, porijeklo, povijest, politika*, Globus, Zagreb.

i Kombeve të Bashkuara dhe krijimi i botës bipolare, të udhëhequr nga superfuqitë SHBA dhe BRSS, me çka bota hyri në epokën e Luftës së Ftohtë.³⁷

Si rezultat i Luftës Antifashiste, por para së gjithash si rezultat i luftës ideologjike – politike në territorin e Mbretërisë Jugosllave gjatë Luftës së Dytë Botërore, në përfundimin e së njëjtës u formua RDFJ (Republika Demokratike Federative e Jugosllavisë). Ky ndryshim i rendit kushtetues tërthorazi, i mbështetur nga qeveritë perëndimore përmes Marrëveshjes Tito-Shubashiq, do të rezultojë me krijimin e RSFJ. Është e evidente se situatat shoqërore, të cilat mbisundonin në RSFJ dhe mënyra me të cilën zhvilloheshin ngjarjet gjatë shpërbërjes së saj, çuan deri në një zhvillim më të madh të fundamentalizmit religjioz në nënqiellin e Evropës Juglindore, që mund të shihet përmes konflikteve të shumta të përgjakshme, të cilat e përfshinë rajonin, përmes organizatave të ndryshme ekstremiste, si dhe përmes ideologjive të pranishme.³⁸ Në këtë hapësirë të vogël, brenda një periudhe të shkurtër, shpërthyen një sërë konfliktesh të dhunshme, të cilat u shfaqën nën ndikimin e ideologjive ekstremiste por edhe si trashëgimi e konflikteve të pazgjdhura historike të aspektit etnik dhe religjioz në territorin e RSFJ dhe më gjerë të rajon.

Si rezultat i përshkallëzimit të konflikteve erdhi deri te zgjerimi i tyre nga konflikte etnike në religjioze dhe veçanërisht prezenca e vazhdueshme e grupeve ekstremiste islamike dhe kampeve për rekrutim dhe trajnim në Ballkan, përhapja e idesë militante për Xhihadin si dhe aktivitete të tjera.³⁹

Edhe sot e kësaj dite flitet për një sërë terroristësh fundamentalistë dhe islamikë të cilët veprojnë në nënqiellin e Bosnjës, e cila

³⁷ Gaddis, J. L., *The Cold War, A new history*, Penguin Books, London, 2007.

³⁸ "Nocioni fundamentalizëm origjinën e ka nga fjala *fondament*, që do të thotë themel, bazë. Së këtejmi, lëvizja fundamentaliste do të thotë kthim kah parimet themelore, në këtë rast parimet themelore të religjionit, të vërtetat burimore. Ai nënkupton shenjë përmbledhëse për shumë lëvizje të ndryshme, para së gjithash në kuadër të krishterimit, islamit dhe judaizmit, por është i pranishëm edhe në budizëm, hinduizëm dhe në fenë konfuçiane". Knoblauch, H., "Sociologjia religjive" (preveo Ivan Markešić, Demetra, Zagreb, 2004), f. 217.

³⁹ Debeljak, A., *Suvremeni fundamentalizam I sveti rat*, f. 69.

konsiderohet si bazë e këtyre fraksioneve dhe vendi për rekrutimin e boshnjakëve të rinj. Ky mendim mbështetet në disa fakte, si vijojnë:

1. Hetimet e shumta për sulme terroriste në mbarë botën dëshmuar se në të njëjtat kanë marrë pjesë persona të cilët në të kaluarën kanë qëndruar në BeH ose kanë pasur lidhje me persona lokalë, ndërkaq thuaja se për të gjithë, pikë e përbashkët ka qenë aradha *El Muxhahir*;⁴⁰
2. Në BeH u ruajt ideologjia të cilën e sollën dhe e përhapën muxhahedinët – vahabizmin, e cila është e pranishme dhe mjaft e dukshme midis të rinjve;
3. BeH shumë lehtë vjen deri te mjetet për kryerjen e veprave terroriste. Si trashëgimi nga lufta, në BeH është shumë lehtë të arrihet deri te mjetet për prodhimin e mjeteve shpërthyes.

Në mbështetje të ekzistimit të mundësisë për rreziqe terroriste në BeH, flasin edhe vlerësimet ndërkombëtare. Kolman thekson se: "Aktualisht, në Bosnjë ekzistojnë më shumë forma të veprimit terrorist. Para së gjithash, këtu bëjnë pjesë organizatat humanitare, nëpër duart e të cilave qarkullojnë shumë para. Përveç tyre, aty është edhe "garda e vjetër" e muxhahedinëve nga lufta, por edhe garda e re të cilën e përbëjnë njerëz të rinj, të aftë dhe të arsimuar nga aspekti teknik dhe teknologjik. Në mbështetje të ekzistimit të ekzekutuesve të mundshëm të sulmeve terroriste në BeH flasin edhe faktorë të tjerë. Me fjalë të tjera, në Ballkan, i cili çdoherë ka qenë "problematik", ekziston një komunitet i madh mysliman mbi të cilin bëhen ndikime në tentativë që ky komunitet të radikalizohet."⁴¹

Po ashtu, një dukuri tjetër e rrezikshme e rajonit gjithsesi se është edhe nacionalizmi ekstrem grek, duke filluar nga pastrimet masive etnike të maqedonasve nga Maqedonia e Egjeut, politika e saj e

⁴⁰ *The 9/11 Commission Report: Final Report of The National Commission on Terrorist Attack Upon the United States*, New York: W.W. Norton & Co, 2004., i aksesshëm në: <http://www.911commission.gov/report/911Report.pdf>

⁴¹ Potenciali terroriste të BeH, i aksesshëm në: http://www.slobodnaevropa.org/specials/al_kaida/15_teroristicki_potencijali_bih.htm#_ftn138

jashtme ekstreme dhe përjashtuese, veprimi i organizatave të tipit të grupacionit nacionalist paramilitar *Etniki eteria dhe Megali ideja*, dhe deri te trajnimi i ushtrisë bashkëkohore, e cila përfshin gjuhë eksplicite të urrejtjes, sidomos ndaj maqedonasve, turqve dhe shqiptarëve. Këtu është edhe *Agimi i Artë* neonacist dhe fashist, pjesëtarët e së cilit luftuan në luftën në Bosnjë e Hercegovinë në anën e serbëve të Bosnjës.

Në ndërkohë, nuk guxojmë t'i harrojmë edhe komunikatat për prezencën e fraksioneve fundamentaliste në territorin e Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë⁴², për të cilat gjithashtu mund të supozojmë se janë në korrelacion me qelitë fundamentaliste islamike të Bosnjës. E gjithë kjo vë në pah faktin se fundamentalizmi tanimë ka lëshuar rrënjë në Ballkan.

Në këtë kontekst është me rëndësi t'i bëjmë një vështrim edhe luftës në Kosovë, idesë së Shqipërisë së Madhe dhe gjithësisë edhe konfliktit ushtarak në Republikën e Maqedonisë të vitit 2001.

Konsiderohet se përshkallëzimi i procesit konfliktual etno-politik, në konflikt të armatosur në vitin 2001 në Republikën e Maqedonisë, në masë të madhe ishte i sponsorizuar nga ana e Al Kaeda-s.⁴³ Ekzistojnë informata se lideri i Al Kaeda-s, Bin Ladeni ka qëndruar në Shqipërinë veriore vend i cili dihet se ka qenë vend-trajnim për terroristët në luftën kundër serbeve në Kosovë.⁴⁴

Gjatë konfliktit, një numër i madh i popullsisë civile u shpërngul, u rrënuan manastire dhe kisha, u masakruan pjesëtarë të forcave të armatosura maqedonase, ndërsa dihen mirë edhe rastet: "Punëtorët e Mavrovës", "Penda e Likovës" dhe ngjashëm.⁴⁵

⁴² Tanseski, N., *Islami Radikal: Kërcënim real ndaj sigurisë së Ballkanit*, i aksesshëm në: <http://dl.fzf.ukim.edu.mk/index.php/sd/article/view/24/22>

⁴³ Islamski teror u bosni i na Kosmetu, i aksesshëm në <http://www.novinar.de/2007/02/03/islamski-teror-u-bosni-i-na-kosmetu.html>

⁴⁴ Bin Laden linked to Albanian drug gangs, i aksesshëm në: <http://www.independent.co.uk/news/world/europe/bin-laden-linked-to-albanian-drug-gangs-632145.html>

⁴⁵ Arsovski, Kuzev, Damjanovski, *Lufta në Maqedoni në vitin 2001*, Shkup, 2006.

Pas konfliktit të armatosur gjithnjë e më të shpeshta janë komunikatat për prezencën e islamit radikal si në Republikën e Maqedonisë ashtu edhe në rajon.⁴⁶ Në raportin e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Maqedonisë nga viti 2002, janë nënvizuar situatat për prezencën e Al Kaeda-s brenda shtetit dhe për lidhjet midis islamikëve radikalë dhe kësaj organizate. Sipas këtij raporti, ekzistojnë dy njësi islamike të cilat janë aktive në Maqedoninë Veriperëndimore, të cilat përbëhen nga ish-luftëtarë muxhahedinë nga Arabia Saudite, Afganistani, Bosnja, Çeçenia dhe Kosova.⁴⁷

Nëse e shqyrtojmë hulumtimin e Skot Tejlor, i cili duke e hulumtuar rolin e muxhahedinëve, gjatë kohës së luftës në Kosovë, ka konstatuar se: "Luftëtarët muxhahedinë ishin shtylla e njësiteve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dhe ata janë përgjegjësit e vetëm për disa nga pritat më të përgjakshme kundër policisë dhe armatës maqedonase. Njëri nga njësitet e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare, i quajtur "Emri Elezi", të cilin anëtarët e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare e kanë quajtur njësi muxhahedine përfshinë luftëtarë të huaj dhe myslimanë radikalë lokal."⁴⁸ – mund të shihet se në çdo rast, shumica e pohimeve kanë bazë reale për dyshime dhe paralajmërojnë për kujdes.

Këtu është me rëndësi të theksohet se rajoni, sido që të jetë, është më i përshtatshëm për prezencën e vehabistëve. Sipas raporteve, aktivitetet e islamikëve radikalë në rajon krijuan një mosbesim të madh midis maqedonasve etnikë dhe shqiptarëve të rajonit.⁴⁹

⁴⁶ Raid of Wahhabi "Camp" Raises Tensions in Sandzak, i aksesshëm në: <http://www.balkaninsight.com/en/article/raid-on-wahhabi-camp-raises-tensions-in-sandzak>

⁴⁷ Dettmer Jamie, "Al-Qaeda s links in the Balkans." Insight on the News 18, no. 26 (2002), i aksesshëm në: <http://www.questia.com/magazine/1G1-90041160/al-qaeda-s-links-in-the-balkans-macedonian-officials>

⁴⁸ Shay Shaul, *Islamic terror and the Balkans* (New Brunswick, NJ: Transaction Publisher, 2007), f. 114.

⁴⁹ Tanevski N., *Islami radikal: kërcënim real ndaj sigurisë së Ballkanit*, i aksesshëm në: <http://dl.fzf.ukim.edu.mk/index.php/sd/article/view/24/22>

Mendimet e ekspertëve janë unanime rreth qëllimeve kryesore të islamikëve radikalë në Maqedoni dhe të njëjtat mund të determinohen në aktivitetet si vijojnë:

1. Vendosja e bazës për formimin e shoqërisë zyrtare islame;
2. Përhapja e ideologjisë radikale dhe këndvështrimi i tyre ndaj islamit;
3. Ndërtimi i xhamive të reja dhe formimi i medreseve të reja, si bazë për ndikim mbi popullsinë, veçanërisht tek të rinjtë;
4. Përhapja e ndikimit islam midis të rinjve të cilët në të ardhmen do të kishin një rol të rëndësishëm.⁵⁰

Me sa duket, vatra të reja për shpërthimin e synimeve fundamentaliste në Evropën Juglindore janë në numër të madh, ndërkaq ne këtu e përfshimë vetëm sipërfaqen e tyre. Megjithatë, ajo që mbetet si kryesore përfshihet në faktin se prezenca e tyre paraqet kërcënim serioz ndaj sigurisë në rajon, e motivuar nga ngjarjet në botë dhe hovit të madh të lëvizjeve ekstremiste.

⁵⁰ Zafirovski E., "Në BIM zhvillohet betejë midis islamit radikal dhe tradicional", Vreme, 06 korrik, 2005.

Sara Al Bander dhe Martin Buzalkovski
Instituti ResPublika

Sara Al Bander and Martin Buzalkovski
Institute ResPublika

Fundamentalizmi islamik – nocioni dhe domethënia

Islamic Fundamentalism – Definition and Meaning

Fjalët kryesore: fundamentalizmi, fundamentalizmi islam, fundamentalizmi religjioz, xihadi, ideologjia.

Key words: fundamentalism, Islamic fundamentalism, religious fundamentalism, jihad ideology.

Abstract

If we want to understand modern religious conflicts which are happening around the globe, we need to dig deep in to the roots of those conflicts. Fundamentalism is a term which we hear and we use very often when we discuss these types of conflicts. Accepting fundamentalism as a universal phenomenon should be viewed through the prism of a particular society and culture in which it is born and in which it exists. However, what is more important is to understand the conditions in which this term was first born, so we can make a comparison between what it meant then and what it means now. Is fundamentalism inherently totalitarian, does it really seek to remake all aspects of society on religious principles, as some of the oldest western works on this subject suggest? Many scholars and political scientists argue that the negative connotations of the term, such as: extremism, militarism and fanaticism, make it totally unsuitable for analysis, while others oppose this point of view. The subject of Islamic fundamentalism attracted a lot of attention in the West after the Iranian Revolution and continues to do so to this very day. But, is it only a religious phenomenon or are we neglecting its other nature?

*

Nocioni "fundamentalizëm" buron nga fjala latine *fondament*, e cila do të thotë mbi bazë ose mbi themel, diçka mbi të cilën ndërtohet ose ngrihet.⁵¹ Kjo flet se të qenit fundamental do të thotë të qenit në burime, në themelet e një ideje të caktuar. Konform këtij përcaktimi terminologjik, fundamentalizmi islam, në thelbin e vet, shënon kthimin konsekuent në burimet dhe themelet e vërteta religjioze, e që shprehimisht nënkupton mirëkuptimin dhe pranimin e Kuranit. Kurani, si libër i shenjtë i myslimanëve, imponon mirëkuptim dhe ndihmë reciproke midis njerëzve. Për këto shkaqe, "radikalizmi fetar", të cilin shtetet perëndimore e identifikojnë si "radikalizëm islamikë" paraqet një nga llojet më të rrezikshëm të manifestimit të terrorizmit me ç'rast shtetet, në nivel global, i kushtojnë rëndësi mposhtjes së kësaj dukurie duke ndërmarr një sërë aktivitete dhe masash në drejtim të programeve për parandalimin dhe eliminimin e tij".⁵²

Duhet të theksohet se ky nocion njëkohësisht e nënkupton edhe qëndrimin negativ të politikës evropiane ndaj përpjekjeve të botës myslimane të çlirohet nga monitorimi politik, kulturor dhe ekonomik të Perëndimit. Domethënia tjetër e tij, përkatësisht domethënia e fundamentalizmit islamik është përfshirë në aktivizmin⁵³ politik, ekstremizmin⁵⁴, fanatizmin⁵⁵ dhe anti-amerikanizmin.⁵⁶ Por, nga ana tjetër, është krejtësisht e qartë edhe ajo se fundamentalizmi islamik në botën bashkëkohore është përplot injorancë dhe paragjykim, sepse ai perceptohet si në rrezik konstant. Në të vërtetë, nocionet e

⁵¹ Përkufizimi i nocionit fundamentalizëm, i aksesshëm në: <http://dictionary.reference.com/browse/fundamental>

⁵² Sinisha, Aleksoski, *Roli i Republikës së Maqedonisë në luftën kundër krimit transnacional dhe terrorizmit ndërkombëtar (aspekti politikologjik)*, Universiteti "Shën Cirili dhe Metodi", Fakulteti Juridik "Justiniani i Parë", Shkup, f. 206.

⁵³ Nënkupton ndërmarrje të aksionit me qëllim të caktuar, përkatësisht zbatim të një aktiviteti të caktuar ose kombinim të aksioneve me qëllim që të shkaktohen pasoja dhe rezultatet e dëshiruara dhe të pritura sociale dhe politike.

⁵⁴ Ekzagjerim, këmbëngulësi, mospajtim në procedura dhe në sjellje (kryesisht në politikë).

⁵⁵ Përkushtim i pasionuar ndaj besimeve të veta.

⁵⁶ Forma e mospajtimit dhe urrejtjes ndaj popullit amerikan, kulturës dhe politikës së SHBA (veçanërisht politikës së jashtme).

tij më adekuate janë: përtëritja islame, aktivizmi dhe zgjimi islamik drejt rrënjëve të cilat i ka feja dhe tradita islame.⁵⁷

Duke u nisur nga e gjithë kjo, fundamentalizmi fetar paraqet nocion i cili ka të bëjë me ideologjitë dhe lëvizjet e ndryshme politike, të cilat angazhohen që jetën e përgjithshme shoqërore ta harmonizojnë me interpretim konsekuent të doktrinaeve të caktuara religjioze. Aspektet e jetës publike dhe private ai i konsideron si sekondare në raport me doktrinën e publikuara fetare. Nga kjo perspektivë, jeta politike dhe shoqërore do të duhet të organizoheshin në bazë të principeve fetare dhe mësimëve të cilat ofrojnë një vështrim të plotë të botës. Kështu, fundamentalizmi religjioz, në mënyrë të arsyeshme, mund të konsiderohet si një ideologji. Edhe pse, islami është religjioni i dytë më i madh në botë, shumica nga Perëndimi deri në Revolucionin Islamik të Iranit të vitit 1979, nuk dinin thuaja se asgjë për fundamentalizmin islamik, sepse, përderisa në Perëndim, islami fillimisht identifikohet me rezistencë, anti-amerikanizëm dhe terrorizëm, pikëpamja kryesore ideologjike ndaj botës, në botën islame është bazuar në frymën fetare pacifiste sipas të cilit i njëjti paraqet:

1. Një ideologji gjithëpërfshirëse, të cilën e udhëheq çdo individ dhe jeta e tij kolektive dhe politike;
2. Kurani dhe shembulli me Profetin Muhamed dhe bashkësia e hershme myslimane janë bazë e jetës së myslimanëve dhe i japin format e sjelljes së përditshme;
3. Ligji islam (Sheriati) është shembull ideal për shoqërinë moderne myslimane, e cila nuk varet nga modelet perëndimore;
4. Shmangia nga islami dhe mbështetja e Perëndimit shkaktojnë rënie myslimane. Nëse kthehesh në rrugën e vërtetë të islamit do të ripërtërihet identiteti, krenaria suksesi, fuqia dhe pasuria e bashkësisë islame në këtë botë dhe do të meritojë dhuratë të përjetshme në botën tjetër;

⁵⁷ Islam way. "The real causes of extremism" 05.03.2001, i aksesshëm në: <http://ar.islamway.net/article/76/> هيقي يوقحل-حبابيس أو غرطتل

5. Shkenca dhe teknologjia duhet të shfrytëzohen në kuadër të kontekstit islamik, në vend të varësisë nga kultura e huaj perëndimore, me çka do të shmanget "Westification" i shoqërisë muslimane;
6. Xhahadi dhe lufta, personalisht dhe në bashkësi, në idetë dhe aktivitetet, gjithnjë me qëllim që të zbatohen reformat islamike dhe revolucioni dhe ata të paraqesin mjet për realizimin me sukses të islamizimit të shoqërisë dhe botës.⁵⁸

Para se të fillojmë me temën qendrore të interesit tonë në këtë punim, konsiderojmë se është e rëndësishme t'u bëjmë vështrim disa nocioneve të përgjithshme teorike, të cilët kanë të bëjnë me domethënien totale të konceptit fundamentalizmi *religjioz*.

Pak dihet se fundamentalizmi religjioz për herë të parë është evidentuar në kuadër të bashkësisë protestante në Shtetet e Bashkuara të Amerikën, kah fundi i shekullit XIX dhe fillimi i shekullit XX. Grupe të caktuara nuk janë pajtuar me protestantët "liberalë", përkatësisht këndvështrimet e tyre për fenë e krishtere, dhe në këtë mënyrë kanë filluar të quhen fundamentalist, në mënyrë që të dallohen nga të tjerët. Më vonë, me kalimin e viteve, shkenca e ka pranuar gjerësisht si nocion dhe e përdor të njëjtin.

Pranimi i fundamentalizmit si fenomen, i cili edhe pse deri diku është universal, duhet të shikohet nga prizmi i shoqërisë dhe kulturës konkrete, në të cilat lind dhe në të cilat ekziston i njëjti. Dëshirë e jona për krijimin e një perspektive universale është e kufizuar nga mosekzistimi i strukturës gjatë çdo përpjekjeje për përkufizimin konkret të fundamentalizmit.⁵⁹ Dhe kështu, fundamentalizmin në përgjithësi mund ta përkufizojmë si lëvizje e cila është *radikale* në aspekt të qëllimeve të veta, *ekstreme* në aspekt të metodave dhe *shprehimisht* në raport me metodat e ruajtjes së burimeve të shkruara religjioze.

⁵⁸ "Otaiba: *Ekstremizmi islamik dhe kanceri interkontinental*" 21.09.2014, i aksesshëm në: <http://www.masralarabia.com/ن-اطرس-يمالسال-اخرطنتال-عبييتعلا-360201/يبنج-عفاحص-تاراقلل-رباع>

⁵⁹ Weinberg, Leonard & Pedahzur, Ami. *Religious Fundamentalism and Political Extremism*, Frank Cass Publishers, London, 2003, f.74.

Është evidente se fundamentalizmi është dukuri e cila është karakteristike për ato kultura të cilat i quajmë tradicionale, në të cilat njerëzit i trashëgojnë përvojat dhe perceptimin e botës nga e kaluara dhe mbi këtë bazë ndërtojnë perceptim konservativ ndaj botës dhe ndaj mënyrës së të kuptuarit të saj. Karakteristike për pjesën më të madhe të njerëzve, të cilët jetojnë në këto kultura, është ajo se ata nuk janë aktivë në mënyrë të vetëdijshme se janë tradicional. Ata karakterizohen me mbylljen, shumë shpesh edhe izolimin dhe si të tillë në esencë grupe të "pasfiduara", për ata nuk ekziston "tjetri ose të tjerët". Kështu që, jo çdo grup i sapokrijuar fetar (të quajtur edhe sekte ose kulte), mund të quhet fundamentalist, edhe pse është shumë e mundshme ata të kenë një pjesë të këtyre karakteristikave. Në mënyrë që të mund të shihen si të tilla, paraprakisht duhet të ekzistojë kultura joagresive, relativisht e mbrojtur, tradicionale në të cilën një pjesë e pjesëtarëve konsiderojnë se ka ekzistuar një e kaluar e çiltër, e mirëfilltë ose e lartësuar, e cila është pjesë e trashëgimisë së tyre kulturore.⁶⁰

Veçori tjetër e tyre është mundësia që çdo dukuri, e cila kërcënon ta lëkundë botën e këtyre grupeve tradicionale, të trajtohet në mënyrë armiqësore, kërcënime të këtilla mund të vijnë nga jashtë, me ç'rast u jepen nocionet si: vesternizim, pluralizëm dhe shekullarizëm. Por, këto kërcënime mund të shfaqen edhe brenda, në vet grupin, me atë se individët e tillë quhen si: modernistë, tradhtarë dhe ngjashëm. Për këtë shkak, mund të konstatojmë se pjesëtarët e këtyre grupeve, në konceptin fundamentalist, gjejnë mënyrë për të dalë nga situatat në të cilat besimet e tyre, në përgjithësi dhe mënyra e jetesës së tyre rrezikohen pavarësisht se nga ku vijnë ndryshimet, përmes përdorimit të përcaktimit të nocioneve dhe veprimt aktiv kundër këtyre kërcënimeve, konform qasjes tradicionale ose udhëzimeve të liderëve të grupit. Roli i liderëve në grupet fundamentaliste, sidomos në aspekt të interpretimit teologjik të korrektesisë së plotësisht të rregullave të asaj që do të thotë e lejuar dhe e palejuar, e drejtë dhe jo e drejtë kanë rol kryesor. Ky rol kryesor depërton në të

⁶⁰ Kaplan, Lawrence. *Fundamentalism in Comparative Perspective*, University of Massachusetts, 1992, f.85

komunitete më të vogla islame të cilat i takojnë islamit Shiit. Marrë sipas përqindjes, myslimanët gjenden në: R. e Turqisë (98%), R. e BeH 48% (në entitetin Federata BeH 70%), R. e Shqipërisë (70%), R. e Kosovës (90%) me popullsi dominante myslimane, ndërsa në R. e Maqedonisë (33%), R. e Malit të Zi (18%), R. e Bullgarisë (10%), me popullsi dominante ortodokse dhe me minoritet të konsiderueshëm të popullsisë myslimane, R. e Serbisë (5%), R. e Rumanisë (0.3%), R. e Greqisë (1.5%) dhe R. e Kroacisë (1.3%) janë me popullsi dominante krishtere".⁶⁵

Sipas artikullit të gazetës britanike Sunday Times – "fundamentalistët e organizatave radikale saudite, gjatë viteve të fundit, në Rajonin e Ballkanit kanë financuar ndërtimin e xhamive dhe qendrave islame, dhe në të cilat pasardhësit e tyre i kanë paguar me shumë prej rreth 225 funta në muaj.⁶⁶ Me këtë, ata kanë për qëllim ta ndryshojnë imazhin për traditë liberale islame, i cili tanimë një kohë të gjatë ekzistonte në Ballkan, përfundon gazeta.⁶⁷

Nëse i marrim parasysh këto parametra dhe konkretisht fokusohemi në Republikën e Maqedonisë, do të vërejmë se ekspertët paralajmërojnë se: "Në Republikën e Maqedonisë janë të pranishëm ithtarët e vëllazërisë myslimane, ndërkaq identifikohen përmes Forumit Rinor Islam (FRI), i cili në mënyrë aktive mbështet studentë në shkencat teologjike dhe studentë nga fakultetet e shkencave shoqërore dhe të natyrës, mbi të cilët si bartës të ardhshëm të funksioneve shoqërore dëshirojnë të kenë ndikim dhe nga ana tjetër kanë degët e tyre në Zvicër (me emrin Fondacioni Rinor Islam) dhe në Austri. Më së shpeshti, kontaktet e tyre në rretë janë përmes organizatave dhe degëve me emërtime të njëjta, siç është Forumi Rinor i Shqipërisë. "Fundamentalizmi islam është shprehje e një lëvizjeje konservative fetare, e cila e kërkon kthimin në vlerat islame, në parimet dhe principet e islamit në aspekt të zbatimit sistemor të

⁶⁵ Sinisha Aleksoski... vepër e cituar, f.221.

⁶⁶ Pančevski Bojan. "Saudis fund Balkan Muslims spreading hate of the West"- 28.03.2010 i aksesshëm në: http://www.thesundaytimes.co.uk/sto/news/world_news/Europe/article251901.ece

⁶⁷ Ibid.

dhunës dhe zbatimit të qëndrimeve të atilla të cilët bëjnë pjesë në fushën e ekzekutimit të veprave penale. Me fjalë të tjera, tentohet të realizohen objektiva të caktuara politike dhe prandaj përdoret sintagma Islami politik".⁶⁸

Sido që të jetë, çështja e islamit radikal në Republikën e Maqedonisë nuk paraqet asgjë të re. Komuniteti fetar islam që para disa vitesh fillimisht e mohonte, ndërsa pasta pohoi se islami radikal futet nëpër xhami, ndërkaq për katër xhami u prononcuan se mbi të njëjtat nuk kanë kontroll.⁶⁹ Një kohë të gjatë, në publik flitet edhe për kampe të trajnimit për njësitë terroriste të locuara në Ballkan. Nja njëzetë xhihadistë nga Maqedonia aktualisht luftojnë në fushëbetejat e Lindjes së Afërt dhe me këtë Ballkani u bë një nga zonat kryesore për rekrutimin në Evropë të luftëtarëve të Shtetit Islamik. Është e pashmangshme se fajtorë kryesorë, për rritjen e ndikimit të islamit radikal në vendet e rajonit, para së gjithash, është varfëria dhe papunësia. Këto janë konkluzione deri te të cilat erdhi "Zidojçe Cajtung" i Gjermanisë, duke iu referuar të dhënave të shërbimeve sekrete të vendeve ballkanike, si dhe CIA-s Amerikane. Kur bëhet fjalë për Maqedoninë, gazeta e njëjtë përkujton se Presidenti Gjorge Ivanov, kohë më parë, e shfrytëzoi fjalimin e tij në KB dhe i bëri apel Bashkimit Evropian dhe NATO-s që sa më shpejtë ta pranojnë vendin tonë, meqë në të kundërtën ekziston rreziku nga islamikët radikal që ta plotësojnë "vakumin në Ballkan." Nga ana tjetër, raportet konfirmojnë se deri më tani, 12 shqiptarë myslimanë nga Maqedonia e humbën jetën në fushëbetejat në Siri dhe Irak.⁷⁰

Ashtu siç theksuam paraprakisht, një nga arsyet kryesore për shkak të të cilave njerëzit shkojnë të luftojnë në Lindjen e Afërt është faktori ekonomik. Nëse i analizojmë parametrat kryesor do të

⁶⁸ Utrinski vesnik. Haxhi-Zafirova, Zhaklina. "DERI KU DEPËRTON ISLAMI RADIKAL NË VEND, 02.05.2010 i aksesshëm në: <http://www.utrinski.mk/default.asp?ItemID=50602E5B3EACB14FA6E8F4482EF14992>

⁶⁹ Utrinski vesnik. Haxhi-Zafirova, Zhaklina. "DERI KU DEPËRTON ISLAMI RADIKAL NË VEND, 02.05.2010 i aksesshëm në: <http://www.utrinski.mk/default.asp?ItemID=50602E5B3EACB14FA6E8F4482EF14992> Ibid. стр.6.

⁷⁰ Utrinski vesnik. Haxhi-Zafirova, Zhaklina. "DERI KU DEPËRTON ISLAMI RADIKAL NË VEND, 02.05.2010 i aksesshëm në <http://www.utrinski.mk/default.asp?ItemID=50602E5B3EACB14FA6E8F4482EF14992>

konstatohet se shkalla e papunësisë në Kosovë është 45%, niveli i lartë i dhunës në familje dhe braktisja masive e shkollave. Ata, fenë e shohin si ombrellën e fundit, ka vlerësuar sociologu Bardhyl Plakoli.⁷¹ Sipas analizës së "Zidojçe Cajktung", - "Ballkani, krahas vendeve perëndimore, me një minoritet të numërt mysliman, siç është Franca, Belgjika dhe Anglia, u bë njëri nga rajonet kryesor në Evropë për rekrutimin e luftëtarëve për Shtetin Islamik dhe për grupet e tjera radikale." Me këtë pohim ndërlidhen edhe vlerësimet e shërbimeve kosovare të sigurisë dhe CIA-s amerikane, se në fushëbetejat në Lindjen e Afërt marrin pjesë 150 njerëz nga Kosova. Përveç tyre, në Siri dhe Irak ka 140 luftëtarë nga Shqipëria, 30 nga Mali i Zi dhe 20 nga Maqedonia.⁷² Në Bosnjë e Hercegovinë, lidhja me islamin radikal ekziston që nga koha e luftës në Bosnje, në fillim të viteve të '90-ta të shekullit të kaluar. Atëbotë myslimanët nga e gjithë bota erdhën që t'u ndihmojnë vëllezërve të tyre për nga feja në luftën kundër serbëve. Viteve të fundit, fundacione islamike, më së shpeshti të financuara nga Arabia Saudite, në mënyrë të përforcuar angazhohen në Bosnje. Disa fshatra, siç është Gorna Maoça, llogariten si bastione islamike.⁷³

Në favor të kësaj që e thamë deri më tani, e konsiderojmë të nevojshme që t'i elaborojmë rastet më eklatante të cilat e karakterizojnë fundamentalizmin modern islam.

Në territorin e Irakut dhe Sirisë me fuqi të madhe sundon "Shteti Islamik", ndërsa mosmarrëveshjet shumëvjeçare midis Palestinës – Gazës dhe Izraelit përsëri tensionohen. Rajonin, të cilin në ndërkohë e kontrollojnë "Shteti Islamik" është një rajon jashtëzakonisht i madh dhe posedon resurse strategjike energjetike, që në mënyrë plotësuere e rrit fuqinë e tij. Së këtejmi, domosdoshmërisht shtrohet

⁷¹ NetPress. "Rexhepi: Pjesa më e madhe e xhihadistëve kosovar janë të paarsimuar, narkomanë dhe kriminelë", 02.10.2014 <http://netpress.com.mk/redzepi-pogolemi-ot-del-od-kosovskite-dzihadisti-se>

⁷² Utrinski vesnik, Adamovski, Goran. "NJËZETË XHIHADISTË NGA MAQEDONIA LUFTOJNË PËR ISIS" 06.10.2014 <http://www.utrinski.mk/default.asp?ItemID=EF0359B4527C964994DA5893D296B953>

⁷³ Utrinski vesnik, Adamovski, Goran. "NJËZETË XHIHADISTË NGA MAQEDONIA LUFTOJNË PËR ISIS" 06.10.2014 <http://www.utrinski.mk/default.asp?ItemID=EF0359B4527C964994DA5893D296B953>

pyetja: - Si u përhap grupi terrorist dhe çfarë lidhje ka mposhtja nga pushteti e Sadam Hyseinit me shfaqjen e "Shtetit Islamik"? – Bëhet fjalë për një grup ekstremist sunit, që u krijua nga pjesët e mbetura të Al Kaeda-s në Irak. Ky grup terrorist dëshiron që me zbatimin e forcës ta krijoj shtetin sunit të Zotit, i cili do ta përfshinte: Sirinë dhe Irakun, por edhe Libanin, Izraelin dhe Jordaninë. Kjo do të thoshte shlyerje të një pjese të, sipas tyre, *vijave kufitare nacionale të vendosura në mënyrë të njëanshme nga ana e fuqive koloniale*. "Shteti Islamik" tanimë kontrollon pjesë të Sirisë dhe Irakut. Ekspertët e Lindjes së Afërt prononcohen se ata fillimisht financoheshin nga Arabia Saudite, Katari, Kuvajti dhe Emiratet e Bashkuara Arabe, me qëllim që ta mbështesin luftën e tyre kundër regjimit të Presidentit të Sirisë, Bashar al Asad, megjithatë prova për këto pohime akoma nuk ka. Ky grup kinse numëron rreth 10 mijë luftëtarë, në mesin e të cilëve edhe shumë sunitë nga Afrika Veriore, nga vendet e Gjirit Persik, si dhe të konvertuarit nga Evropa dhe SHBA. Fillimisht, krijohet si një grup i rezistencës kundër intervenimit amerikan në Irak në vitin 2003. Atëherë nga pushteti u rrëzua Presidenti i Irakut, Sadam Hysein-i, u ndalua partia e tij nacionaliste BAAS dhe u shpërnda armata.⁷⁴ Megjithatë, ekstremistët nuk i sulmonin vetëm ushtarët amerikanë, por të njëjtit kryenin edhe sulme vetëvrasëse ndaj shiitëve dhe të krishterëve. Në atë "Shtet Islamik" vlejnë ligjet e Sheriatit, ndërsa gratë, përmes kërcënimit me vdekje, detyrohen që tërësisht të mbulohen dhe të mbajnë niqab.⁷⁵ Minoritetet religjioze si krishterët dhe ezid-ët u detyruan të ikin nga luftëtarët e IDIL-it pasi që u ishin kërcënuar me vdekje. Gjatë sulmeve të tyre, ky grup terrorist ia doli të vidhte miliona dollarë dhe të përvetësojë më shumë fusha naftë në Irak dhe Siri. Në mesin e sendeve të vjedhura kishte edhe armë të armatës së SHBA-ve.⁷⁶

⁷⁴ "The real causes of extremism" Islam way: 05.03.2001, i aksesshëm në: <http://ar.islamway.net/article/76/> <http://ar.islamway.net/article/76/>

⁷⁵ "The real causes of extremism" Islam way: 05.03.2001, i aksesshëm në: <http://ar.islamway.net/article/76/> <http://ar.islamway.net/article/76/>

⁷⁶ Crooke, Alastair. "Middle East Time Bomb: The Real Aim of ISIS Is to Replace the Saud Family as the New Emirs of Arabia" 11.02.2014 http://www.huffingtonpost.com/alastair-crooke/isis-aim-saudi-arabia_b_5748744.html

Nga ana tjetër, mospajtimet midis Izraelit dhe Hamasit, filluan në vitet e vona të tetëdhjeta. Dega palestineze e Vëllazërisë Myslimane, Hamas, nuk e njohu Izraelin si shtet të pavarur dhe kërkoi formimin e Palestinës në bazë të kufijve të saj nga viti 1967 me Jerusalem si kryeqytet. Në vitet e nëntëdhjeta të shekullit të kaluar, njësitë paramilitare të Hamasit ndërmorën sulme terroriste kundër Izraelit. Në vitin 2006, në zgjedhjet parlamentare, Hamasi e fitoi partinë në pushtet Fatah. Nga ajo periudhë, në masë të konsiderueshme u rrit ndikimi i tyre mbi Palestinën, ndërsa kjo organizatë u bë një forcë e fuqishme politike në rajon, me seli në Rripin e Gazës dhe në Bregun Perëndimor (Ed Hysein në kolumnën e tij në SiEnEn). Dhuna e vazhdueshme midis Izraelit dhe Gazës u nxit nga vrasja e tre studentëve të ri izraelit më 10 qershor të këtij viti. Izraeli u përgjigj duke bombarduar Gazën ku ka edhe pjesëtarë të Hamasit, atë natë kur u gjetën djemtë. Grupet militante palestineze (jo Hamas) në Gazë hodhën raketa drejt Izraelit. Pastaj, më 2 korrik, një palestinez 16 vjeçar Muhammed Abu Khdebir u gjet i vdekur në afërsi të shtëpisë së tij në Jerusalem me djegie nëpër trup. Policia arrestoi gjashtë izraelitë për vrasjen e tij. Me fjalë të tjera, bëhet fjalë për hakmarrje nga ana e ekstremistëve hebraikë për vrasjen e tre djemve izraelitë. Pas kësaj, pasoi një numër i madh i akteve të dhunshme mbi palestinezët nga ana e kolonëve izraelitë dhe izraelitëve të tjerë, pastaj kishte një manifestim anti-palstinez, ndërsa përmes deklaratave provokuese nga ana e politikanëve izraelitë dhathtistë të cilët e nxitën zemërimin nacional izraelit. Gjatë krizës kishte edhe sulme sporadike me raketa, por Hamasi, më 8 korrik, ndërmori një valë prej 40 raketash për të cilën gjë për herë të parë, pas vitit 2009, e mori përgjegjësinë. Pastaj, Izraeli organizoi më shumë demonstrata në Gazë, si pjesë të asaj që Netanjahu e paralajmëroi, se Hamasi duhet të paguaj "çmim më të lartë".⁷⁷ Pas disa ditëve tejte të përgjakshme, të cilat shkatërruan shumë pjesë të Gazës, Izraeli dhe Hamasi i filluan negociatat për një paqe të qëndrueshme në Kairo, me ç'rast Qeveria e Egjiptit ishte ndërmjetësuese në këto negociata.

⁷⁷ Sputnik News. "Israel determined to complete destruction of Hamas tunnels" 28.10.2014, i aksesshëm në: <http://sputniknews.com/world/20140731/191526220/Israel-Determined-to-Complete-Destruction-of-Hamas-Tunnels.html>

Mund të konstatojmë se domethënia e nocionit "fundamentalizëm, nga shfaqja e fundamentalistëve protestantë në SHBA deri në grupet ekstremiste të sotme, të cilat për çdo ditë i hasim në mediat e shumta, tërësisht ka ndryshuar. Mirëpo, pavarësisht formës, fundamentalizmi çdoherë në vetvete e përmban komponentin politik, madje edhe atëherë kur për vetvete pohon se është vetëm fetar, gjithmonë është edhe politikë. Ai kërkon një model të caktuar të organizimit politik dhe social si mënyrë për realizimin e idealeve të veta fetare. Është evidente se fundamentalizmi islam ka orientim eminent politik, edhe pse motivimi i tij është i natyrës së pastër fetare. Për këto shkaqe, fundamentalizmi islam, sido që të jetë, është produkt i tentativave për kthimin e rëndësisë teorike të islamit si religjion në botën bashkëkohore. Fillimisht nënkupton drejtim në shkencë në të cilin teologët islamikë i hulumtojnë burimet dhe fondamentet e Islamit, përkatësisht Kur'anin dhe Sunnetin dhe ata në asnjë rast nuk guxojnë të identifikohen me grupet radikale (Hamas, Shteti Islamik, Al Qaeda), të cilët propagojnë dhe përhapin urrejtje e dhunë, ndërsa vetveten e quajnë fundamentalistë.

Mr. Ivana Atanasoska
Forumi Politikologjik Maqedonas

MA Ivana Atanasoska
Macedonian Political Forum

Modeli i multikulturalizmit
(disa çështje dhe sfida themelore)

The Model of Multiculturalism
(some basic issues and challenges)

Fjalët kryesore: multikulturalizëm integrim, polietnicitet, diversitet, bashkëjetesë.

Key words: multiculturalism, integration, polyethnicity, diversity, coexistence.

Abstract

The debate around multiculturalism, which has grown into being one of the most issues discussed in the 20th century, is one of the crucial questions in the modern age from political, economic, social and anthropological aspect. The question of the role and the influence of multiculturalism is an inevitable part of many analyses, given the fact that this concept is deeply rooted in all modern societies, regardless of whether this concept is promoted or subsided in the society itself. The increasing number of conflicts on all levels, the interethnic tensions and violence imminently place the issue of multiculturalism in the core of many debates, researches and policies. This paper aims at analyzing the different aspects of defining multiculturalism and examining the stances of this concept's supporters and critics. Furthermore, this paper focuses on reviewing the different types of multiculturalism and analyzing the group-specific rights, as well as their demands in regards to preserving their group interests, as defined by the political philosopher Will Kimlika. The final point of this paper is positioning multiculturalism and its characteristics through the prism of modern day problems and challenges on global level.

*

Debati, sa i përket multikulturalizimit, si njëri nga çështjet më sensitive të shekullit XX, sot është mjaftë aktual edhe atë në çdo aspekt të procesit politik, ekonomik, social dhe antropologjik, duke filluar nga niveli lokal, nacional dhe deri në nivelin global. Së këtejmi, çështja lidhur me rolin dhe ndikimin e multikulturalizmit është pjesë e pashmangshme e të gjitha analizave, meqë ky koncept është thellë i vendosur në të gjitha shoqëritë bashkëkohore, pa dallim nëse një shoqëri e mbështet dhe stimulon ose nga ana tjetër e mohon dhe i bën shtypje.

Duke i bërë një vështrim numrit të madh të konflikteve, tensioneve ndëretnike dhe dhunës, të cilat nxiten nga mostoleranca etnike, çështja e multikulturalizmit, në mënyrë të pashmangshme, vendoset në thelbin e të gjitha debateve dhe analizave shkencore, por edhe në ato të përditshme në mbarë botën, përfshirë këtu edhe Republikën e Maqedonisë.

Së këtejmi, është e sigurt se multikulturalizmi vazhdimisht mbështetet, kritikohet, përkufizohet dhe ripërkufizohet.⁷⁸ Komponenti kryesor, i cili e përkufizon këtë fenomen shoqëror, konsiston me atë se multikulturalizmi është vetvetiu paradoks, dhe i njëjti në të vërtetë nuk mund të përkufizohet, së paku kur bëhet fjalë për përkufizimet në kuptimin e tyre të mirëfilltë ose teknologjik të fjalës. Deri më tani, në shkencë, qoftë nga këndvështrimi juridik, politik, ekonomik, sociologjik ose antropologjik nuk u arrit të gjendet një përkufizim burimor, kështu që ne kemi në dispozicion një sërë përkufizimesh përgjithësisht të pranuar, të cilat e karakterizojnë domethënien e nocionit të multikulturalizmit.

Përkufizimi më autentik, sa i përket multikulturalizmit, është se ai mund të përkufizohet aq herë dhe në po aq mënyra sa ka edhe njerëz në planetin Tokë dhe të gjitha këto përkufizime, në një aspekt të caktuar, janë të sakta. Prandaj, qasja më e mirë drejt përkufizimit të

⁷⁸ Prato, Giuliana B., *Beyond Multiculturalism: Views from Anthropology*, Ashgate Publishing Ltd, 2012, f. 2

multikulturalizmit është qasja ndaj këtij koncepti dhe ndaj analizës së tij përmes pranimit të faktit se i njëjti i ka karakteristikat e ADN-së së njeriut, përkatësisht se çdo përkufizim është unik dhe me këtë edhe vetvetiu autentik.

Është me rëndësi të theksohet se multikulturalizmi, veçanërisht në gjysmën e dytë të shekullit XX, u bë pjesë integrale e ngjarjeve politike moderne, me ç'rast njëkohësisht u imponua si temë në të cilën janë gërshetuar shumë interpretime divergjente në aspekt të arenës specifike dhe ideologjike me implikime afatgjata politike dhe teorike.⁷⁹ Nga ky aspekt, në vend të tentativës që të mbështetet një ose disa përkufizime të multikulturalizmit ose multikulturalizmit t'i qaset vetëm nga provenienca skollastike, ky punim ka për qëllim t'i shqyrtojë përkufizimet e multikulturalizmit që burojnë nga ithtarët e këtij koncepti, si dhe përkufizimet të cilat rezultojnë nga kritikët, dhe përmes analizës së tyre të shqyrtohen modelet e multikulturalizmit në botën bashkëkohore.

Mungesa e një përkufizimit, përgjithësisht të pranuar, çon kah analiza e multikulturalizmit përmes shqyrtimit të tij nga ana e ithtarëve dhe kundërshtarëve të tij. Ata që e mbështesin multikulturalizmin e theksojnë vlerën e tij si mënyrë të vetme për praktikimin e të drejtës së çdo individi për identitetin personal. Ata konsiderojnë se multikulturalizmi, nëse vendoset në baza të qëndrueshme në një shoqëri, është mënyra më e mirë për afirmimin e diversitetit të grupeve etnike dhe për promovimin e bashkëjetesës midis komuniteteve të ndryshme. Ithtarët e multikulturalizmit të njëjtin e përkufizojnë si formë unike të integritit. Për Ronald Takaki, multikulturalizmi nënkupton koncept dinamik, i cili e stimulon individin në kërkim të përfaqësimit autentik të vetvetes dhe grupit në të cilin bën pjesë.⁸⁰

Gjithashtu, nga aspekti i shkencës sociologjike dhe politikologjike, ithtarët e multikulturalizmit të njëjtin e përkufizojnë si praktikë të

⁷⁹ Podunavac, Millan, *Sfidat e Multikulturalizmit*, Hajnrih Bol Fondacioni, Beograd, 2012. f. 11.

⁸⁰ Trotman, C. James, *Multiculturalism: Roots and Realities*, Indiana University Press, 2002, page Xi.

njohjes dhe vlerësimit të diversitetit në kuadër të krijimit të një shoqërie kohezive, të përbërë prej grupeve të ndryshme etnike dhe kulturore, në vend të përpjekjeve që këto grupe të ndryshme të vendosen në një "kallëp" të njëjtë.⁸¹ Ata marrin një hov të konsiderueshëm në periudhën pas Luftës së Dytë Botërore, kur idetë për humanizmin, për të drejtat e njeriut dhe barazinë arritën dimensione të reja, ndërsa ideja për "afirmimin e diversiteteve" u bë temë qendrore në politikën e reja progresive. Në këtë periudhë, identiteti u vendos fuqishëm si pikë referimi në çdo fushë të shoqërisë, ndërkaq të gjitha format e organizimit u analizuan dhe debatuan sërish, megjithatë kësaj radhe nga aspekti i përkufizimit të së drejtës së vet-përcaktimit individual në çdo kuptim.⁸² Së këtejmi, është e evidente se multikulturalizmi është ngushtë i lidhur me migrimin e popujve, ndërsa shembull më i mirë për këtë është fakti se në mesin e vendeve të para, të cilat vetveten e perceptojnë si multikulturore, janë pikërisht ato vende të cilat janë themeluar dhe bazuar mbi migracionin, ndërsa para së gjithashtu këto vende janë: Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Australia dhe Kanadaja.

Së këtejmi, një numër i madh i mbështetësve të idesë së multikulturalizmit sot e apostrofojnë Kanadanë si shembull të një shoqërie të suksesshme multikulturore.⁸³ Komisioni Mbretëror për bilingualizëm (dygjuhësi) dhe bikulturalizëm në Kanada apostrofohet si njëri nga shembujt e parë për pranimin dhe promovimin politik të multikulturalizmit në shoqëritë bashkëkohore.⁸⁴ Nga ana tjetër, edhe pse çdo proces i migrimit, deri në një masë të caktuar, i nënshtrohet asimilimit, kur bëhet fjalë për SHBA praktikën e asimilimit kanë

⁸¹ Reitz Jeffrey G., Breton Raymond, Dion Karen Kisiel, Dion Kenneth L., *Multiculturalism and Social Cohesion: Potentials and Challenges of Diversity*, Springer Science+Business Media, 2009, page 1.

⁸² Gjatë analizës së multikulturalizmit, në fokusin e debatit çdoherë është identiteti personal dhe perceptimi i tij politik në një shoqëri. Shih: Guttman, Amy, *Introduction*, bo Taylor, Charles, Appiah, Anthony K., Habermas, Jurgen, Rockefeller, Steven C., Walzer, Michael, Wolf, Susan, *Multiculturalism: Examining the Politics of Reconciliation*, Princeton University Press, 1994, f. 3-25.

⁸³ Multikulturalizmi u promovua zyrtarisht si politikë qeveritare në Kanada në vitet e '70-ta dhe të '80-ta të shekullit të kaluar, duke u fokusuar mbi aspektin social të imigracionit.

Kobajashi, Audrey, *Multiculturalism: Representing a Canadian Institution* bo Duncan, James S, Duncan, Ley *Place/Culture/Representation*, Routledge 1983 f.205.

⁸⁴ Jackson, Ronald L, *Encyclopedia of Identity*, Sage, 2010 f.480.

ndikim shumë më të vogël në krahasim me praktikën e asimilimit të detyrueshëm të perandorive të mëdha nga e kaluara. Kryesisht të mbështetura mbi konceptin e lirisë, SHBA-të vendosin për një qasje krejtësisht të ndryshme sa u përket imigrantëve dhe në vend që të fokusohen në asimilimin e tyre të detyrueshëm në bazë etnike në shoqërinë amerikane, ata vendosin për një metodë mjaft më suptile, megjithatë edhe mjaft më të suksesshme – projektimi i “Ëndrrës amerikane”, vizion për ardhmëri më të mirë, sukses dhe mirëqenie, që paraqesin një gjuhë universale të të gjithë popujve dhe motiv kryesor për të emigruar në SHBA. Prandaj, sot pa dallim të përkatësisë së tyre etnike, numri më i madh i banorëve të SHBA vetveten e konsiderojnë për amerikanë dhe koncepti i “melting pot”⁸⁵ u tregua si jashtëzakonisht i suksesshëm.

Megjithatë, duhet të theksohet se shtetet multikulturore nuk janë “zbulim” i shekullit XX. Nga këndvështrimi historik, multikulturalizmi ka qenë i pranishëm që në kohërat e lashta, në Perandorinë e Aleksandërit të Madh, përmes Mbretërisë Romake, pastaj Bizanti dhe deri në Perandorinë Osmane, kur kultura dhe popuj të ndryshëm kanë jetuar brenda një sistemi të njëjtë, megjithatë në masë të caktuar e kanë ruajtur traditën dhe kulturën e tyre. Por, risinë të cilën multikulturalizmi bashkëkohor e instaloi në shtetet-kombet perëndimore është një lloj i miksit etnik-religjioz që është një dukuri relativisht e re për ato vende, veçanërisht për vendet e Evropës Perëndimore (edhe pse mund të bëhen krahasime relevante me hebrenjtë dhe sektet krishtere të cilat ekzistonin në Evropë shumë kohë më parë). Me një fjalë, multikulturalizmi bashkëkohor paraqet zëvendësim për asimilimin e praktikuar gjatë kohës së kolonializmit.

Së dyti, multikulturalizmi, në këto përmasa, është i ndërthurur me idenë për shoqëri demokratike dhe të drejtat individuale të

⁸⁵ Ithtarët e konceptit të “melting pot” amerikan (shkruarja e një numri të madh të kulturave të ndryshme të imigrantëve në një kulturë homogjene dhe harmonike “amerikane”), përkatësisht amerikanizimi i imigrantëve vë në pah se asimilimi kulturor është njëra nga karakteristikat më të rëndësishme për ndërtimin dhe qëndrueshmërinë e identitetit nacional dhe i njëjti duhet të mbështetet dhe promovohet. Shin: Fuchs, Lawrence H. *The American Kaleidoscope: Race, Ethnicity, and the Civic Culture*. Wesleyan University Press.1990 f.275.

njeriut nga aspekti i idesë për bashkëjetesë të komuniteteve të ndryshme etnike dhe religjioze, madje është shumë më progresiv nga multikulturalizmi i cili ka ekzistuar para lindjes së kombeve, përkatësisht më progresiv nga pluralizmi i institucionalizuar kulturor i arritur në shtetet perandorake siç është Perandoria Osmane apo në krahasim me Indinë bashkëkohore.⁸⁶ Prandaj, kur bëhet fjalë për “multikulturalizmin bashkëkohor”, pikë referimi më e mirë për analizën e tij është përmes simbiozës së tij gjatë krijimit të shoqërive bashkëkohore⁸⁷, përkatësisht gjatë procesit të krijimit të shteteve bashkëkohore multietnike dhe multinacionale gjatë shekullit XIX dhe XX.

Është me rëndësi të nënvizohet se në bazën e tyre mund të kufizohen tre lloje të praktikave në shoqëritë pluraliste. Varësisht nga shkalla e komunikimit midis grupeve të ndryshme në një shoqëri dhe varësisht nga të drejtat të cilat i gëzojnë grupet minoritare në të njëjtën, ata karakterizohen përmes: segregimit, asimilimit dhe integritit.

Segregimi⁸⁸ e nënkupton izolimin e plotë të një grupi të caktuar nga shoqëria tjetër, si nga aspekti fizik ashtu edhe nga ai kulturor. Ai më së shpeshti zbatohet përmes masave ligjore, sipas së cilave pjesëtarëve të një grupi të caktuar u imponojnë ndalime dhe kufizime, ndërkaq si shembull mund ta marrim Afrikën e Jugut gjatë kohës së Apartheidit.⁸⁹ Segregimi më së shpeshti karakterizohet me racizmin, përkatësisht kur i analizojmë shoqëritë e segreguara, veçanërisht shembujt nga shekulli XX, mund të shohim se ato, në pjesën më të madhe të shembujve, burojnë nga mostoleranca racore. Shkallë më e butë e segregimit është getoetizimi, i cili mund të burojë nga vet

⁸⁶ Modood, Tariq, *Multiculturalism*, John Wiley & Sons, 2013, f.53.

⁸⁷ Vlen të theksohet se, në debatin për multikulturalizmin, ekziston vetëm një premisë rreth së cilës pajtohen shkencëtarët, ndërsa kjo konsiston me atë se sot në botë, madje edhe nuk ekzistojnë “shoqëri homogjene”, përkatësisht shoqëri në të cilat jetojnë pjesëtarë vetëm të një bashkësie. Si shembuj unikal të shoqërive të këtylla më së shpeshti apostrofohen: Grenlanda (ku jeton popullata eskimez) dhe Koreja e Veriut.

⁸⁸ Shih: Uslaner, Eric M. *Segregation and Mistrust: Diversity, Isolation and Social Cohesion*, Cambridge University Press, 2012.

⁸⁹ Shih: Beinar, William, *Segregation and Apartheid in Twentieth-century South Africa*, Psychology Press, 1995

grupi, siç është rasti me hebrenjtë ortodoksë në Izrael, apo nga ana tjetër nën presionin e pjesës tjetër të shoqërisë, por nuk bëhet fjalë për ndalime të përcaktuara me ligj, por për kufizime të perceptuara të cilat i kanë instaluar vet grupet kulturore.

Asimilimi është një proces në të cilin grupet minoritare shkrihen në shumicën, përkatësisht e pranojnë kulturën dhe mënyrën e tyre të të jetuarit në llogari të kulturës së tyre. Deri në një shkallë të caktuar vet shoqëria pranon elemente të caktuara nga kulturat minoritare, megjithatë ky proces është shumë më i vogël në krahasim me ndikimin e shumicës në të cilën shkrihen grupet minoritare. Asimilimi është karakteristikë e perandorive të mëdha nga e kaluara, por edhe e një numri të madh shtetesh aktuale. Asimilimi i detyrueshëm është karakteristikë e perandorive të lavdishme, siç është ajo e Perandorisë Osmane, kur popullsia e territoreve të pushtuara të reja turqizohej me detyrim. Asimilim të detyrueshëm në masë të konsiderueshme mund të hasim edhe sot, ndërkaq shembull për këtë është Franca dhe ndalimi për mbajtjen e burkës.⁹⁰ Nga ana tjetër, e sotmja karakterizohet me asimilimin vullnetar, ndërsa shembull më i mirë për këtë është SHBA, për të cilën diskutuam paraprakisht.

Mbështetësit e konceptit të asimilimit pohojnë se atje ku nuk ka ndarje nuk ka as probleme. Ata konsiderojnë se homogjeniteti kulturor dhe ndjenja e fuqishme e përkatësisë ndaj kombit kontribuojnë për harmoninë sociale e cila është jashtëzakonisht e rëndësishme për progresin e shoqërisë. Nga ana tjetër, kritikët e asimilimit konsiderojnë se ky proces, veçanërisht nëse është i detyrueshëm, mund të rezultojë me frikë tek grupet minoritare nga mostoleranca dhe diskriminimi, dhe përmes kësaj edhe deri në turbulencë në vet shoqërinë. Gjithashtu, ata konsiderojnë se shoqëritë, të cilat praktikojnë politika asimilimi, vinë deri në shkallë të stagnimit kulturor dhe mbyllje sa i përket progresit.

⁹⁰ Williams, Michelle Hale, *The Multicultural Dilemma: Migration, Ethnic Politics, and State Intermediation*, Routledge, 2013, f. 216.

Integrimi, si koncept, në të vërtetë e përfshinë atë që propagon multikultura si dukuri. Me shoqëri të integruar nënkuptohet shoqëria në të cilën minoritetet kulturore stimulohen ta ruajnë kulturën e tyre dhe t'i praktikojnë traditat dhe zakonet e tyre, kuptohet në përputhje me normat e vendosura juridike, të cilat e mundësojnë funksionimin e shoqërisë. Integrimi, si koncept, shkon paralelisht me demokracinë, tolerancën, respektimin e të drejtave të njeriut dhe kështu me radhë, ndërsa si karakteristikë themelore e këtij modeli është respektimi i diversiteteve kulturore, përkatësisht "afirmimi i diversiteteve". Shoqëritë në të cilat ekziston integrimi në të shumtën e rasteve përshkruhen si "mozaik kulturor", në të cilat çdo bashkësi e ka vendin e vet dhe identitetin e vet të cilat e plotësojnë mozaikun. Mbështetësit e integrimit në të vërtetë janë ata të cilët e mbështesin multikulturalizmin si koncept dhe të cilët përpiqen për ruajtjen e diversiteteve në bazë të të drejtës themelore të individit për ta përcaktuar dhe ruajtur identitetin e tyre. Kritikët e modelit të integrimit, krahas pohimeve të shumta, sugjerojnë edhe në rrezikun nga i ashtuquajtur "segretim spontan", përkatësisht bashkë-ekzistimi i më shumë grupeve të ndryshme të cilët nuk kanë komunikim të ndërsjellë dhe shpejtë mund të çojnë në destabilizimin e shoqërisë dhe krijimin e tensioneve etnike.

Gjatë analizës së shoqërive multikulturore Kimlika përkufizon dy lloje të grupeve: "kultura të inkorporuara" të cilat Kimlika i emërton "minoritete nacionale" të cilat paraqiten si rezultat i përfshirjes të disa autonomive të mëparshme, kulturave të përqendruara teritorialisht, brenda një shteti më të gjerë, të cilët dëshirojnë të mbeten si shoqëri të ndara në kuadër të kulturës së shumicës dhe kërkojnë forma të ndryshme të autonomisë ose vetëqeverisjes, me qëllim të sigurimit të mbijetesës së tyre si shoqëri të ndara; dhe "grupe etnike" të cilat paraqiten si rezultat i migrimit individual dhe familjar, të cilat synojnë drejt integrimit në shoqërinë më të gjerë dhe dëshirojnë të pranohen si anëtarë të plotë të tyre.⁹¹ Sipas kësaj ndarjeje, është i pashmangshëm konkludimi se problemet në

⁹¹ Kimlika, Vil, *Qytetaria multikulturore: Teoria liberale për të drejtat e minoriteteve*, Instituti për Demokraci, Solidaritet dhe Shoqëri Civile, Shkup, 2004, f. 25.

shoqëritë multikulturore shfaqen nga të ashtuquajturat “kultura të inkorporuara”, meqë në të shumtën e rasteve synimi i tyre është të mbeten si shoqëri të ndara në kuadër të kulturës së shumicës dhe kërkesat e tyre për autonomi ose vetëqeverisje në mënyrë negative pasqyrohen mbi të drejtat dhe kërkesat e grupeve të tjera në shoqëri, më së shpeshti mbi grupin shumicë.

Nga ky aspekt, mund të konkludojmë se problemi kryesor i multikulturalizmit mund të përkufizohet përmes parashtrimit të një pyetjeje të thjeshtë, por njëkohësisht pyetje e cila nuk ka përgjigje: “Çka është më e rëndësishme – integriteti territorial dhe sovraniteti i shteteve ose e drejta e çdo populli (madje edhe e minoritetit nacional) për vetpërcaktim?” Debati i përhershëm, midis këtyre dy të drejtave të njohura dhe të garantuara ndërkombtarisht, secila me mbështetësit dhe kritikët e vet, na jep një panoramë të qartë për atë se multikulturalizmi dhe analiza e tij, në shoqëritë bashkëkohore, në masë të madhe varet nga pikë-referimi themelor i analizës dhe qëndrimit të shkencëtarëve të cilët merren me të njëjtën.

Nga ana tjerët, kritikët e multikulturalizmit konsiderojnë se ky koncept në esencë ka “karakter ndarës” i cili në të vërtetë favorizon një grup të caktuar, në llogari të një grupi tjetër, duke nxitur garë dhe konflikte. Ata, multikulturalizmin e identifikojnë si formë radikale të korrektësisë politike, e cila bie ndesh me principet themelore liberale të cilat kinse i përfaqëson.⁹² Prato, ashtu sikurse edhe shkencëtarët e tjerë, vazhdimisht e vënë në pah faktin se vet Kimlika, edhe pse perceptohet për multikulturalist, madje edhe si baba i multikulturalizmit, përmes veprave të veta vendos së paku një sfidë kur thotë se multikulturalizmi edhe si koncept edhe si projekt politik para së gjithash është konfuz, meqë bazohet mbi ndarjen e paqartë midis “multikulturalizmit” dhe “polietnicitetit”, të cilët i vendos dhe asocon me koekzistencën në njësitë politike të shoqërisë, të cilat në të kaluarën kanë qenë vetëqeverisëse, si dhe

⁹² Prato, Giuliana B., *Beyond Multiculturalism: Views from Anthropology*, Ashgate Publishing Ltd, 2012, f 2.

me migracionin.⁹³ Madje edhe vet Kimlika bën fjalë për sfidën e “multikulturalizmit”, i cili nënkupton ballafaqim me grupet minoritare të cilat e kërkojnë njohjen e identitetit të tyre dhe pranimin e diversiteteve kulturore.⁹⁴ Kimlika, madje konkludon se përkufizimet e multikulturalizmit dhe debati publik në këtë temë vuajnë nga përgjithësimi dhe interpretimi i gabueshëm. Nga aspekti i ditëve të sotme, mund të konfirmohet konkluzioni i Kimlika-s veçanërisht për shkak të faktit se multikulturalizmi shqyrtohet nga çdo aspekt i jetës shoqërore. Në gjysmën e dytë të shekullit XX, analiza e multikulturalizmit fiton dimensione të reja dhe të zgjeruara, meqë ky koncept vendoset “nën thjerrë” nga më shumë aspekte, midis së cilave përmes analizës së faktorit racë, faktorit etnikum, faktorit religjion, faktorit gjini, por edhe përmes analizës së faktorëve të tjerë, midis të cilëve më i theksuar është faktori i orientimit seksual, i cili është tabu temë në një numër të madh të shoqërive, madje edhe në shekullin XXI.

Është me rëndësi të theksoj edhe atë se baza e multikulturalizmit buron nga e ashtuquajturat “të drejta specifike grupe”, ashtu siç i përkufizon Kimlika. Sipas tij, ekzistojnë tre lloje të të drejtave specifike grupe edhe atë: *e drejta e autonomisë*⁹⁵, si element i njohur në të drejtën ndërkombëtare përmes Kartës së Kombeve të Bashkuara, në të cilën qëndron se “të gjithë popujt kanë të drejtë në vetpërcaktim”; *të drejta politike*⁹⁶, si e drejtë e shprehjes së lirë të autenticitetit, pa frikë nga paragjykimet ose nga diskriminimi në shoqërinë ekzistuese; dhe *të drejta të veçanta parlamentare*⁹⁷, përkatësisht një proces politik më reprezentativ, i cili duhet t’i përfshijë pjesëtarët e minoriteteve etnike, me qëllim që të manifestohet diversiteti i popullsisë, si dhe ideja që një numër i caktuar i vendeve në pushtetin ligjvënës të rezervohen për grupet minoritare. Si të drejta specifike grupe këto të drejta janë

⁹³ Ibid, f. 2.

⁹⁴ Kimlika, Vil, *Qytetaria multikulturore: Teoria liberale për të drejtat e minoriteteve*, Instituti për Demokraci, Solidaritet dhe Shoqëri Civile, Shkup, 2004, f. 24.

⁹⁵ Ibid. f. 51.

⁹⁶ Ibid. f. 56

⁹⁷ Ibid. f. 58.

sanksionuar nga e drejta ndërkombëtare dhe e paraqesin konceptin themelor mbi të cilin themelohet mbështetja e multikulturalizmit. Megjithatë, këto të drejta specifike grupore, të perceptuara nga aspekti i kritikëve të multikulturalizmit, njëkohësisht paraqesin matricë për destabilizimin e shoqërive.

Para së gjithash, e drejta e autonomisë së popujve, ashtu siç e përkufizuar paraprakisht, është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me të drejtën e sovranitetit dhe integritetit territorial të shteteve.⁹⁸ Nëse merren parasysh konfliktet e ditëve të sotme, siç është rasti i Kosovës, Tajvanit, Krimesë, Kashmirit, Abhazisë, Osetisë Jugore, madje edhe Baskisë, Vojvodinës, Transilvanisë, mund të konkludojmë se pjesa më e madhe e tyre janë si rezultat i konfliktit midis këtyre dy të drejtave të njohura ndërkombëtarisht. Kërkesa e grupeve të caktuara etnike për shkëputjen e pjesëve të veçanta të shteteve, me qëllim të shpalljes së shteteve të pavarura ose bashkimit me shtete të tjera, e cila mbështetet mbi të drejtën e autonomisë, në mënyrë të drejtpërdrejtë e shkelë të drejtën e integritetit dhe sovranitetit territorial të shtetit. Nga ky këndvështrim, edhe pse është pak e besueshme, nuk do të ishte e papritur nëse meksikanët kërkojnë autonomi në bazë etnike në një pjesë të shteteve në jug të SHBA-ve, apo nëse minoriteti turk në Gjermani kërkon autonomi në pjesë të caktuara të Gjermanisë ku ata janë në shumicë. Nga të tria llojet e të drejtave të përcaktuara grupore, të drejtat polietnike janë më pak kontroverse dhe me vet këtë edhe më të pranueshme dhe të integruara në shoqëritë bashkëkohore. E drejta e shprehjes së lirë të autenticitetit të vet, pa frikë nga paragjykimet ose nga diskriminimi, në shoqërinë aktuale në shekullin XX është përgjithësisht e pranuar në shumicën e shoqërive si shprehje e mirëfilltë e multikulturalizmit dhe vlerave demokratike.

⁹⁸ Shih në Kapitullin 1, Neni 2 (4) nga Karta e Kombeve të Bashkuara – *Ndalim i kërcënimit ose përdorimit të forcës në marrëdhëniet ndërkombëtare*, ku qëndron se ndalohet kërcënimi ose përdorimi i forcës, si dhe thërriten të gjitha vendet anëtare ta respektojnë sovranitetin, integritetin territorial dhe autonominë politike të shteteve të tjera.

Aktualisht edhe pse paraqet temë për një analizë krejtësisht të ndryshme, megjithatë duhet të theksohet se ky lloj i të drejtave më së shpeshti kontestohen edhe nga ekstremistët religjioz, të cilët të drejtat polietnike i shohin si kërcënim për religjionin dhe traditën e tyre, përkatësisht të "vlerave të mirëfillta" mosrespektimin e të cilave e konsiderojnë si përdhosje të fesë së tyre. Kur bëhet fjalë për të ashtuquajturat "të drejta speciale parlamentare", mund të konkludohet se praktikimi i tyre u rrit në mënyrë eksponenciale në shumë shoqëri multietnike, në periudhën pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Edhe pse deri në një masë të caktuar e njohin të drejtën e përfaqësimit reprezentativ të të drejtave etnike në nivel institucional, kritikët e multikulturalizmit gjithashtu e vënë në pah se ky "diskriminim pozitiv" ndikon negativisht diskriminueshëm mbi grupet e tjera etnike, veçanërisht mbi shumicën.

Kur i shqyrton të drejtat kolektive, Kimlika e bën dallimin midis dy llojeve të kërkesave të grupeve, siç janë: "kufizimet e brendshme" të dedikuara që ta mbrojnë grupin nga ndikimi destabilizues i mospajtimeve të brendshme dhe "masat mbrojtëse të jashtme" të orientuara drejt mbrojtjes së grupit nga ndikimi i vendimeve të jashtme.⁹⁹ Nga aspekti i analizës së multikulturalizmit, megjithatë konsideroj se është më i rëndësishëm shqyrtimi i të ashtuquajturave "masa mbrojtëse të jashtme". Në të vërtetë, të drejtat e lartpërmendura specifike grupore bëjnë pjesë në këtë kategori dhe si çdo gjë që është e lidhur me masat mbrojtëse të jashtme, ekzistojnë ithtarë dhe kundërshtarë të tyre. Madje, vetë aplikimi dhe nevoja nga të ashtuquajturat masa mbrojtëse të jashtme varet nga shkalla e integritetit të vet kulturave brenda shoqërisë dhe organikës institucionale të analizuar nga aspekti i përfaqësimit të drejtë dhe promovimit të vlerave multikulturale. Duhet të merret parasysh edhe fakti se masat mbrojtëse të jashtme duhet të analizohen nga aspekti i natyrës së tyre, përkatësisht nëse dhe deri në cilën shkallë ato ndikojnë negativisht mbi grupet e tjera në shoqëri, si dhe mbi shoqërinë në përgjithësi.

⁹⁹ Ibid. f. 63.

Nga kjo që e thash më lartë, konsideroj se multikulturalizmi si koncept dhe aplikimi i tij nga njëra anë më së shumti varen nga mënyra se si i njëjti është vendosur dhe nga ana tjetër, nga mënyra se si ai perceptohet. Dinamika e marrëdhënieve ndëretnike në një shoqëri, si dhe vet struktura organizative institucionale e modeleve të zgjedhura të multikulturalizmit janë faktor themelor në analizën e multikulturalizmit në përgjithësi, bashkë me inkorporimin e tij në vet shoqërinë. Aspekti tjetër i analizës dhe debatit rreth multikulturalizmit gjithësesi se janë çështjet e sigurisë të cilat e diktojnë politikën globale në dy dekadat e fundit, veçanërisht pas numrit të madh të sulmeve terroriste anë e mbanë botës, prej të cilave ndikim më të madh kanë sulmet terroriste mbi Qendrën Tregtare Botërore në Nju Jork, që ndodhën më datë 11 shtator të vitit 2001.¹⁰⁰ Në të vërtetë, perceptimi i "sigurisë së rrezikuar" dhe fokusi i mediave botërore mbi kërcënimin në rritje nga ekstremistët religjioz kishin ndikim të madh mbi rritjen e numrit të kritikëve të multikulturalizmit, të cilët në konceptin multikulturor të "afirmimit të diversiteteve" e perceptuan njërin nga faktorët që janë fajtor për rrezikimin e sigurisë së tyre. Modelet multikulturore të rregullimit kritikohen më shumë, madje janë të shënuar si eksperimente të pasuksesshme, si premisa malinje të cilat e shkatërrojnë shoqërinë apo si ide të cilat edhe pse ndoshta janë mirë të paramenduara, në praktikë janë të pazbatueshme. Në fokusin e kritikëve është multikulturalizmi si mënyrë për promovimin e ndarjes në vend të harmonisë, diversitetit në vend të kohezionit, të ndarjes në vend të solidaritetit.¹⁰¹ Megjithatë, nëse analizohet në nivel global, suksesi i konceptit të multikulturalizmit, multilingualizmit dhe multireligjionizmit nuk mund t'i nënshtrohet përgjithësimit meqë, siç e theksuam paraprakisht në pjesën hyrëse, çdo shoqëri polietnike e cila mbështetet mbi vlerat e multikulturalizmit është unike në ekzistimin dhe karakteristikat e veta. Pranimi i multikulturalizmit dhe vlerësimi i suksesit të tij si model varet nga shumë faktorë, në mesin e të cilëve duhet të theksohet pranimi i diversitetit të

¹⁰⁰ Shih: Chomsky, Noam, 9-11: *Was there an alternative?*, Seven Stories Press, 2011.

¹⁰¹ Shih: Lentin, Alana, Titley, Gavan, *The crises of Multiculturalism*, Zed Books, 201, f.79.

popullsisë si realitet, angazhimi i politikanëve për promovimin e vlerave multikulturore, si dhe vullneti i tyre që multikulturalizmin ta mbështesin si element të qëndrueshëm dhe real për ndërtimin e një shoqërie të drejtë.

Nga kjo që u tha më lart, mund të konkludohet se koncepti i multikulturalizmit vetvetiu nuk mund të vlerësohet pozitivisht apo negativisht, meqë për të njëjtin mund të flitet vetëm në kuadrin teorik. Analiza duhet të fokusohet mbi zbatimin e tij në shoqëri, përkatësisht mbi përcaktimin e asaj se cilat vlera dhe praktika multikulturore janë të aplikueshme në shoqërinë përkatëse dhe kanë potencial ta avancojnë të njëjtën, ndërsa cilat vlera dhe praktika mund të çojnë deri në intensifikimin e problemeve shoqërore dhe të kenë impakt negativ. Përsëri do t'i kthehem konceptit të perceptimit të multikulturalizmit si ADN unike e njeriut. Nëse premisa e pikë - referimit është vendosja e sistemit të suksesshëm multikulturor në një shoqëri, atëherë ai duhet të vendoset në përputhje me ADN e shtetit në të cilin aplikohet, me qëllim që vlerat të cilat i bart me vete të absorbohen natyrshëm në shoqëri, në vend që të flaken nga "organizmi" shoqëror si "trup i huaj".

Liljana Lazarevska
Instituti ResPublika

Liliana Lazarevska
Institute ResPublika

*Modeli i multikulturalizmit në
Republikën e Maqedonisë*

*The Model of Multiculturalism in the
Republic of Macedonia*

Fjalët kyçe: multikulturalizëm, multietnik, multikonfencional, modele të multikulturalizmit.

Key words: Multiculturalism, Multiethnic, Multi-confessional, Models of multiculturalism.

Abstract

Macedonian multicultural society is made up of a few basic elements: ethnic groups, religious groups and globalizing transformations. The authentic model of multicultural society, as it is perceived today, leans on the principles of liberalism and democracy in correlation with historical tradition, the level of its current political and economic development and the impact of the modern globalization process. The Republic of Macedonia, being during the centuries a crossroad of civilizations and melting pot of numerous cultural traditions, has the uniqueness of multi-confessional, multiethnic and multicultural environment, as a cultural, social and political habitat for a model of inclusive democracy. With more than twenty ethnic, religious and linguistic entities, the Macedonian reality heavily depends on the multi-confessional, multicultural and multiethnic coexistence and tolerance, resembling the interlocking and fermented presence in many cultures and influences.

*

Shoqëria multikulturore maqedonase përbëhet nga disa elemente themelore sa vijon: grupet etnike, grupet religjioze dhe transformimet globale. Në këtë kuptim, nëse e marrim se shteti bashkëkohor paraqet bashkësinë politike të qytetarëve të bashkuar pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike, religjioze ose kulturore, atëherë në këtë rast të objektit tonë të interesit flasim për një model specifik të multikulturalizmit në shoqërinë bashkëkohore maqedonase.

Këtu është me rëndësi të theksohet karakteri heterogjen i shtetit maqedonas. Në kuadër të këtij shteti gravitojnë shumë bashkësi etnike të cilat për nga numri i tyre përveç kombit shumicë maqedonas radhiten edhe: shqiptarët, turqit, romët, serbët, vlllehët, boshnjakët etj.¹⁰² Të gjitha këto bashkësi etnike i karakterizon veçoria e kulturave të tyre si dhe tiparet e tyre të veçanta kulturore. Për këtë arsye përvoja historike tregon se një nga determinuesit kryesor në këtë kuptim paraqesin dallimet kulturore të cilat ndikojnë në rrethanat shoqërore dhe politike, ashtu edhe në prapavijën historike që i hasim si faktorët historik integrues ashtu edhe ato çintegrues të cilat i kushtëzojnë varësisht nga situata, zhvillimi ose stagnimi i shoqërisë bashkëkohore maqedonase.

Modeli origjinal, ose thënë më konkretisht ai autokton i shoqërisë multikulturore në kuptimin e sotëm të fjalës mbështetet në parimet e liberalizmit dhe demokracisë të vëna në korrelacion me traditën historike, zhvillimin politik dhe ekonomik dhe nga ndikimet kulturore. Veçanërisht nga pozita e Republikës së Maqedonisë e cila me shekuj të tërë paraqet udhëkryqin e civilizimeve të ndryshme dhe të përvojave të shumta kulturore të cilat e përbëjnë tërësinë e saj në cilën janë gërshetuar karakteri multikonfencional, multikulturore dhe multietnik i shtetit.

¹⁰² Jovanovska, B. Stojmenov, S. *Implementing Multiculturalism: Social Inclusion of Minorities through Decentralization Reforms in Macedonia*, The Western Balkans Policy Review, Vol.1, Jan/Jun, 2010. faqe. 119 Sipas tyre: „Sipas regjistrimit të fundit struktura etnike e popullsisë është : 64,18% Maqedonas, 25,17% Shqiptarë, 3,85% Turqë, 2,66% Romë, 1,78% Serbë, 0,84% Boshnjak, 0,48% Vlllehë, 1,04% te tjerë.“

Edhe pse multikultura e Kimlikut fokusohet në grupet nacionale dhe etnike dhe në këtë mënyrë ai bënë dallimin e dy burimeve të diversitetit kulturor¹⁰³, modeli maqedonas i multikulturës bazohet në radhë të parë në kulturat dhe religjionet e ndryshme, të cilat janë si rezultat i Komonveltit bizantin ashtu edhe të periudhës kulturore dhe sociologjike osmane.

Sipas Ivanka Dodovska: “që të prezantohet zhvillimi i brendshëm i Perandorisë osmane, me theks të veçantë në provincat e saj ballkanike, duke përfshirë edhe të gjitha shtresat e shoqërisë së saj e cila përveç myslimanëve i përfshinë edhe jo myslimanët, është e domosdoshme të kuptohet shkalla e vetëdijes nacionale të këtyre grupeve... jo myslimanët në Perandorinë osmane kanë gëzuar të drejtat dhe privilegjet në kuadër të sistemit osman, tipik për këtë perandori.” Sipas saj, “në fillim të shekullit XIX, në ndikimin e ideve perëndimore për kombet në shoqërinë osmane, gradualisht nisi të ndryshojë edhe kuptimi i sistemit të milletit në kuadër të të cilit nisin të theksohen aspiratat politike të segmenteve të tij etnik, religjioz dhe linguistik, veçanërisht në kuadër të milletit ortodoks nis të theksohet përkatësia etnike”. Për shkak të kësaj: “nga njëra anë sistemi i milletit osman ka luajtur rol pozitiv në krijimin e identitetit fetar dhe gjuhësor të popullsisë jo myslimane, por, gjithashtu, nga ana tjetër sistemi i milletit në shekullin e XIX ka luajtur rol negativ për vetë Perandorinë osmane, duke ndikuar në rënien e saj”. Sipas kësaj ajo konkludon se: “Me vetë faktin se ka mundur ndarjen e shoqërisë osmane në bazë fetare, dhe më vonë edhe në bazë etnike, mileti u bë pengesë serioze në përpjekjet e shtetit t’i integrojë të gjithë të nënshtuarit në një shoqëri të përbashkët.”¹⁰⁴

Në gjysmën e dytë të shekullit XX, më konkretisht pas rënies së ndarjes së blloqeve dhe si pasojë e kësaj me shkëputjen e Maqedonisë

¹⁰³ Will Kymlicka, *Multicultural Citizenship, A Liberal Theory of Minority Rights*, Oxford University Press, Oxford, 1995, *Мультикултурно граѓанство, Либерална теорија за малцинските права*, Institutit për demokraci, solidaritet dhe shoqëri civile, Shkup, 2004, faqe. 25.

¹⁰⁴ Dodovska I. *Размената на малцинства меѓу Кралството Грција и Царството Бугарија и процесот на формирањето на националните држави на Балканот*. Fakulteti Juridik „Justiniani i parë”, Shkup, 2009. faqe. 4.

nga ish RSFJ, në dekadën e fundit të shekullit të XX dolën në dritë sprova të reja të cilat i zgjuan nga gjumi proceset e fjetura historike dhe shkaktuan çrregullime si në tërë regjionin ballkanik, ashtu edhe në realitetin shoqëror dhe politik të Republikës së Maqedonisë. Njëpërmjet Marrëveshjes së Dejtonit¹⁰⁵, deri te Marrëveshja kornizë e Ohrit¹⁰⁶, deri te rezolutat e Kombeve të Bashkuara për Bosnjë e Hercegovinën dhe Kosovën, u bënë përpjekje ndërkombëtare për mbajtjen e nivelit të sigurisë në rajon me ç’rast si qëllim kryesor u bë siguria transatlantike dhe bashkësia mbrojtëse.¹⁰⁷

Të gjitha këto ndikime të jashtme sikurse është integrimi në BE dhe në NATO të të gjitha shteteve të Ballkanit Perëndimor e krijojnë nomenklaturën në kudër të së cilës Republika e Maqedonisë që nga fillimi i mvetësimit u përcaktua për një status të barabartë juridik ndërkombëtar në bashkësinë ndërkombëtare. Në këtë kuptim për më tepër se dy dekada në shoqërinë bashkëkohore maqedonase bëjnë oscilime prioritetet e brendshme dhe ato strategjike. Edhe kjo nuk paraqet veçorinë vetëm për shtetin maqedonas, po kjo ka rëndësi vendimtare atëherë kur diversitetet kulturore bëhen aktuale ose të rrezikshme.

Në këtë kuptim, duhet theksuar se gjatë ndërtimit të sistemit të ri demokratik në Republikën e Maqedonisë, me postulatit e parimeve të demokracisë parlamentare, të drejtave dhe lirive të njeriut si dhe në transformimin e kapitalit shtetëror dhe shoqëror në pronësi private, e shprehën refleksin e vet edhe në aspektet tjera të jetës shoqërore dhe në masë të madhe e kushtëzuan transicionin ekonomik dhe shoqëror tek qytetarët maqedonas. Së këndejmi, duke filluar që nga zgjedhjet e para shumëpartiake parlamentare në vitin 1990, njëpërmjet referendumit për pavarësi në vitin 1991 si shprehje më e dukshme etno-politike të raporteve të shpërndara dhe radikale

¹⁰⁵ Për këtë shih tekstin integral të Marrëveshjes paqësore të Dejtonit <http://cesi.fpn.unsa.ba/wp-content/uploads/2012/12/Dejtonski-mirovni-sporazum.pdf>

¹⁰⁶ Për këtë shih tekstin integral të Marrëveshjes kornizë të Ohrit http://mls.gov.mk/images/dokumentiprikaceni/Ramkoven_dogovor.pdf

¹⁰⁷ Slavevski S. „Интеграцијата на земјите од Западниот Балкан во евроатлантските структури: Прилог кон регионалната безбедност” во *Перспективите на РМ на патот кон НАТО и Европската унија*, Ministria e Mbrojtjes dhe Institutit i studimeve të mbrojtjes dhe paqësore,, Shkup, 2006. f. 202.

ndërmjet grupeve etnike në Republikën e Maqedonisë të krijuar ndërmjet grupit etnik maqedonas dhe faktorit shqiptar në shtet, të cilat i hapën çështjet të cilat që në fillim e prekën karakterin unitar të shtetit bashkëkohor maqedonas.

Për shkak të gjitha këtyre shkaqeve të përmendura, modeli specifik i multikulturalizmit në Republikën e Maqedonisë ndër të tjera shërbeu edhe si faktor integrues gjatë tejkalimit të dallimeve të përmendura si dhe në decentralizimin e strukturës sociopolitike së cilës iu bashkëngjit edhe përpjekja për realizimin e korpusit të të drejtave kulturore të bashkësive etnike. Kjo më së shumti i ngjanë konceptit të shtetit multinacional edhe pse në vete i përmban edhe elementet e multikulturës.

Duke marrë parasysh strukturën multikulturore dhe multietnike të shoqërisë maqedonase, kjo paraqet një formë ndërkulturore, që në vetvete nënkupton prani të shumë kulturave dhe ndikimeve të ndërthurura dhe të fermentuara. Sipas Marjan Stojanov: "Republika e Maqedonisë ka nevojë për multikulturën si koncept, sepse asnjë koncept tjetër nuk mund të funksionojë si ai, për shkak të një varg faktorësh regjional, të jashtëm dhe të brendshëm." Realisht, mendon ai: "Me Marrëveshjen kornizë të Ohrit, Republika e Maqedonisë është obliguar për të ndërtuar një komb qytetar multikulturor dhe politikë multikulturore". Për këto shkaqe, konkludon Stojanov: "multikultura në Republikën e Maqedonisë ka bazë kushtetuese dhe politike"¹⁰⁸.

Duke i marrë parasysh shumë modele të multikulturalizmit, në të cilin i radhisim: modelin e multikulturës qytetare¹⁰⁹, modelin asimilues të integritimit social dhe politik¹¹⁰, variantin

¹⁰⁸ Stojanov, M. *Мультикултурализмот како модел на културна комуникација во современото македонско општество*, IV-AN PRINT, Shkup, 2009. faqe.32.

¹⁰⁹ Ky model i propozuar nga Kimlika ka të bëjë me njohjen e rolit qendror të dimensioneve etnike dhe kulturore në ndërtimin e individëve si genie morale dhe qytetare. Hapsira shoqërore është e ndarë në një zone qendrore "monokulturore" me role të ndryshme marrin pjesë të gjitha grupet dhe në zona të shumta periferike në të cilën çdo grup ka autonominë e vet. Semprini, A. *Le Multiculturalisme, Paris, Presses Universitaires de France, 1997, Multikulturalizam*, Beograd, CLIO, 2004 стр. 114-115.

¹¹⁰ Në këtë model shteti-komb merret si ideal ndërsa pakicat trajtohen ashtu si të gjithë qytetarët dhe ato asimilohen" Stojanov, M. *Мультикултурализмот како модел на културна комуникација во современото македонско општество*, ИВ-АН ПРИНТ, Shkup. f. 35.

regjional të multikulturalizmit¹¹¹, multikulturalizmin ose të ashtuquajturën "nacionalitete kulturore"¹¹², variantin sociokulturor të multikulturalizmit¹¹³, multikulturalizmin partikular¹¹⁴, pluralizmin korporativ¹¹⁵, modelin politik- pragmatik¹¹⁶, multikulturalizmin autonom¹¹⁷, multikulturalizmin përshtatës dhe interaktiv¹¹⁸, është evidente se ai që më së shumti i përshtatet realitetit të shoqërisë maqedonase bashkëkohore është kompozita e pjesës më të madhe të modeleve të përmendura më lartë.

Sipas presidentit të Republikës së Maqedonisë Gjorge Ivanov: "Modeli maqedonas i bashkëjetesës është integrim pa asimilim". Ai gjithashtu thotë se: "Ne asnjëherë nuk kemi praktikuar vetëm

¹¹¹ Sipas Stojanov ky model i multikulturalizmit ka të bëjë me konceptin e demokracisë konsensuale dhe me politikën konsensuale, e cila e garanton trajtimin e barazisë nëpërmjet pushtetit të përbashkët, promovon identitetin (identitetin kolektiv) të pakicave gjuhësore si faktor kyç të politikës nëpërmjet ndarjes territoriale, federalizimin dhe shumë nivele të aranzhmanit të prezantimit politik. Ibid. faqe. 36

¹¹² Modeli i këtyre paraqet theksimin e nacionales dhe veçorive në bazë të përkatësisë etnike.

¹¹³ Ibid.

¹¹⁴ Ibid.

¹¹⁵ Sipas Gordonit tek pluralizmi korporativ grupet racore dhe etnike formalisht njihen si juridike. Glazer, N. and Moynihan, D. *Ethnicity: Theory and Experience*, Harvard University Press, 1975, f.106.

¹¹⁶ Ibid.

¹¹⁷ Joana Fomina (Fomina, 2009:7-8) në shpjegimin e multikulturalizmit autonom mbështetet në Jang (Young, 1990:163) e cila e lidhë në të drejtën për të shprehur tërësisht partikularizmin dhe dallimet. Ajo pohon se "shoqëria e mire nuk i eliminon ose transcedon dallimet grupore. Përkundrazi, diferencimi grupor është aspekt i pashmangshëm dhe i dëshirueshëm i proceseve bashkohore shoqërore. Në këtë drejtim Jang përmend tezën e Shakat (Shachat, 1998:90) se dallimet duhet të promovohen në mënyrë aktive duke u dhënë të drejta speciale kulturave të pakicave me krijimin e të ashtuquajturit ishuj të vetqeverisjes, duke u dhënë mbështetje financiare si dhe me përfshirje zyrtare të identiteteve të ndryshme grupore në kuadrin kushtetues dhe në sferat publike Në këtë mënyrë sipas Jang roli i institucioneve është që të promovojë qëndrueshmërinë dhe respektin për dallimet grupore, që në praktikë, siç thotë Fomin, duke u thirrur në Amatia Sen, rezultojn me monokulturalizëm pluralist që e kundërshton multikulturalizmin e vërtetë të mbështetur në përzierje siç e definon Vertovec (Vertovec, 2006).

¹¹⁸ Multikulturalizmi interaktiv thekson rëndësinë e individit si dhe të komunitetit dhe gjithashtu i thekson përparësitë e dialogut ndërmjet individëve dhe komuniteteve. Kjo teori nisat nga premisa: me shumë mund të fitohet në kuptimin kulturor mënyra e hapur dhe e ndryshme e jetës e cila nënkupton interakcion dhe dialog me individë dhe grupe tjera se sa në kuptimin kulturor e ekzistencës vulnetare. <http://www.cohesioninstitute.org.uk/Resources/Toolkits/InterculturalDialogue/ConceptualFramework/LiteratureReview/InteractiveMulticulturalism>

tolerancë, ne praktikojmë respekt, Asnjëherë nuk i kemi asimiluar dallimet".¹¹⁹

Në këtë kuptim, ky qëndrim ndaj entiteteve të ndryshme etnike dhe kulturore në shtetin maqedonas është i arsyeshëm dhe i pritur, posaçërisht kur kihet parasysh e kaluara e afërt në të cilën kanë ekzistuar paragjykime të vazhdueshme, të cilat siç dihet, janë shkallëzuar me mos tolerancë të hapur ndëretnike dhe në konflikt të armatosur, siç është konflikti i armatosur në vitin 2001.¹²⁰

Në të kaluarën ajo që ishte me ndikim dhe në masë të madhe bënte presion ndaj shoqërisë bashkëkohore maqedonase e hasim të përputhur në përkatësinë etnike dhe religjioze tek qytetarët maqedonas, me ç'rast e njëjta gjë u transferua edhe në veprimin partiak-politik në shtet.

Ajo që është evidente në këtë moment është shndërruar në fakt se integrimi shoqëror në të cilin aktivisht janë përfshirë pakicat nga niveli lokal në ato më të larta në shtet është e arritur nga njëra anë e kuadrit i cili i kushtëzoi ndryshimet në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë pas konfliktit të vitit 2001, ndërsa nga ana tjetër nëpërmjet zhvillimit të shoqërisë civile e cila bëri të mundshëm ndjenjën e përkatësisë së përbashkët në të gjitha elementet që e përbëjnë substratin e konceptit unitar.

Në këtë kuptim është e nevojshme të përqendrohemi më hollësisht në Marrëveshjen kornizë të Ohrit të 13 gushtit të vitit 2001. Në parimet themelore që janë definuar në të bien:

1.1. Tërësisht dhe pa kurrfarë kushtesh hidhet poshtë përdorimi i dhunës për realizimin e qëllimeve politike. Vetëm zgjidhje politike paqësore mund të garantojnë të ardhmen stabile dhe demokratike të Maqedonisë.

¹¹⁹ <http://notesfromthequad.yale.edu/notes/2014-09-27-021500/macedonian-president-gjorge-ivanov-there-no-tolerance-if-there-no-other>

¹²⁰ Për këtë shih më tepër Ilievski Z. *Интегративната теорија на Доналд Хоровиц и нејзината примена во Република Македонија*, Universiteti "Shën Cirili dhe Metodi", Fakulteti Juridik Justiniani i parë, Shkup 2008.

1.2. Sovraniteti dhe integriteti territorial i Maqedonisë dhe karakteri unitar i shtetit janë të pacenueshëm dhe patjetër të mbrohen. Nuk ekzistojnë zgjidhje territoriale për çështjet etnike.

1.3. Karakteri multi-etnik i shoqërisë maqedonase patjetër të ruhet dhe të gjejë shprehjen e vet në jetën publike.

1.4. Një shtet bashkëkohorë demokratik në rrjedhën e natyrshme të zhvillimit dhe krijimit të vet duhet gjithnjë të sigurojë që Kushtetuta e tij tërësisht të plotësojë nevojat e të gjithë qytetarëve në pajtim me standardet më të larta ndërkombëtare, të cilat edhe vetë zhvillohen gjithnjë.

1.5. Zhvillimi i administrimit lokal është me rendësi esenciale për nxitjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në jetën demokratike, dhe për përparimin e respektimit dhe identitetit të komuniteteve.¹²¹

Në këtë kontekst, është evident pohimi i Stojanovit për zbatimin e marrëveshjes të variantit sociokulturor të multikulturalizmit me ç'rast ai konstaton: "Ky model e promovon identitetin e pakicave gjuhësore, duke mundësuar krijimin e institucioneve paralele tek bashkësia etnike shqiptare së cilës i ndahet statusi i barabartë (përkundër ekskluzivitetit) në sferën gjuhësore. Kjo shkakton bi-kulturalizmin në të gjitha sferat e shoqërisë."¹²²

Ajo që është evidente është bërë postulat në faktin se Republika e Maqedonisë posedon pjesë unike inkluzive të demokracisë. Në këtë kuptim ekzistojnë dhjetëra grupe etnike, religjioze e nacionale, që e përbëjnë bashkëjetesën multi-etnike por edhe multikonfesionale. Në kudër të të drejtave dhe lirive universale të cilat si vlera burojnë nga amëza kulturore të ndryshme e përforcojnë dhe njëkohësisht e përparojnë shoqërinë bashkëkohore maqedonase në aspektin e respektimit të refleksive të së kaluarës që kontribuojnë për përparimin e së tashmes dhe të ardhmes të Republikës së Maqedonisë.

¹²¹ Për këtë shih tekstin integral të Marrëveshjes kornizë të Ohrit http://mls.gov.mk/images/dokumentiprikaceni/Ramkoven_dogovor.pdf

¹²² Stojanov, M. *Мультикултурализмот како модел на културна комуникација во современото македонско општество*, ИВ-АН ПРИНТ, Shkup, 2009. f. 39

Në konceptin i cili në vete e ka integruar të kaluarën, të tashmen dhe të ardhshmen në këtë udhëkryq të civilizimeve botërore çilet hapësirë në të cilën implementohen mirëqenia e të drejtave individuale bashkë me inkluzionin e komuniteteve të ndryshme në pluralizëm të shoqërisë, në të cilin është shumë me rëndësi ekzistimi i pluralizmit religjioz. Për këtë shkaqe, edhe njëherë e theksojmë rëndësinë e dialogut ndërmjet komuniteteve në Republikën e Maqedonisë në drejtim të ruajtjes dhe përparimit të parimeve të pluralizmit, demokracisë dhe bashkëjetesës.

Katerina Neshkova

Katerina Neshkova

***Trajtimi mediatik i islamit radikal
si kërcënim për sigurinë***

***Media Treatment of Radical Islam
as a Security Threat***

Fjalë kyçe: mediumet, fundamentalizmi islam, radikalizmi, SHBA.

Key words: media reports, Islamic fundamentalism, radicalism, USA.

Abstract

The interest of this paper is focused on media analysis of world and Macedonian press on the topic "Radical Islam as a security threat". The aspects of phenomenological and ontological wave of media informing about the topics of Islam and its ideology are discussed in this paper. A special review of the method that media treat women in the radical Islam and the informing of the Balkan media on this topic are presented in the paper. At the end a short analysis of the media informing about the most current expression of radical Islam in the Republic of Macedonia is presented in the paper.

*

Bota nuk është e njëjtë që nga 11 shtatori i vitit 2001. Sulmet ndaj kullave binjake në Nju Jork si shembull më drastik të terrorizmit, motivuar nga lëvizje fundamentaliste radikale i ndryshuan të gjitha pikëpamje e deriatëhershme për politikën, taktikën ushtarake, ekonominë, antropologjinë etj., për faktin se cilët janë kërcënimet për botën moderne. Pasi bota më nuk është e njëjtë atëherë me ndryshimet e saj më së shumti përshtaten mediumet. Çështjet e

sigurisë, cenimi i jetës njerëzore pavarësisht në cilën pjesë të botës, posaçërisht nëse kërcënimi na rri mbi krye të gjithëve, gjithsesi se janë tema të titujve të faqeve të gazetave dhe lajmeve kryesore në Ditarët e TV. Aq më shumë kur kësaj i bashkëngjitet edhe religjioni, gjithashtu një e drejtë njerëzore fundamente, atëherë është e qartë përse shumë shpesh mediumet botojnë rrëfime me përmbajtje të këtyllë, pavarësisht për cilin religjion bëhet fjalë që keq (përdoret) nga lëvizjet fundamentaliste gjatë terrorit që ushtrojnë ndaj njerëzve të pafajshëm. Megjithatë është e qartë se vëmendje dhe analiza më të mëdha mediumet i kushtojnë islamit radikal dhe lëvizjes fundamentaliste myslimane që janë me numër më të madh, më të organizuara por edhe më të rrezikshme për sigurinë.

Mbulimi mediatik i çështjeve që lidhen me islamin ka ndryshuar në mënyrë dramatike nga fillimi i mileniumit të ri, si në cilësi ashtu edhe në sasi. Nëse shihet linja kohore e njoftimeve, pastaj termat që i shfrytëzojnë reporterët dhe gazetarët, si dhe përmbajtjen e botimeve gjatë dy dekadave të kaluara shihet se në njoftimet mediatike në raport me fundamentalizmin, islamin radikal, sulmet terroriste ose veprimet antiterroriste, pavarësisht a janë me karakter global ose lokal mund të njihen dy valë (faza) të kumtimeve: valë-fenomenologji, ku mediumet merren me çështje të motivuara kryesisht nga ndonjë ngjarje ose valë-ontologji ku më hollësisht shqyrtohen bazat e predikimit islam të cilat mund të jenë kërcënim për sigurinë.

Vala e parë – fenomenologjia

Vala e parë është shpallja paraprake e rrëfimeve për islamin radikal dhe terrorizmin e inicuar nga “ngjarje kyçe” dhe zgjatë në mënyrë intensive ditët/javët e para pas ngjarjes. Pastaj kjo valë e parë e njoftimeve rreth ngjarjeve me këtë tematikë (pavarësisht se i ka nxitur këto ngjarje: agjenda politike, politika redaktuese e mediumit etj), karakterizohet me mbulesë mediale të karakterit informativ, pa hyrë në tema dhe koncepte religjioze, por vetëm në aspektet politike, gjeopolitike ose të sigurisë. Në to gjithnjë dominon, veçanërisht

theksohet, dëshmohet ose mohohet lidhshmëria: shkak-pasojë ndërmjet ideologjisë fundamentale me faktorët terrorist ose me sigurinë e cenuar. Termat kuç që dominojnë në mediumet të kësaj vale të parë janë islami (myslimanizmi) xhihad (lufta e shenjtë, lufta e drejtë e myslimanëve), sheriati (e drejta myslimane), xhihadistët, muxhahedinët, talibanët, islamistët, ekstremistët islamik etj.

Gjatë dy dekadave të kaluara pothuajse çdo ditë paraqiten zhvillime me përmbajtje fundamentaliste ose të sigurisë të cilat do të motivonin –valë-seri të lajmeve të lidhura me to. Megjithatë ekzistojnë disa zhvillime karakteristike me të cilat fillon interesi masiv (botëror) mediatik për islamin radikal si kërcënim për sigurinë në kuadrin global. Ngjarje e këtyllë është paraqitja e intervistës së parë të Osama Bin Laden dhënë një gazetar të “perëndimit” të shpallur në Si-En-En në mars të vitit 1997.¹²³ Për valën e madhe të paraqitjeve mediatike në temën: islami radikal si kanosje e sigurisë që do të shkaktonte intervista, si momente kyçe paraqiten dy: 1. Shpallja formale e xhihadit¹²⁴ kundër SHBA nga ana e prijësit religjioz, politik dhe ushtarak dhe biznes-pronar para autoriteteve amerikane dhe publikut shumë të madh (milionash) të botës perëndimore dhe 2. Se paralajmërimi për veprim luftarak të grupit që e drejton ku njeri i pasur (tani më është i njohur si Al Kaeda e popullarizuar) në fakt është lëvizje terroriste e cila shfrytëzon një kontekst religjioz për mbrojtje të veprave të veta.¹²⁵

Realisht edhe më parë intervistat e përhershme të Bin Ladenit në të cilat ai thërret në Xhihad kundër Perëndimit ose shfrytëzon ideologjinë

¹²³ Intervista është punuar nga producenti Peter Bergen i cili merret me rreziqet e sigurisë, veçanërisht të Lindjes së Afërt dhe të botës arabe dhe gazetari Piter Arnet, reporter i njohur ushtarak.

¹²⁴ Përveç indikacionit të tërthortë se bëhet fjalë për “luftë të shenjtë” kundër jo myslimanëve me Kuran në botën arabe nuk jepen shpjegime të hollësishme në intervistën për konceptin xhihad.

¹²⁵ Deklaratë e ish përfaqësuesit të CIA-s Braham Fuller në kuadër të kronikës Televizive në intervistë: “Kur ky njeri (mendohet për Bin Ladenin) dërgon mesazhin se do t’i sulmojë SHBA ose thërret në xhihad ai përdor disa terma të qartë islamik nga Kurani me qëllim që të japë bazën legale për veprimin e vet”, (<http://www.youtube.com/watch?v=dqQwnqJA-6w>, në mënyrë intergrale materiali i Si-En-En-it në intervistën e parë të Osama bin ladenit).

fetare dhe terminologjinë fetare që të shpjegojë organizimin e grupeve luftarake, por më shpesh këto intervista janë për servise mediatike në gjuhën arabe, përkatësisht Bin Ladeni i drejtohet publikut të atjeshëm, dhe jo atij që praktikisht i kërcënohet.¹²⁶

Shembull më evident për një valë të këtyllë të parë të mbulimit mediatik të temës janë sulmet e 11 shtatorit të vitit 2001 të dy kullave binjake në Nju Jork. Mediumet në disa muaj të parë në përgjithësi merreshin me vetë zhvillimet: ç'ndodhi, si, kush është përgjegjës, cilët janë reagimet politike për zhvillimet, duke e ndërlidhur qartë Al Kaedën, Osama Bin Ladenin dhe zëvendësit dhe ithtarët e tij, islamin radikal me vetë aktin terrorist. Lidhshmëria mediatike e fundamentalizmit me kërcënimin e sigurisë kryesisht shkonte në linjën që e përcaktonin deklaratat e autoriteteve politike dhe ideologjike, si ato të ish presidentit amerikan Xhorxh Bush¹²⁷ (por edhe të liderëve të tjerë botëror të asaj kohe, veçanërisht të aleatëve të SHBA) dhe deri te vetë mesazhet e Bin Ladenit.¹²⁸

Nga kjo periudhë futet edhe një term i ri që e paraqet luftën globale kundër terrorizmit i nxitur nga fundamentalizmi fetar dhe islami radikal: Lufta (beteja) botërore (globale) kundër terrorizmit ose Koalicioni botëror kundër terrorizmit.¹²⁹ Për herë të parë kjo frazë përdoret nga presidenti Bush në deklaratën e dhënë më 20 shtator të vitit 2001. Pastaj kjo fiton formë institucionale përkatësisht bëhet emërues i fushatës luftarake ndërkombëtare të filluar pas sulmeve

¹²⁶ Shembull, shih intervistën "Osama Bin Laden mohon lidhshmërinë me terrorizmin" Londër Al Kuds Al- Arabi në gjuhën arabe të 9 marsit 1994.

¹²⁷ Fjalimi i Bushit para Kongresit apo kontekstin e locimit të përgjegjësisë për sulmet e 11 shtatorit: "Al Kaeda është për terrorizmin ashtu si është mafia për kriminalitetin. Por qëllimi i saj nuk është të fitojë para, qëllimi i saj është ridefinimi i botës dhe imponimi i bindjeve të saja radikale për njerëzit kudo që janë. Këta terroristë, në mënyrë plotësuese, praktikojnë ekstremizmin formal islamik që është hedhur poshtë nga shkencëtarët mysliman dhe nga shumica e madhe e klerikëve mysliman. Direktiva e terroristëve urdhërojnë për vrasje të krishterëve dhe ebrejëve, të gjithë amerikanëve dhe nuk bëjnë dallim ndërmjet personave ushtarak dhe civilëve, përfshirë këtu gratë dhe fëmijët".

¹²⁸ Nga mesazhi me video i Bin Ladenit të publikuar më 26 dhjetor të vitit 2001: "Ne themi se terrori jonë kundër Amerikanëve është terror i bekuar me qëllim t'i japim fund kësaj robërie, me qëllim që t'i ndalojmë SHBA edhe më tutje të përkrahin Izraelin".

¹²⁹ Në origjinal: WaronTerror (WOT) ose GlobalWaronTerrorism (GWOT).

të 11 shtatorit, të kryesuar nga SHBA, shtetet e NATO-s, si dhe shtetet që s'janë në NATO. Megjithatë edhe administrata e Bushit (administrata e Barak Obamës nga viti 2005 e këtej i shmanget përdorimit të këtij termi¹³⁰), por edhe mediumet perëndimore e përdorin këtë term me kuptimin e luftës globale, të luftës politike, juridike dhe ideologjike kundër organizatave që kanë natyrën terroriste dhe regjimeve të cilët i përkrahin, me fokus të posaçëm ndaj shteteve myslimane të cilat kanë lidhje me organizatat terroriste islamike, si dhe me Al Kaedën ose me organizata me koncept të ngjashëm ideologjik dhe metodologjik të veprimit.

Ngjashëm janë edhe njoftimet nga sulmet e tjera terroriste të lidhura me islamistët, qoftë për ato para 11 shtatorit të vitit 2001 (përkatësisht bombardimet të Ambasadës amerikane në vitin 1998, ose sulmit të parë të Qendrës botërore të biznesit në Nju Jork në vitin 1993), por edhe për aktet terroriste në Bali në vitin 2002, sulmet me bomba në Madrid në vitin 2004, sulmet me bomba në Londër në vitin 2005, sulmet në Mumbaj në vitin 2008, për çka përgjegjësinë e mori ose iu përshkrua Al Kaedës ose celulave të kësaj organizate, përkatësisht si akte të grupeve islamiste.

Valë e këtyllë e fundit tipike "e parë" e njoftimeve është shpallja e Kalifatit nga ana e grupit të vjetër - të ri të Shtetit Islamik më 29 qershor të vitit 2014. Edhe pse dihet dhe shpesh i përmendur në medime është ekzistenca e grupit që vepron në territoret arabe nën emrin: Shteti Islamik i Irakut (ISI)¹³¹ që në vitin 2006, ndërsa nga prilli i vitit 2013 ndryshon dukshëm: Shteti Islamik i Irakut dhe Levantit, domethënë i Sirisë (ISIL ose ISIS)¹³² vëmendja e medimeve si kërcënim për sigurinë e merr pas shpalljes sa Kalifatit.¹³³

¹³⁰ Edhe pse ende ekziston dekoratë ushtarake në Armatën e SHBA me këtë term - medalje për merita në Luftën botërore kundër terrorizmit, original: U.S. military's Global War on Terrorism Service Medal.

¹³¹ Në anglisht: Islamic State in Iraq (ISI).

¹³² Në anglisht: Islamic State in Iraq and the Levant (ISIS).

¹³³ Kur grupi u riquajt vetëm Shtet Islamik - IS, por edhe më tutje në përdorim është akronimi ISIS, diku edhe Isil, veçanërisht në mediumet perëndimore dhe ballkanike.

Tempo të përshpejtuar të shpalljes së lajmeve, analizave, komenteve, intervistave në lidhje me ISIS si kërcënim global për sigurinë nisin kur gjatë shtatorit të vitit 2014 u paraqitën disa video njëra pas tjetrës të prezantuara nga vetë grupi terrorist, ndërsa në të cilat prezantohet heqja e kokës të gazetarëve amerikan dhe humanistëve britanik të rrëmbyer në territorin e Sirisë, Irakut, Afganistanit... si dhe kumtesa e presidentit amerikan Barak Obama për aksionin ushtarak kundër ISIS.¹³⁴ Në këtë mënyrë nisin të shpallen një varg njoftimeve mediatike, ngjashëm me zhvillimet e vitit 2001 për Al Kaedën rreth asaj se ç'është ISIS, si vepron, cilët janë prijësit e tij ideologjik, analiza të shumta gjeopolitike etj.¹³⁵

Vala e dytë – ontologjia

Pas shpalljes së valës së parë me motive mediale fenomenologjike të mbulimit të akteve terroriste dhe të kërcënimeve të sigurisë nisë vala e dytë e njoftimeve. Kjo valë e mbulimit mediatik nga aspekti i kohës zgjatë më shumë se sa vala e parë, bile mund të zgjasë edhe me vite. Kryesisht këto njoftime kanë një qasje më esenciale dhe më përmbajtjesore rreth terrorizimit - islamit radikal. Në këtë fazë njoftimet kanë të bëjnë me shpjegimin e termave religjioz

¹³⁴ Nga deklarata e presidentit Barak Obama ISIL më 9.09.2014: "Du gjëra të jenë të qarta: ISIL nuk është "islamik". Nuk egzistonë religjion që predikon vrasje të njerëzve të pafajshëm. Ndërsa shumica e viktimave të ISIL kanë qënë myslimanë. Edhe ISIL kurrsesi nuk është shtet. Kjo është një filialë e mëparshme e Al Kaedës në Irak që ka fituar përparësinë gjatë konflikteve sektare dhe luftës qytetare në Siri me çrast e okupoj territorin e dy shteteve në kufirin irako-sirian. Ky shtet nuk është pranuar nga asnjë shtet tjetër, dhe as nga njerëzit të cilët i kanë pushtuar. ISIL është thjeshtë organizatë e pastër terroriste... Në një regjion ku ka aq shumë gjakderdhje këta terroristë janë unik në brutalitetin e tyre: ekzekutojnë të burgosur, vrasin fëmijë, ata zbatojnë gjenocid të pakicave fetare..."

¹³⁵ Shih shembullin: 1 "Shteti islamik së bashku me Al Kaedën vlenë si një nga grupet më të rrezikshme xhihadiste pas depërtimit të tij në Siri dhe Irak" (Bi-Bi-Si, 2.08.2014 Siria, Irak Grupi militant Shteti Islamik (<http://www.bbc.com/news/world-middle-east-24179084>), 2. "Sot, ISIS dhe Al Kaeda bëjnë gara me njëra tjetrën se cila nga të ketë kontrollin më të madh ndaj grupeve ekstremiste islame në botë" dhe "faktor më i rëndësishëm për çdo rigrupim të madh të ISIS është konflikti ndërmjet Shiitëve dhe Sunitëve në Irak. Luftëtarët e ISIS më së shumti janë Sunitë, ndërsa tensione ndërmjet dy grupeve të Myslimanëve është vegël e fuqishme për regrutimin e ISIS". Voks, 9.10.2014 "17 gjëra që duhet t'i dini për ISIS-in / ç'është ISIS?" (<http://www.vox.com/cards/things-about-isis-you-need-to-know/what-is-isis>) ose 3. Si-En-En „Fakte të shpeshta për ISIS“, të 9 tetorit të vitit 2014, në formë të linjës kohore të zhvillimeve dhe fakteve të lidhura me ISIS (<http://edition.cnn.com/2014/08/08/world/isis-fast-facts/>), 3.Si-En-En „Fakte të shpejta për ISIS“, 9.10.2014(<http://edition.cnn.com/2014/08/08/world/isis-fast-facts/>).

të myslimanizmit¹³⁶, demistifikimin e disa termave dhe dukurive kuazi fetare, mënyrën e jetës së myslimanit dhe luftëtarëve islamist, mësimet e Kuranit dhe rrymat në Islam, dallimin ndërmjet myslimanizmit si religjion dhe fundamentalizmit dhe radikalizmit islamik si ideologji politike dhe terroriste¹³⁷ e kështu me radhë. Distikcioni ndërmjet religjionit islam dhe islamit radikal si ideologji e terrorizmit veçanërisht është i dukshëm dekadën e fundit, si dhe me rastet e fundit për ISIS-in. Kjo kryesisht ka të bëjë me përshtypjen dhe stigamtizimin që u krijuan pas sulmeve të 11 shtatorit të vitit 2001, se të gjithë myslimanët janë terrorist që gjithsesi nuk është e saktë. Kështu, mediumet iu përkushtuan faktit për të shpjeguar se xhihadi është term dhe koncept i cili e ilustron hendekun e thellë dhe mospasjen e komunikimit ndërmjet botës islamike dhe perëndimore, por ekzistojnë edhe pikëpamje të tilla të cilat nuk mbështeten në predikimet reale islamike të cilat xhihadin e shpjegojnë si zhdukje të popullsisë jo myslimane në emër të Allahut.¹³⁸ Veçanërisht është e dukshme lënia e hapësirës mediatike edhe tek mediumet perëndimore, por edhe në mediumet arabe sikurse Al Xhezeira me letrën e 120 imamëve sunit, hoxhallarë të njohur mysliman në botë për 24 pikat sipas të cilave dallohet ISIS nga Islami (Myslimanizmi¹³⁹). Në këtë valë fillojnë njoftime mediatike të cilat shpjegojnë edhe termat xhihadistë, talibanë, muxhahedinë, ekstremistë islam për të karakterizuar luftëtarët në anën e islamit radikal, veçanërisht rreth faktit se çfarë vlerash kanë, si jetojnë dhe mënyrat se si luftojnë.¹⁴⁰

¹³⁶ Shembull, shih reportazhin e Bi-Bi-Si në shtator të vitit 2009 "Të gjitha aspektet e jetës së myslimanëve janë përcaktuar nga Sheriati" (http://www.bbc.co.uk/religion/religions/islam/beliefs/sharia_1.shtml)

¹³⁷ Ekonomist, prill 2004, "Goditje nga forcat e së keqes" (<http://www.ekonomist.com/node/2610231>)

¹³⁸ Shih shembullin: National Geographic, 24.10.2003, 2003, "Çdo të thotë në fakt xhihadi për Myslimanët?" (http://news.nationalgeographic.com/news/2003/10/1023_031023_jihad.html)

¹³⁹ Shih shembullin 1. Independent, 25 shtator 2014 "ISIS është fyerje për Islamin" (<http://www.independent.co.uk/news/world/middle-east/isis-is-an-offence-to-islam-says-international-coalition-of-major-islamic-scholars-9756255.html>) 2. Al Xhezeira, 7 korrik i vitit 2014. „Liderët mysliman e refuzojnë Kalifatin e Bagdatit" (<http://www.aljazeera.com/news/middleeast/2014/07/muslim-leaders-reject-baghdadi-caliphate-20147744058773906.html>)

¹⁴⁰ Shih shembullin: 1. Si-En-En, 17 tetor 2012, "Cilët janë talibanët e Pakistanit?" – reportazh, (<http://edition.cnn.com/2012/10/17/world/asia/pakistan-taliban-profile/>) 2. IJ Review, 16.10.2014, Londinezët protestojnë në shenjë të shokimit të tyre nga ISIS: Brutaliteti i cili nuk mund të harrohet lehtë, (<http://www.ijreview.com/2014/10/188652-londoners-get-shocking-demonstration-isis-brutality-way-easy-forget/>)

Gruaja në njoftimet për islamin radikal

Në kudër të valës së dytë ontologjike të njoftimeve mediatike për fundamentalizmin islam vend i veçantë i jepet temës: gruaja myslimane. Me këtë rast ekzistojnë dy boshte në të cilat sillen gazetarët që punojnë në këtë tematikë. Njëri bosht është ai që ka për qëllim të prezantojë pikëpamjen e vetë luftëtarëve islamik dhe ideologjinë e tyre për gruan. Njëra linjë e këtij boshti ka qenë posaçërisht e popullarizuar në "ditët më të mira" të Al Kaedës me faktin se motiv për misionet vetëvrasëse të luftëtarëve të saj janë 72 virgjëresha të cilat i presin në xhenet (parajsë). Linja e dytë është që të paraqesë jetën, veshjen dhe vlerat e gruas radikale islame. Për shembull, mbajtja e burkës dhe hixhabit veçanërisht ka qenë e popullarizuar për mediumet evropiane si një rrezik për sigurinë, ndërsa pjesërisht këto njoftime ishin të nxitura edhe nga ndalimet zyrtare të këtij lloji veshjesh.¹⁴¹ Linja e tretë aktuale kohëve të fundit është gruaja luftëtare radikale islame.¹⁴² Linja e dytë megjithatë është ajo që e paraqet gruan si viktimë të islamit radikal.¹⁴³ Edhe këtë bosht mediumet e përpunojnë nga shumë aspekte, por më shumë rrëfime i kushtohen grave të cilat i janë kundërvënë ideologjisë së tillë.¹⁴⁴

Si informohet?

Pa dyshim se nuk ka medium në botë i cili nuk publikon informacione që lidhen me fundamentalizmin fetar, por si bëhet ky informim? A bëhet fjalë për tekste profesionale gazetareske, të bazuara në burime relevante dhe fakte reale? A ndikon politika në prezantimin e

¹⁴¹ Shembull, Rojters, 1 korrik 2014, "Gjyqi evropian e konfirmoi ndalesën franceze për mbulimin e tërësishëm të fytyrës" (<http://www.reuters.com/article/2014/07/01/us-france-burqa-idUSKBN0F63VH20140701>)

¹⁴² Shembull, Al Arabia, 2 shkurt 2014, "Al Kaeda në Siri formon çeta të grave" (<http://english.alarabiya.net/en/News/middle-east/2014/02/02/Syria-jihadist-group-ISIS-forms-women-only-battalions.html>)

¹⁴³ Shembull, Al Xhezeira, 13 tetor 2014, Aktivistët e të drejtave të njeriut thonë: Luftëtarët e ISIL përdhunojnë grate jaside dhe rrëmbejnë fëmijë", (<http://america.aljazeera.com/articles/2014/10/13/isil-yazidi-iraq.html>)

¹⁴⁴ Shembull, Si-En-En, 15 tetor, 2012, "Guximi i një vajze, ndaj quqarëve talibanez" – reportazh për 14 vjeçaren Malala Jusufzai (<http://edition.cnn.com/2012/10/10/opinion/ghitis-malala-yousufzai/index.html>)

islamistëve si të mirë ose të këqij. Pikërisht edhe në paralajmërimin e intervistës së parë të Bin Ladenit në Si-En-En ai paraqitet si luftëtarë për çlirim nga terrori shtetëror, sipas kontekstit lokal, ndërsa si terrorist sipas kategorizimit të qeverisë amerikane.

Mediumet relevante dhe me ndikim, pavarësisht se prej nga vijnë, ose cilit publik i drejtohen, është evidente se informojnë sipas standardeve profesionale gazetareske. Gjithsesi, në radhë të parë duke pasur parasysh rëndësinë e terrorizmit si formë bashkëkohore dhe me i rrezikshëm sipas të cilit rrezikohet e drejta për jetë, por edhe ndikimi i disa forcave të caktuara botërore në politikën e përgjithshme botërore në këtë plan, është i dukshëm ndikimi në paraqitjet publike, që më së shumti shihet nëpërmjet burimeve të cilat përdoren për rrëfime. Mediumet amerikane dhe të Evropës perëndimore të kontekstit lokal apo kohor udhëhiqen nga politika shtetërore për faktin se kërcënimi kundër SHBA është kërcënim për gjithë botën dhe prandaj është e nevojshme: lufta botërore kundër islamit radikal". Informacionet për mënyrën e veprimit ose të kërcënimeve për sulme të reja të Al Kaedës dhe të celulave të saj, të ngjashëm me ato të 11 shtatorit, ose tani të ISIS-it kryesisht këto medime i marrin nga burime të agjencura të njohura ose të panjohura dhe burimeve politike të qeverive të tyre.

Burimisht, mesazhet nga terreni si dhe burimet e drejtpërdrejta nga ana e fundamentalistëve islamik të Sirisë, Irakut, Avganistanit... gjatë luftës me Al Kaedën nga fillimi i këtij shekulli transmetoheshin dhe transmetohen nëpërmjet medimeve në gjuhën arabe. Servisi kryesor mediatik veçanërisht në fillim ka qenë stacioni televiziv Al Xhezeira. Kështu, Bin Laden (sipas linjës kohore e cila bëhej në Si-En-En) me vet-iniciativë iu drejtua opinionit me më shumë se 35 video ose audio mesazhe në gjuhën arabe (mesazhi i parë është më 7 tetor të vitit 2002, ndërsa mesazhi i fundit është i 3 qershorit të vitit 2009). Këto 35 mesazhe, pothuajse 23 u shpallën në mënyrë ekskluzive në Al Xhezeira (e cila është më me ndikim në botë, duke marrë parasysh se ka servise në shumë gjuhë dhe kanale të veta

anë e mbanë botës), ndërsa pastaj janë marrë dhe përkthyer nga mediumet perëndimore. Al Xhezeira thoshte se të gjitha mesazhet të liderit të Al Kaedës i ka marrë përmes dërgesës anonime. Padyshim se shpalljet në mediumet arabe nga aspekti gazetaresk janë përpunuar në mënyrë profesionale, edhe pse në to haset ndërhyrja politike e qeverive të atjeshme lokale. Al Xhezeira, Al Arabia dhe gazeta Al Hajat konsiderohen si medime kyçe arabe. Sipas disa informacioneve ekzistojnë mbi 300 televizione dhe radio-stacione qofshin të karakterit informativ qofshin të karakterit të pastër fetar (islamik). Numri i rritur në mënyrë drastike i medimeve sipas disa analizave ka të bëjë me disa faktorë: Ekonomik - tregu mediatik vlerësohet në 300 milion telespektatorë, social - demokratizimi dhe mediumet e reja, por edhe të konfliktit botëror të botës perëndimore ndaj asaj arabe në kontekst të islamit radikal.¹⁴⁵ Megjithatë, ISIS dhe ndikimi i tij në medime sigurohet krejt ndryshe nga ajo që e bënte Al Kaeda. Në fakt, janë përhapur informacione se ISIS disponon një media-qendër të vetë¹⁴⁶, e cila kontrollon qindra veb-faqe, portale, video dhe audio kanale (kështu janë transmetuar incizimet për heqjen e kokave gazetarit amerikan dhe humanistit britanik), TV servise në internet në shumë gjuhë nëpërmjet të cilave drejtpërdrejtë i dërgon informacionet për vete, pastaj ndërhyjnë islami radikal ose rekruton ushtarë dhe ithtarë nga mbarë bota.

Por, ndikimi i politikave dhe interesave shtetërore në raport me "palën armike" nuk është evidente vetëm në raport me mediumet perëndimore, përkundër medimeve të Lindjes së Afërt. Kjo posaçërisht është e dukshme në informacionet e medimeve amerikane dhe të Evropës Perëndimore për terrorizmin e motivuar nga islami radikal në konfliktet në Rusi me Çeçeni, që nuk mbeten

¹⁴⁵ Më shumë për mediumet me përmbajtje fetare shih analizën: Kanalet satelitore islamike fetare: Ekranet që të çon në xhenet (parajs) nga Muhamed El said, 2009, Rojters Instituti i studimeve të gazetarisë (Universiteti i Oksfordit). (<https://reutersinstitute.politics.ox.ac.uk/sites/default/files/Religious%20Islamic%20Satellite%20Channels%20-%20A%20Screen%20That%20Leads%20You%20To%20Heaven.pdf>)

¹⁴⁶ Guardian, 7 tetor 2014, "Lufta propaganduese e ISIS: Hajtek xhihadi mediatik" (http://www.theguardian.com/world/2014/oct/07/isis-media-machine-propaganda-war?CMP=fb_gu)

imune në marrëdhëniet ndërmjet Ruisë dhe SHBA ose të Ruisë me Evropën perëndimore.¹⁴⁷ Gjithsesi, i pashmangshëm është informimi pothuajse nga të gjitha sulmet terroriste nga islamistët radikal çëqen që kanë ndodhur në këtë pjesë të botës, sikurse janë sulmet me bomba në një banesë të një oficeri rus në vitin 1999, pastaj kriza me pengjet në Teatrin e Moskës në vitin 2002, kriza e pengjeve në shkollën Beslan në 2004¹⁴⁸, sulmet me bomba në Moskë në vitin 2010 dhe bomba në aeroportin në Domodevo ose kërcënimet për sulme të mundshme në Lojërat dimërore olimpike në Soçi në vitin 2014.¹⁴⁹ Më shumë hapësirë mediumet perëndimore i dhanë vetëm dukurisë së paraqitjes së grave-vetëvrasëse të ashtuquajtura të veja të zeza, të cilat i kanë bërë një numër të madh të sulmeve të përmendura më lartë dhe të cilët kryekëput deklarojnë se luftojnë në Emër të Allahut.

Megjithatë edhe informacionet e këtilla për islamit radikal në territoret e ish BRSS nga mediumet perëndimore nuk mbeten imune ndaj marrëdhënieve ndërmjet Ruisë dhe SHBA ose të Ruisë me Evropën perëndimore. (Uashington post, 2 dhjetor 2013, Nuset e Allahut: Kërcënime terroriste nga vejushat e zeza – vetëvrasëse në Lojërat dimërore olimpike: "Që të kuptohen këto gra me bomba-vetëvrasëse të cilat kanë bërë shumë aksione terroriste në Rusi, duhet të shihet prapavija e historisë tragjike të kësaj lufte në rajon. Nxitja e vetëvrasësve duhet të kërkohet në përpjekjen e Çeçenisë që

¹⁴⁷ Shembull, citat nga teksti i botuar në Hafington post më 2 dhjetor të vitit 2013, "Nuset e Allahut: kërcënime terroriste nga të vejat e zeza-vetëvrasëse të Lojrave olimpike dimërore": Që të kuptohen këto gra bombashe-vetëvrasëse të cilat kanë bërë shumë aksione terroriste në Rusi, duhet të shihet prapavija e historisë tragjike të kësaj lufte në rajon. Nxitja e vetëvrasësve duhet të kërkohet në përpjekjet e Çeçenisë që të ndjekë hapat e Ukrainës, Kazakistanit, Armenisë, Lituanisë dhe republikave të tjera sovjetike për shpëtim nga dominimi i Moskës. Në këtë kontekst më pare çëqenët sekular të cilët nuk kanë qenë të njohur për përkushtimin e tyre ndaj stilit saudit të fundamentalizmit islamik, fillojnë të prodhojnë atë që Rusët e quajnë "Bomba të gjalla". (<http://edition.cnn.com/2004/WORLD/europe/09/01/russia.widows/>)

¹⁴⁸ Shembull, Si-En-En, 3 shtator 2004, "Shpërthimi i terrorit të "të vejava të zeza" ruse, analizë e të gjitha sulmeve të deriatëhershme të bëra nga "të vejat e zeza", (<http://edition.cnn.com/2004/WORLD/europe/09/01/russia.widows/>)

¹⁴⁹ Shembull, Euronjuz, 30 shtator 2013, "të veja të zeza" përhapin terror në Rusi (<http://www.euronews.com/2013/12/30/the-black-widows-spreading-terror-in-russia/>)

të ndjekë hapat e Ukrainës, Kazakistanit, Armenisë, Lituaniës dhe republikave të tjera sovjetike për shkëputje nga dominimi i Moskës. Në këtë kontekst më pare çëqenët sekular të cilët nuk kanë qenë të njohur për përkushtimin e tyre ndaj stilit saudit të fundamentalizmit islamik, fillojnë të prodhojnë atë që Rusët e quajnë "Bomba të gjalla".

Konteksti ballkanik - rrëfime ballkanike

Në qendër të njoftimeve për islamin radikal që i japin mediumet botërore janë edhe mediumet tona rajonale të cilat gjatë dy dekadave të kaluara çdo ditë njoftojnë lajme pikërisht për fundamentalizmin islam si kanosje për sigurinë. Mediumet ballkanike kanë fare pak njoftime origjinale për Al Kaedën dhe për celulatat e saj, për aksionet e koalicionit botëror kundër terrorizmit në botën arabe, për informacionet dhe analizat e fundit rreth ISIS, si dhe njoftime për nocionet e lidhura me islamin dhe predikimet islame. Njoftime të këtilla në tërësi ose të pjesshme merren nga serviset mediatike botërore.

Por, nga ana tjetër një pjesë e madhe e njoftimeve për islamin radikal si e keqe që i kanoset paqes kanë kontekst origjinal lokal autentik si askund në ndonjë vend tjetër të Evropës. Kjo gjithsesi ka të bëjë me karakterin multikonfesional të një numri më të madh të shteteve të Ballkanit (kryesisht të krishterë dhe myslimanë) por edhe të pozitës së tij gjeopolitike si kryqëzim rrugësh, ekonomish, politikave dhe kulturave ndërmjet lindjes dhe perëndimit. Myslimanët ballkanik përmes boshtit Sarajevë-Shkup-Stamboll-bota arabe, me shekuj ka mbajtur lidhje rrënjët e predikimit mysliman, prandaj në këtë kuptim bile edhe me lëvizjet dhe pikëpamjet radikale islame. Në të vërtet gjersa paraqitja e islamit radikal në shtetet e Evropës perëndimore është më shpesh nga ardhacakët (emigrantët) nga bota arabe, në Ballkan bëhet fjalë për popullsinë vendase. Kjo gjithsesi shprehet edhe në njoftimet e mediumeve ballkanike. Posaçërisht interesimet e përforcuara mediatike për islamin, për lëvizjet radikale, veçanërisht vehabizmin, islamikët dhe muxhahedinët, paraqiten pas shpërbërjes

së RSFJ dhe informacioneve se në frontet ballkanike në luftimet në Bosnje e Hercegovinë nga fundi i shekullit të kaluar dhe atyre në Kosovë dhe gjatë konfliktit në Maqedoni në vitin 2001, ka pasur islamistë radikal. Dy viteve të fundit, dhe veçanërisht pas shpalljes së luftës globale kundër ISIS, gjithsesi se është përshpejtuar tempi i njoftimeve me këtë tematikë, veçanërisht në kontekstin e paqes dhe stabilitetit në rajon.¹⁵⁰ Në mediume është shprehur fuqishëm linja e njoftimeve për islamistët të cilët kanë shkuar në xhihad në botën arabe dhe faktikisht njoftimet janë nga më të ndryshmet të karakterit informativ^{151, 152}, për islamistë të arrestuar¹⁵³, dhe deri te zbulimi i rrugës dhe mënyra e rekrutimit të luftëtarëve nga regjioni.¹⁵⁴ Mediumet lokale është e qartë se ndjekin politikat zyrtare shtetërore që të qëndrojnë në anën "perëndimore" kur bëhet fjalë për ISIS¹⁵⁵, veçanërisht në pjesën e aksioneve për ndërprerjen e rekrutimit të të rinjve nga regjioni për frontet arabe. Njoftime të këtilla më së shumti shpërndajnë sot mediumet kosovare, shqiptare, boshnjake¹⁵⁶ dhe maqedonase.¹⁵⁷

¹⁵⁰ Shembull, Ballkan magazin, 14 shtator 2014, "Islamistët radikal të Ballkanit" (<http://www.balkanmagazin.net/novosti-i-politika/cid128-98283/radikalni-islamisti-na-balkanu>).

¹⁵¹ Shembull, Slobodna Bosna, 4 tetor 2014, "Dy serbe luftojnë në radhët e xhihadistëve" (http://www.slobodna-bosna.ba/vijest/16684/dvije_srpkinje_u_redovima_dzihadista.html)

¹⁵² Netpres, 23 tetor 2014, "Edhe një shqiptar nga Shkupi është vrarë në Siri", (<http://netpress.com.mk/ushte-eden-albanec-od-skopje-zagina-vo-sirija/>)

¹⁵³ Shembull, Alsat, 17 shtator 2014, "Në Kosovë janë arrestuar shumë imamë", (<http://alsat.mk/index.php/lajme/region/10707-%D0%BD%D0%B0-%D0%BA%D0%BE%D1%81%D0%BE%D0%B2%D0%BE-%D1%83%D0%B0%D0%BF%D1%81%D0%B5%D0%BD%D0%B8-%D0%BF%D0%BE%D0%B2%D0%B5%D1%9C%D0%B5-%D0%B8%D0%BC%D0%B0%D0%BC%D0%B8.html>)

¹⁵⁴ Shembull, Dnevnik, 12 gusht 2014, Lidhja gjermane i dërgon shqiptarët e Maqedonisë në Siri. (<http://dnevnik.mk/?ItemID=590171A951BF024A8B2E94761F96E55A>)

¹⁵⁵ Shembull, Dnevnik, 15 gusht 2014, "Për muxhahedinë dhe mercenarë tek armiqët edhe nga 15 vjet burg" (<http://www.dnevnik.mk/?ItemID=C1C8946EFC53CD42B44363EB05E0C000>)

¹⁵⁶ Slobodna Bosna, 29 shtator 2014, "SB merrë vesh: Në Siri është vrarë një boshnjake, ndërsa është plagosur një kroate" (http://www.slobodnabosna.ba/vijest/16595/sb_saznaje_u_siriji_poginula_bosanka_fatima_mahmutovic_i_ranjena_hrvatica_dora_bilic.html)

¹⁵⁷ Shembull, 1. Netpres, 4 shtator 2014, "Ballkani pastron xhihadistët, vallë vilajet është Maqedonia" (<http://netpress.com.mk/balkanot-chisti-dzihadisti-vireat-li-i-vo-makedonija/>), 2. Dnevnik 12 shtator 2014, "Banorë të fshatit të Shkupit penguan të rinjtë të shkojnë në xhihad në Siri", (<http://netpress.com.mk/balkanot-chisti-dzihadisti-vireat-li-i-vo-makedonija/>)

Islami radikal Maqedonas në të Enjten e Madhe

Mënyra se si mediumet maqedonase e trajtojnë çështjen e islamit radikal si kanosje për sigurinë nuk dallohet nga ajo se si e bëjnë mediumet botërore ose ballkanike në kontekstin lokal. Varësisht nga pesha, zhvillimet botërore dhe ballkanike në këtë temë shpesh janë top-lajmet në televizionet, gazetatat dhe portalet informative të internetit maqedonas. Duke marrë parasysh aspektin ndërjetar (të krishterë dhe myslimanë) të marrëdhënieve ndëretnike (Maqedonas-Shqiptarë) në shtet si dhe faktin se kjo mund të ndikojë në stabilitetin e shtetit, në redaksitë maqedonase ka bile gazetare special që punojnë në këto tema religjioze. Mundësia për islamit radikal dhe sa ai ka depërtuar në Maqedoni trajtohet periodikisht, por pa ndërprerje nga viti 2001 e këndej varësisht nga aktualiteti i çështjes dhe disponimi i informacioneve për këtë temë.¹⁵⁸

Megjithatë, duhet veçuar posaçërisht masakrën e katër djemve dhe një peshkatari tek Liqeni i Smilkovës afër Shkupit, para festës krishtere Pashkët, në Të Enjten e Madhe, më 13 prill të vitit 2012, si ngjarje e cila përveç valës informative tek mediumet, ngriti edhe një qasje serioze dhe analitike të medimeve në lidhje me islamit radikal që vazhdon sot e gjithë ditën. Pas informacioneve fillestare për këtë ngjarje dhe deklaratat e personave zyrtar se bëhet fjalë për akt terrorist¹⁵⁹, mediumat maqedonase nisën me analiza më serioze rreth sigurisë nga kanosjet e fundamentalizmit fetar¹⁶⁰, pastaj rreth asaj se ç'është islami radikal, ku mund të kërkohet në Maqedoni si të njihet e kështu me radhë. Arrestimi i të dyshuarve për rastin në aksionin policor "Monstra" shkaktoi një zhvillim të ri: disa protesta javore të dhunshme nga ana e mijëra Shqiptarëve me ikonografi të

¹⁵⁸ Shembull, Nova Makedonija, 6 korrik 2010, "Një milion evra investime në islamit radikal", (<http://www.novamakedonija.com.mk/NewsDetal.asp?vest=7610955528&id=9&setIzdanie=22026>)

¹⁵⁹ Dnevnik, 1 Maj 2012, "Islamistët radikal gjuajtën në Maqedoni" (<http://www.dnevnik.mk/?ItemID=9B2074ECB33CA946BCD4629A25902542>)

¹⁶⁰ 1. MKD 2 maj 2012, "Maqedonia para kërcënimit serioz nga islami radikal" <http://www.mkd.mk/29095/makedonija/makedonija-radikalen-islam-ubistvo>, 2. Nova Makedonija 3 maj 2012 g., "Gjashtë mijë terroristë islamik i bien kryq e tërthorë Ballkanit" (<http://www.novamakedonija.com.mk/NewsDetal.asp?vest=5312841126&id=9&prilog=0&setIzdanie=22570>)

theksuar fetare kundër vlerësimeve të MPB-së, se bëhet fjalë për islam radikal. Në këtë kontekst, evidente ishin dallimet në analizën se a kanë qenë edhe protestat shprehje e islamit radikal ndër muxhahedinët tek mediumet në gjuhën maqedonase dhe shqiptare. Dallimi i ngjashëm është shënuar edhe na analizat me rastin e aktvendimit gjyqësor për "Monstrën" dhe për procesin gjyqësor.¹⁶¹

Politika zyrtare maqedonase në vazhdim që të jetë pjesë e koalicionit global kundër terrorizmit, në rastin e ISIS sërish i hapi temat për lidhshmërinë potenciale të myslimanëve maqedonas me rrymat radikale të shteteve arabe dhe cili është rroli i Bashkësisë Fetare Islame në këtë. Informacionet e fundit se janë arrestuar imamë radikalë në Kosovë dhe në Shqipëri, si dhe informacionet se një pjesë e xhihadistëve të ISIS me prejardhje nga Ballkani kanë qenë nxënës të hoxhallarëve maqedonas, sërish e hapi temën se a ka BFI kontroll të plotë ndaj objekteve të veta fetare ose ato i kanë marrë rrymat radikale islame.¹⁶²

¹⁶¹ Kurir, 7 korrik 2014, "Analistët: elementet radikale islamiste qëndrojnë pas protestave" (<http://www.kurir.mk/makedonija/vesti/164275-Analiticari-Radikalni-islamisticki-elementi-stojat-zad-protestite>)

¹⁶² Shembull, 1, Dnevnik, 16 gusht, "Kryetari i BFI: Dy xhami në Shkup nuk janë nën kontrollin tonë të plotë" (<http://dnevnik.mk/?ItemID=44A50D119A8C544CBDFD4B09CB2698AF>), 2. Kanal 5, 23 gusht 2014 "BFI nuk kontrollon edhe disa xhami në rajonin e Prilepit-Krushevs". (http://kanal5.com.mk/vesti_detail.asp?ID=46889)

Magjistër Marjan Vučković dhe Xhenur Iseni
Forumi politik maqedonas

MA Marjan Vuchkovikj and Djenur Iseni
Macedonian Political Forum

***Republika e Maqedonisë – roli i bashkësive fetare
në ndërtimin e bashkëjetesës në shoqërinë
bashkëkohore maqedonase***

***The Republic of Macedonia – the Role of Religious
Communities in Generating Cohabitation in
the Modern Macedonian Society***

Fjalët kyçe: Republika e Maqedonisë, bashkësitë fetare,
bashkëjetesa.

Key words: Republic of Macedonia, religious communities,
coexistence.

Abstract

Republic of Macedonia its independence practiced in the period of the nineties, when separating from the Former Yugoslavia. Ten years later, in the Republic of Macedonia appeared interethnic inconsistency which also bore the prefix inter religious, primarily because both of the sides concerned in the conflict although belong to different ethnic and religious groups. Even though it was noted significantly desecration of religious buildings on both sides, in no time the heads of the two largest religious communities in Republic of Macedonia, did not made effort to make joint condemnation of such vandal acts.

The role of the religious communities in the creation of coexistence in the contemporary Macedonian society was large, namely, every religious community helped further in the development of the society, but in two parallel worlds, without mutual help in the process of homogenization of the already divided society along ethnic and religious lines.

*

Periodha e pavarësisë së Republikës së Maqedonisë, në vitet e nëntëdhjeta, ishte një periudhë e stagnimit në planin ideologjik fetar. Gjatë këtij stagnimi kemi një lloj "grevë të zhvillimeve" siç do të shprehej edhe vet Makedonio Fernandez.¹⁶³ Megjithatë greva përfundoi me pavarësinë e shtetit tonë, ndërsa gjithashtu edhe ambicjet religjioze të bashkësive fetare u rritën në mënyrë drastike, si pasojë e situatës së re të krijuar - hapësirë e lirë për funksionim pa pengesa dhe sovran.

Ekspansioni në hapësirën e lirë për veprim të bashkësive etnike, nisi po në atë moment kur nisi edhe demokratizimi i Republikës së Maqedonisë si shtet sovran dhe i pavarur. Maqedonia me hapin e vet përpara drejt pavarësimit filloi ndërtimin e shoqërisë bashkëkohore maqedonase, ndërsa bashkësitë fetare në Maqedoni, në këtë moment fituan shansin për t'u stacionuar sa më afër qendrës së kartës socio-kulturore të shoqërisë sonë.

Megjithatë, kur bëhet fjalë për erërat e para të kohëve moderne në Republikën e Maqedonisë në vitin 1991, në Kushtetutë u distancua qartë Kisha ortodokse maqedonase nga bashkësitë tjera fetare dhe nga grupet religjioze, edhe pse de-jure ato ishin të barabarta para ligjit. Një lëshim i këtille u korigjua në mënyrë plotësuese me Amendamentet e Kushtetutës me numrin VII, ku u barazuan Kisha ortodokse maqedonase me Bashkësinë fetare islame në Maqedoni, Kishën katolike, Kishën evangjelike-metodiste, Bashkësinë ebreje dhe bashkësitë e tjera fetare dhe grupet religjioze të cilat janë të ndara nga shteti.¹⁶⁴

Sekullarizmi i cili është i ndarë qartë edhe në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, paraqet një pjesë të teorisë globale për sekullarizmin i cili ka mundësi të ekzistojë dhe të realizohet realisht vetëm në kufijtë e shoqërive bashkëkohore dhe përparimtare, dhe

¹⁶³ Makedonio Fernandez (Macedonio Fernandez, 1874- 1952, Shkrimtar, humorist dhe filozof argjentinas.

¹⁶⁴ Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.91 e 20.11. 2001.

e cila në vete ngërthen një varg teorish për sekularizmin të cilat nuk mund të hidhen poshtë pa e sjellë në pikëpyetje ekzistencën e funksionalizmit modern shoqëror në shoqëritë bashkëkohore. Si pasojë e kësaj, shoqëria moderne maqedonase e cila nëpërmjet Kushtetutës thekson sekularizmin e shoqërisë, përkatësisht distinktin rigoroz të bashkësive religjioze dhe fetare nga shteti, e vë në pikëpyetje të madhe funksionimin e kësaj shoqërie e cila është pjesë e një rrjeti të shoqërisë ballkanike ku bashkësitë religjioze dhe fetare janë të pranishme në mënyrë permanente dhe janë një nga fundamentet e kësaj shoqërie, ndërsa njëkohësisht, në rastin konkret vetë këto institucione fetare dhe religjioze marrin pjesë në ndërtimin e shtetësisë së Maqedonisë.

Nëse i kthehemi fillimeve të mëvetësimit maqedonas, sovranitetit dhe pavarësisë do të shohim se karakteri bashkëkohor shtetëror maqedonas ka hasur në pengesa të mëdha të cilat kanë kërkuar hapa të mëdha për tejkalimin e tyre. Njëkohësisht edhe vetë Marrëveshja kornizë e Ohrit paraqet një hap të madh në zgjidhjen e një pjese të këtyre çështjeve të ndjeshme. Abreaksioni kolosal i vetë zhvillimeve, përkatësisht gjallërimi ose përjetimi i qëllimshëm ose spontan i dukurive afektive të cilat ishin ngulitur në të kaluarën, dhe të cilat njëkohësisht lidhen me shfaqje dhe përjetime traumatike, e theksuan rolin dhe rëndësinë e institucioneve fetare dhe religjioze, të cilët në ato momente u bënë më të kërkuara që të bëjnë thirrje për paqe dhe bashkëjetese.

Momentet që e karakterizuan periudhën e tensionuar të konfliktit të vitit 2001, paraqesin shembullin klasik për "konfliktin egoist" të llojit të vet, përkatësisht konflikt i cili më së shumti preferonte të shihet dhe të dëgjohet. Konfliktet e këtilla në esencën e tyre kanë për qëllim që të lënë një shok simbolik i cili do të mbahet mend gjatë dhe do të rrefehet. Edhe pse ka shembuj për konflikte të tjerë në vise të ndryshme të botës të cilat kanë rezultuar edhe me më shumë viktima, megjithatë pikërisht këto konflikte nuk kanë shkaktuar aq reagime emocionale me pasojat afatgjate për vetë shoqërinë bashkëkohore maqedonase se sa shkaktoi konflikti në vitin 2001.

Mendimi se shoqëria maqedonase e sapo formuar është para kolapsit që në çdo moment mund të shkatërrohet, paraqet shok-bombë për të gjithë qytetarët e shtetit pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike ose fetare. Sepse frika ishte e barabartë tek të gjithë ne, dhe ajo ishte metoda kryesore e konfliktit dhe e arriti qëllimin e vet që të shkaktojë shok tmerrësisht simbolik i cili do të mbahet mend. Edhe pse bëhej fjalë për konflikt ndërmjet dy strukturave etnike dhe fetare të ndryshme, megjithatë realiteti është se aspak nuk bëhej fjalë për përleshje etnikumesh, religjionesh ose të institucioneve fetare.

As etnikumi maqedonas nuk ndjehej i gatshëm për një lloj të këtillë të konfliktit, dhe as etnikumi shqiptar nuk ishte i disponuar për një mënyrë të këtillë të zgjidhjes së problemeve. Në asnjë moment Bashkësia Fetare Islame nuk i "shpalli luftë Kishës ortodokse maqedonase", dhe as islami nuk u çua në kryengritje ndaj të krishterëve. Megjithatë këto ishin koncepte të elitës për ndarjen e pushtetit që pasojat e tyre afatgjate ndjehen edhe sot.

Së këndejmi, me rëndësi është të theksohet se Kisha ortodokse maqedonase – Kryepeshkopata e Ohrit, është bashkësia më e madhe fetare në Maqedoni. Ashtu si përmendëm edhe më herët, deri në ndryshimet me Marrëveshjen kornizë të Ohrit, ajo ishte bashkësi e vetme fetare që përmendej në Kushtetutë, ndërsa prezantonte 65% të popullsisë së përgjithshme në Maqedoni sipas të dhënave të Entit shtetëror të statistikave të vitit 2004¹⁶⁵. Nga ana tjetër, Bashkësia Fetare Islame është e dyta për nga madhësia bashkësi etnike në Maqedoni dhe si e tillë përfaqëson 33% të popullsisë së përgjithshme sipas statistikave¹⁶⁶, ndërsa i prezanton myslimanët në Republikën e Maqedonisë, etnikumin shqiptar, etnikumin maqedonas, etnikumin rom, etnikumin boshnjak etj.

Praktika për identifikimin etnik dhe fetar dhe simbioza e këtyre

¹⁶⁵ Enti shtetëror i statistikave (2004). Regjistrimi i popullsisë, amvisërive dhe bane-save në Republikën e Maqedonisë, Libri X. Shkup, faqe 334 <www.stat.gov.mk >

¹⁶⁶ Ibid.

dy përcaktimeve, përkatësisht njësimi i përkatësisë etnike me etnikumet u multiplifikua dhe u gjeneralizua, me ç'rast u fitua përshtypja se të gjithë përfaqësuesit e etnikumit maqedonas janë të krishterë dhe të gjithë pjesëtarët e etnikumit shqiptar, rom, boshnjak dhe turq janë mysliman. Një njësim i këtillë i përkatësisë fetare me përkatësinë etnike, krijoj huti që i detyruan institucionet shtetërore të polarizohen dhe shpesh të vijnë në situatë që t'u drejtohen vetëm pjesëtarëve të vet fetar edhe pse gjatë veprimit të këtillë qartë e përjashtojnë sulmimin e tjetrit. Kështu shpesh mund të hasen se si përmes medimeve nacionale përfaqësuesit e të dy institucioneve të mëdha fetare iu drejtohen besimtarëve të vet, duke dërguar kështu mesazhe të llojit të vet për durim dhe paqe. Megjithatë, është shumë i vogël bashkëpunimi i hapët ndërmjet këtyre institucioneve i cili mund të ishte shprehur përmes projekteve reale për bashkëpunim reciprok dhe do të kontribuonte për përforcimin plotësues të mirëbesimit ndërmjet përfaqësuesve të këtyre dy institucioneve, që gjithashtu, me suport hierarkik ky bashkëpunim do të zgjerohej në të gjitha nivelet deri te besimtarët. Një korrespondencë e këtillë ndërmjet besimtarëve të feve të ndryshme dhe grupeve etnike, shumë shpesh është vërejtur tek institucionet e sektorit civil, nëpërmjet projekteve të ndryshme duke provuar të "shkrijnë akullin" dhe të tregojnë se nuk ka asgjë të gabuar në korrespondencën ndërmjet grupeve religjioze dhe etnike në Republikën e Maqedonisë.¹⁶⁷

Rasti me Republikën e Maqedonisë, sipas profesor Sllavevski, ku përparimi i tolerancës etnike dhe veçanërisht fetare është mjaftë me rëndësi gjithashtu i theksojmë edhe shumë iniciativa të cilat nxisin bashkëpunim intensiv i cili shpie në forcimin e integritimit, harmonisë dhe respektimit reciprok të kulturave dhe religjioneve të ndryshme. Në vendin tonë ekzistojnë etnikume të ndryshme që e pranojnë dialogun si medium më homogjen për realizimin e tolerancës etnike dhe religjioze dhe respektimin e gjerë të universales dhe

¹⁶⁷ Këtu është me rëndësi të theksojmë rolin aktiv në zhvillimin e dialogut ndëretnik dhe ndërfeetar nga ana e Fondacionit Konrad Adenauer në Shkup http://www.tolerancijadijalogsorabotka.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=114&Itemid=69&lang=mk

humanizmit. Lirisht mund të vërejmë se pikërisht diversiteti kulturor dhe religjioz i Republikës së Maqedonisë paraqesin burimin e potencialit të madh kreativ dhe urën drejt mirëkuptimit, respektimit dhe bashkëjetesës.¹⁶⁸

Grupet religjioze në esencën e tyre bëjnë thirrje për paqe, tolerancë dhe respektimin e tjetrit, me çka mund të kontribuojnë dhe në ndërtimin e shoqërisë multikulturore. Nga ana tjetër mosrespektimi dhe manipulimi me ndjenjën fetare veçanërisht mund të shpie në konflikt. Gjithashtu, konflikti mund të nxitet edhe nga marginalizimi i ndjenjave fetare dhe ngulfatjes së tyre që mund të evoluojë në shpërthimin e ndjenjave dhe emocioneve të cilat më vonë mund të dalin në sipërfaqe. Nga një gjë e këtillë qartë mund të rezultojë fakti se në asnjë moment, nevoja e nxitur nga instinkti për vdekje ose për destruksion të tjetrit duhet të bëhen efektive në realitet, edhe pse ato janë si pasojë e rritjes së aftësisë së një grupi të caktuar dhe dëshira që po ajo dëshirë të shkatërrohet nga ana e grupit tjetër.

Gjithashtu, komunikimi ndërfeetar në tërësi investon në ndërtimin e mirëkuptimit i cili duhet të bazohet në respektimin universal të dinjitetit njerëzor dhe të drejtave të përcaktimit etnik dhe fetar. Komunikimi i rregullt reciprok është parakushti më i rëndësishëm i mirëkuptimit reciprok dhe kontribuon për parandalimin, përkatësisht tejkalimin e moskuptimit i cili në mënyrë potenciale mund të paraqitet ndërmjet grupeve religjioze dhe etnike. Komunikimi ndërfeetar mund të ndihmojë që të zëvendësohen stereotipat dhe paragjykimet me përvoja reale, ku besimtarët e feve të ndryshme do të njësoheshin së pari me postulatet e religjioneve të tjera dhe do t'u mundësohet të njohin atë që më parë për to ka qenë "e huaj", ajo që më parë ka qenë mistike ose tek e fundit etiketim si diçka nga e cila duhet pasur kujdes.

Ajo që është shumë e rëndësishme dhe që duhet të përmendet, është se mosdurimi fetar nuk do të ishte asgjë tjetër përveç parasupozim

¹⁶⁸ Kolumnë e profesor Stojan Slavevski për Nova Makedonija, nr, 23259, të 26-08-2014, e kapshme në: <http://www.novamakedonija.com.mk/NewsDetal.asp?vest=82614935322&id=13&setIzdanie=23259>

se është evidente dukuria e prishjes së objekteve fetare duke shkruar grafite. Injorimi mediatik i një problemi të këtillë me kalibër të vogël gjithsesi se nuk do të pengonte në eliminimin e mëtejshëm të këtij fenomeni. Por, problemi paraqitet në momentin kur gjërat e këtilla lokale do të shpërthejnë në kanalet televizive dhe do të eksplodojnë si shok-bomba emotive.

Për këto shkaqe, konsiderojmë se informimi mediatik është nyja kryesore në ndërtimin e një shoqërie bashkëkohore, përfshirë edhe atë maqedonase dhe prandaj duhet të pranohet si e tillë. Transmetimi i informacionit për cenimin e objekteve fetare, gjithsesi nuk duhet të fshihet nën qilim por një informacion i tillë duhet të transmetohet qartë dhe me zë në medime, dhe njëkohësisht, ai duhet të ndiqet me deklaratë të përbashkët, pres- konferencë ose me qetësim simbolik ndërmjet drejtuesve të të gjitha bashkësive fetare, ku kjo ngjarje do të dënohet publikisht. Një bashkëpunim i këtillë gjithsesi do të tregojë se liderët fetar janë të qartë dhe konsistentë ndaj njëri-tjetrit dhe se çdo incident i lidhur me çfarëdo grupi fetar ose religjioz do të thotë fyerje për të gjithë. Në këtë mënyrë, do të kontribuohet edhe më tepër në destimulimin, por jo në çrrënjosjen e konflikteve të mëtejshme ndërfitare, të cilat shpesh janë kapsulë nxitjeje për "luftëra religjioze minore" brenda shoqërisë.

Duke bërë një rezymë rreth asaj që u tha më lartë mund të përfundojmë se Republika e Maqedonisë mvetësimin dhe pavarësinë e saj e përjetoi në vitet e nëntëdhjeta gjatë shpërbërjes së RSFJ. Vetëm dhjetë vjet më vonë në Republikën e Maqedonisë u manifestua konflikti ndëretnik i cili gjithashtu mbante edhe etiketimin e konfliktit ndërfitar, në radhë të parë sepse të dyja palët në konflikt përveç se i takojnë dy grupeve të ndryshme etnike, ato gjithashtu u takojnë edhe dy grupeve religjioze. Edhe pse ishte evident shkatërrimi i objekteve religjioze nga të dyja palët gjatë periudhës së konfliktit në vitin 2001, megjithatë në asnjë moment krerët e dy bashkësive më të mëdha fetare në Republikën e Maqedonisë, nuk dolën me paraqitje dhe dënim të përbashkët të akteve të këtilla vandale.

Roli i bashkësive fetare në ndërtimin e bashkëjetesës në shoqërinë bashkëkohore maqedonase ka qenë i madh, faktikisht, çdo bashkësi fetare dhe religjioze gjithashtu e ndihmonte zhvillimin e shoqërisë, por në dy botëra paralele, pa ndihmuar në këtë rast bashkërisht në homogjenizimin edhe ashtu të ndarë të shoqërisë bashkëkohore maqedonase në linjë etnike dhe religjioze.

Qasja e këtillë e bashkësive religjioze, vazhdoi edhe më tutje pas përfundimit të konfliktit, ndërsa qasja e këtillë është evidente dhe në tërësi pengon procesin e zhvillimit të përbashkët të shoqërisë bashkëkohore maqedonase multietnike dhe multikonfesionale.

Nga këto shkaqe konsiderojmë se vetëm me angazhim të shtuar për paraqitje të përbashkët të bashkësive fetare dhe me mbulim mediatik të tyre, mund të arrihet përparim në këtë sferë dhe të ndihmohet zhvillimi i shëndetshëm i shoqërisë bashkëkohore maqedonase nga ana e bashkësive fetare dhe religjioze që funksionojnë në territorin e Republikës së Maqedonisë, ndërsa frytet e tyre do të jenë në dobi të të gjithëve.

PËRFUNDIM

Kuptimi konceptual i këtij projekti akademik ka të bëjë me një ndërtim të veçantë komplet historik si dhe me përmbajtje filozofike - juridike dhe politike - sociologjike dhe të mbrojtjes, gjë që për tu kuptuar sa më lehtë rreth asaj që u munduam të theksojmë me këtë projekt, është e nevojshme të përpunohen shumë vëllime me të cilat do të arrihet deri në përfundimet e tërësishme dhe me të cilat po e njëjta do të mund të konstatohej njëherë e përgjithmonë se është e mbyllur. Mirëpo, qëllimi ynë që nga fillimi nuk ka qenë që të mbyllim pyetjet më të rëndësishme me të cilat jemi marrë, por po të njëjtat pyetje ti hapim në mënyrë serioze.

Për këto arsye, me këtë hulumtim përveç asaj që në mënyrë të përpiktë janë përpunuar postulatet themelore të materialit teorik, me atë në të njëjtën kohë janë parashtruar edhe disa pyetje themelore si dhe dilema të cilat kanë të bëjnë me këtë temë shoqërore shumë aktuale. Kështu, Ivan Ivanov në punimin e tij i cili e përpunon temën: "Roli i shoqërisë qytetare në botën bashkëkohore - me një kahe të veçantë në Republikën e Maqedonis", do të konstatojë se: "në vend të qytetërimit dhe demosit kemi kthim në primordialen përkatësisht elemente të gjendjes parapolitike", prej këtu sipas tij: "shoqëria civile si një paradigmë premtuese, e cila duhej të paraqet lidhje në kalimin prej rregullimit autoritar dhe totalitar drejt demokracisë, sot ka ngecur në një formë specifike të burokratizimit ose NGO-izimit, e cila në esencë ia merr forcën jetësore, zbulimin dhe kreativitetin". Për këto arsye për ne ishte interesante që ti kthehemi edhe zhvillimit historik të rajonit të Evropës Juglindore me qëllim që të detektojmë format e të shprehurit religjioz në periudhën prej shekullit XIX deri më sot. Në këtë pikëpamje ka punuar Stanislav Cvetkovski, i cili mbas analizës më të hollësishme ka konstatuar se: "Me sa duket shkëndijat e reja për të ndezur aspiratat fundamentale në Evropën Juglindore janë të shumta, ndërsa ne këtu kemi përfshirë vetëm sipërfaqen e tyre. Mirëpo ajo e cila mbetet thelbësore është e përfshirë në faktin se prezenca e tyre paraqet kërcënim serioz për sigurinë e rajonit, e udhëhequr nga ndodhitë në botë si dhe hovi

i fortë i lëvizjeve ekstremiste". Në bazë të këtyre përfundimeve, Sara Al Bander dhe Martin Buzallkovski fokusin e përqendrimit të tyre e kanë orientuar drejtë analizës të kuptimit të poentës dhe karakteristikave thelbësore të fundamentalizmit islamik. E gjithë kjo padyshim ka futur nevojën që në këtë hulumtim të përpunohen edhe pyetjet themelore si dhe sfidat që i sjellë modeli i multikulturalizmit. Në këtë temë znj. Ivana Atanasoska do të konstatojë se: "Derisa qëllimi fillestar është vënia e sistemit të suksesshëm multikulturor në një shoqëri, atëherë ai duhet të jetë i vendosur në përputhje me ADN-ën e shtetit në të cilin aplikohet, me qëllim që vlerat të cilat i bartë me vete të jenë të absorbuara në mënyrë natyrale në shoqëri, në vend se të hidhen prej "organizmit" shoqëror si një "trup i huaj". "Për shkak të specifikave të nivelit regional, në këtë temë lidhet edhe hulumtimi i Liljana Lazarevska e cila iu drejtua modelit të multikulturalizmit i cili është specifik për Republikën e Maqedonisë, ndërsa Katerina Neshkova ka hulumtuar në temën "Tretmani i medimeve të islamit radikal si një kërcënim sigurie" në nivel global dhe atë rajonal. Në fund pikëpamje të tyre për rolin e bashkësive fetare në ndërtimin e shoqërisë bashkëkohore maqedonase, kanë dhënë m-r Marjan Vučković dhe Xhenur Iseni, të cilët kanë përmbyllur pjesën teorike të hulumtimit me konstatime të caktuara si dhe sugjerime lidhur me bashkësitë fetare, të cilat janë të rëndësishme për përparimin dhe zhvillimin e tolerancës mes religjioneve në Republikën e Maqedonisë.

Duke marrë të gjitha shtatë punimet akademike në tërësi, mund të konstatojmë se për nga aspekti i konfigurimit kulturor në botë pas dy luftërave botërore, si dhe njëkohësisht duke u nisur nga qëndrimi i Hantingtonit se civilizimi paraqet entitetin më të gjerë kulturor, është e evidente se politika globale në çdo kuptim fiton një konfigurim të ri përgjatë gjatësive të kufijve kulturore. Duke shkruar në këtë drejtim edhe Pol Berman do të konstatojë se: "Shoqëritë liberale si dhe idetë liberale kanë përparuar përgjatë shekujve të fundit..."¹⁶⁹ Ky përparim më së fortë e ndjejmë prej kohës të sistemit të Versajës nga viti 1919, kur filluan edhe në praktikë të transformohen, edhe pse

¹⁶⁹ Pol Berman, Terrori dhe liberalizmi, Euro-Balkan Press, Shkup, 2005. faq.15.

për një periudhë jo aq të gjatë, matricat ideologjike dhe politike në planin global, për të njëjtat me një hov të përshpejtuar të rindërtohen mbas luftës së dytë botërore, ndërsa në rajonin e Evropës juglindore, po të njëjtat të bëhen aktuale në veçanti mbas shkatërrimit të perdes së hekurt në dekadën e fundit të shekullit të kaluar.

Gjithashtu vetëm se e kemi theksuar se epoka sekulare në shoqëritë e zhvilluara konstaton lidhjet historike individuale, të cilat janë thellë të ngulitura në matricën ideologjike të çdo shteti nacional në botë, në secilin rajon gjeopolitik dhe gjeostrategjik dhe në fund në çdo individ më vete. Në këtë aspekt, ky përfitim liberal, u tregua se posedon dy fytyra, gjegjësisht i njëjti nga njëra anë dhe në epokën e re vazhdoi të mbrojë bindjet personale si dhe qëndrimet e qytetarëve, ndërsa nga ana tjetër po të njëjtat i kundërshtoi njëra kundër tjetrës, duke shfrytëzuar mekanizmat e lirisë të bashkimit e cila përfshin edhe atë të shoqërive dhe grupeve religjioze. Ky mekanizëm la hapësirë në suaza të kësaj sfere të keqpërdoren liritë e përfituara si dhe të drejtat përmes së cilave para neve qëndron rreziku prej zhvillimit dhe zgjerimit të terrorizmit internacional, mu në bazë të synimeve liberale të cilat bëhen mbërthesa mbi të cilën deformohet e kaluara religjioze historike me qëllim që të kryhet ndikim dhe të mblidhen pasues me anë të së cilës në ardhmëri kërcënohet shoqëria liberale dhe shteti i qytetëruar.

Në këtë kontekst është evidente se Republika e Maqedonisë si një shtet i pavarur dhe sovran, mbas zgjedhjeve të para shumëpartiake në vitin 1990, ka kryer ndryshime të sistemit të tërësishëm politik dhe shoqëror. Përveç transformimit të brendshëm, Republika e Maqedonisë në të njëjtën kohë ka filluar edhe procesin e njohjes ndërkombëtare. Duke marrë hapat e mëdha historike, si dhe përgjegjësitë për formimin e shtetit në planin e brendshëm, ajo që nga fillimi i pavarësisë u gjet në kushtet e veçanta specifike në të cilin zhvillohej ky proces i rëndësishëm i tranzicionit në hapësirat e federatës së mëparshme të Jugosllavisë. Tërësia e gjasave që e kaplonin, është e qartë se në periudhat e kaluara të këtyre dy dekadave e kanë vendosur shoqërinë bashkëkohore maqedonase si

dhe shtetin e Maqedonisë para shumë sfidave të reja në të njëjtën kohë duke shtjelluar edhe sëmundjet e vjetra si dhe fatamorganat e të kaluarës.

Para së gjithash, Republika e Maqedonisë sot si dhe para një shekulli ballafaqohet me çështjet të cilat janë të lidhura me prejardhjen, identitetin si dhe gjuhën e popullit shumicë maqedonas nga ana e fqinjëve të saj. Në veçanti është karakteristike çështja rreth emrit për Republikën e Maqedonisë të cilën e ka ngritur Republika e Greqisë që prej viteve të para prej shpalljes të pavarësisë të shtetit të Maqedonisë. Kjo çështje padyshim ka ndikim të madh edhe në nivelin ndërkombëtar, për shkak të jostabilitetit dhe jointegritimit të Republikës së Maqedonisë në aleancën e NATO-s si dhe në Bashkimin Evropian, gjë që në mënyrë strategjike dhe të qartë i tërheq edhe kombet tjera të Gadishullit ballkanik në mundësinë e konflikteve dhe gjeneron jostabilitet të cilat nuk janë në favor të politikës paqësore të evropintegritimit.

Edhe pse na është e qartë se çështja maqedonase është akoma një temë aktuale e lidhur në veçanti me të kaluarën, ndërsa po të njëjtën e shohim prej negacionit grek të së drejtës për vet-përcaktim, si dhe përmes mohimit bullgar për pavarësinë e identitetit nacional maqedonas si dhe gjuhës, më tutje përmes qëndrimit të kishës ortodokse serbe (SPC-KPS) për mos pranimin e autoqefales të Kishës ortodokse maqedonase, si dhe deri te aspiratat e mëdha shqiptare për krijimin e Shqipërisë së madhe.

Për shkak të gjitha këtyre faktorëve, është me rëndësi të potencohet se Republika e Maqedonisë si një pjesë e Ballkanit perëndimor bie mes shteteve në të cilat më dominuese janë religjioni krishterë dhe ai islam. Në suaza të këtyre dy shtyllave religjioze e gjejmë edhe çelësin për paparandalimin dhe pengimin e urrejtjes religjioze dhe racore, posaçërisht duke u nisur nga aspekti i karakterit thelbësor të religjionit, në kuptimin e korigjuesit moral dhe mediatorit për tejkalimin e paragjytimeve dhe propagandimin e paqes dhe tolerancës mes njerëzve.

Dhe për në fund është e rëndësishme të theksojmë se në kushtet e rrjedhave të globalizimit shoqëror, politik, religjioz dhe kulturor, është evidente rritja e alienacionit shoqëror, mosdurimit mes dallimeve si dhe prezencës gjithnjë e më të madhe fundamentalizmit religjioz. Këto gjendje janë nën ndikim direkt prej krizës të vlerave morale si dhe të mundësive ekonomike të cilat kanë një rol të rëndësishëm ndaj ndërtimit të qëndrimeve dhe perceptimeve, në veçanti të rinjtë.

Për shkak të gjithë këtyre faktorëve të ndikimit, bëhet e patjetërsueshme që në vazhdimësi dhe me përkushtim të punohet si në aspektin teorik dhe atë praktik në ngritjen e vetëdijes për rreziqet dhe dëmet të cilat i sjellin krizat moderne në planin global, me çka do të mundësohet zhdukja e rreziqeve potenciale të cilat i kaplojnë në veçanti qytetarët e rinj. Në këtë aspekt është e rëndësishme të theksohet ndikimi i faktorëve edukativ dhe religjioz në shtet, si dhe ndikimi i medimeve, të cilët mund të japin kontribut të rëndësishëm në ndërtimin e dialogut religjioz dhe atij etnik.

Doc.dr. Ivanka Dodovska

PUNIM

*Doc.dr. Oliver Andonov dhe
doc.dr. Ivanka Dodovska*

ANALIZË E RADIKALIZMIT RELIGJIOZ SI MJET I RADIKALIZMIT POLITIK- PERCEPTIM I NIVELIT TË NDIKIMIT DHE KËRCËNIMI NDAJ SIGURISË NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

Hyrje

Llojet e ndryshme të sjelljes radikale dhe zbatimi pragmatik i radikalizmit në themel kanë si qëllim të ndikojnë në realizimin e kërkesave politike. Në përgjithësi të gjitha grupet politike të cilat orientohen për të realizuar qëllimet e veta në kushte të caktuara e shfrytëzojnë radikalizmin si mjet politik.

Intensiteti i manifestimit të radikalizmit të ndryshëm dhe rrënjësia e tij në strukturat shoqërore, përvojat historike dhe kushtet aktuale për shkallëzimin e tyre, kushtëzojnë se në cilin nivel do të përdoren në pragmatizmin politik. Grupet politike të cilat në ideologjinë e tyre kryesore dhe platformën politike shprehin radikalizëm politik ose ekskluzivitet, autoritaritet ose tendenca totalitare, nuk kanë problem me përdorimin e të gjitha llojeve të radikalizmit në të gjitha nivelet. Me këtë rast, radikalizmi politik i nxitë llojet e tjera të radikalizmit duke i shfrytëzuar për realizimin e platformës së vet politike.

Përdorimi i radikalizmit përveç ndikimit që ai ka nga ana e radikalizmit politik për qëllime të tij, varet edhe nga perceptimi i cili krijohet tek qytetarët e shtetit, dhe që ka të bëjë me nivelin e kërcënimeve.

Në këtë kontekst radikalizmi religjioz ka rol mjaft të madh të theksuar. Ky rol në Republikën e Maqedonisë është i ndërlidhur me perceptimin

e përkatësisë religjioze dhe lidhshmërinë me përkatësinë etnike. Një tendencë e këtillë është kryesisht e pranishme në tërë rajonin, dhe kjo ka të bëjë me varshmërinë e fortë historike ndërmjet identitetit religjioz dhe atij etnik me ç'rast në rajon identitetet nacionale bazat e veta i kanë në identitetin religjioz.

Kjo qasje e ndërvarësisë të identitetit nacional me përkatësinë religjioze i lidh edhe më shumë radikalizmin religjioz dhe radikalizmin etnik, dhe me këtë edhe radikalizmi politik posedon dy mjete të lidhura njëri me tjetrin për realizmin e qëllimeve të veta.

Lidhshmërinë me perceptimin e nivelit të pranisë së radikalizmit, veçanërisht radikalizmit religjioz në kuadër të manifestimit të radikalizmit politik dhe nivelit të rrezikshmërisë, mund ta përcaktojmë në prizmin e rrezikshmërisë reale të sigurisë, e aq më shumë ekzistencën e shoqërisë dhe pushtetit demokratik. Vetë perceptimi krijohet si rezultat i ndikimeve të jashtme të cilat mund të jenë rrezik real dhe ndjenjë pasigurie ose të krijojë iluzione të sigurisë në shoqëri me nivel të theksuar të rrezikshmërisë nga radikalizmi. Krijimi i iluzioneve paraqet pragmatizëm politik në aktivitetet e përditshme të radikalizmit politik të cilat mund të gjejnë qasje të ndryshme, në radhë të parë nëpërmjet përdorimit të medimeve. Në krijimin e nivelit të perceptimit të rrezikshmërisë në baza etnike dhe religjioze, si dhe në përdorimin e tyre për krijimin e platformës politike ekskluzive, veçanërisht ndikim të madh ka distanca sociale e ngritur në shoqëri. Kjo krijon masën kritike me përdorim afatgjatë nëse është negativ tek pjesëtarët e rinj të shoqërisë. Eliminimi i distancës së shprehur sociale realizohet me studime të përbashkëta dhe edukimit të të rinjve me prejardhje të ndryshme religjioze, etnike dhe kulturore. Nxitja e dallimeve sociale, bazuar në prejardhjen e ndryshme etnike, religjioze dhe kulturore krijon perceptimin e rrezikshmërisë dhe orienton ndaj mbështetjes së radikalizmit vetjak etnik dhe religjioz.

Mënyra e këtillë e qasjes në krijimin e iluzioneve të sigurisë dhe shkallës së ndikimit të radikalizmit religjioz në rrezikimin e sigurisë dhe krijimi i marrëdhënieve politike të brendshme dhe rajonale është e pranishme edhe në Republikën e Maqedonisë, që në kontekst të analizës sonë është evidente nga hulumtimi që e prezantojmë. Në prezantimin konkret të hulumtimit nuk bëhet fjalë për radikalizëm konkret politik në pragmatizmin politik në Maqedoni. Hulumtimi është një indikator i thjeshtë i raporteve të perceptimit për nivelin e rrezikut nga radikalizmi religjioz dhe politik në Republikën e Maqedonisë i shprehur tek qytetarët.

Në pjesën e dytë të hulumtimit e paraqesim analizën krahasuese të gjendjes në raport me dallimin e shprehur social tek studentët që ndikon në krijimin e perceptimit të tyre për rrezikshmëri. Njëkohësisht në bazë të këtyre rezultateve dhe indikatorëve hulumtues për perceptimin e nivelit të rrezikimit mund të formulojmë modelin e përdorimit të radikalizmit religjioz si mjet i radikalizmit politik.

Vështrim metodologjik ndaj hulumtimit

Të dhënat që janë prezantuar në këtë punim janë marrë në kuadër të një hulumtimi dy shtresor, i cili u bë në të njëjtën kohë në Republikën e Maqedonisë dhe në Republikën e Kroacisë si matje e qëndrimeve të studentëve të Kroacisë dhe studentëve të Maqedonisë. Në pjesën e dytë të këtij hulumtimi, u bë matja e perceptimit të nivelit të rrezikut tek qytetarët e Republikës së Maqedonisë në raport me radikalizmin religjioz. Me këtë rast rezultatet paraqesin segmentin e një hulumtimi më të gjerë.

Në pjesën e parë të hulumtimit u përfshinë gjithsej 400 studentë të Universitetit "Josip Juraj-Shtrosmajer" në Osiek dhe të Universitetit "Shën Cirili dhe Metodi" dhe Universiteti MIT në Shkup. Si pjesë e studentëve që studiojnë në Osiek, në kuadër të hulumtimit në terren, u përfshinë edhe studentë të shteteve të tjera të cilët gjendeshin në

momentin e hulumtimit si studentë të programit për shkëmbimin e studentëve "Erazmus", të cilët janë regjistruar nën grupin "të tjerë". Sipas të dhënave të kolegëve të Universitetit në Osiek, shumica e studentëve të shkëmbimit "Erazmus" ishin nga Polonia dhe Çekia, por edhe nga shtete të tjera evropiane. Në këtë hulumtim nuk u interesuam për numrin e saktë të studentëve të shteteve të tjera në radhë të parë sepse i përdorëm si grup kontrolli për korrektësi të përgjigjeve të studentëve nga Kroacia dhe Maqedonia.

Pjesa e dytë e hulumtimit përfshiu 400 qytetarë nga Republika e Maqedonisë. Të anketuarit e të dy grupeve u zgjedhën sipas zgjedhjes së rastit, ndërsa si instrument u përdor anketa si hulumtim sociologjik në terren në kuadër të së cilës u përdor edhe shkalla e Bogardit si disiplinë sociale. Hulumtimi u zhvillua në dy pjesë dhe është radhitur në aspektin kohor në dy pjesë: për studentët në muajin shkurt të vitit 2014, ndërsa për qytetarët në Republikën e Maqedonisë në muajin prill të 2014.

Në hulumtim morën pjesë kolegë nga Republika e Kroacisë, doc. dr. Vesna Stanković- Pejnoviq dhe mr. Sc. Lidija Getto¹⁷⁰, me bashkëpunimin e së cilëve i definuam edhe pyetjet e anketës dhe e zhvilluam hulumtimin në Osiek dhe të cilat dhanë komente interesante, veçanërisht në lidhje me nivelet divergjente evidente të dallimeve sociale ndërmjet studentëve të Kroacisë dhe shteteve të tjera me ato të studentëve maqedonas.

Në lidhje me variabilitetin e hulumtimit u përdorën nënshtetësitë e studentëve (jo përkatësia etnike, por shteti prej nga vijnë) me ç'rast u anketuan 186 studentë të Universiteteve të Republikës së Maqedonisë me ç'rast u veçuan dy grupe më të mëdha konfesionale (Ortodoksë dhe Myslimanë) ku kemi pasur një disbalanc të vogël, përkatësisht 30,2% Myslimanë dhe 68% ortodoks, si dhe 1,8% të anketuarit nga bashkësitë tjera fetare në Republikën e Maqedonisë.

¹⁷⁰ Doc. Dr. Vesna Stanković- Pejnoviq dhe mr. Lidija Getto, Universiteti "Josip Juraj -Shtrosmajer", Osiek.

Sipas ndarjes gjinore të të hulumtuarve 49% e tyre ishin meshkuj dhe 51% femra gjë që është përafërsisht strukturë normale gjinore në Republikën e Maqedonisë. Gjithsesi se exemplari i hulumtimit në lidhje me qytetarët e Republikës së Maqedonisë sipas nivelit arsimor ishte maksimalisht jo i stratifikuar dhe sipas zgjedhjes së rastit, prandaj dominuan të anketuar me shkollë të mesme, por arsimimi në këtë variabël nuk u mor parasysh në këtë hulumtim.

Analiza dhe komente të të dhënave të fituara nga hulumtimi

Një nga indikatorët më të rëndësishëm i cili mund të vë në dukje ekzistencën e masës kritike përkatëse për krijimin e kushteve për manifestimin e radikalizmit religjioz dhe përdorimim e mëvonshëm të tij në kuadër të radikalizmit politik, është distanca theksuar sociale tek të rinjtë nga përkatësia e ndryshme etnike, religjioze dhe kulturore.

Lidhshmërinë e përkatësisë nacionale dhe religjioze e imponuam në radhë të parë si rezultat i lidhshmërisë së identitetit nacional dhe religjioz, duke vënë me këtë rast barazinë e përafërt në raport me pranimin e dallimeve tek studentët që sjellë specifikat e tyre, të cilat hulumtohen edhe në dallimet kulturore dhe si rezultat i përkatësisë së ndryshme etnike dhe fetare.


Nëpërmjet pasqyrës së shkallës së distancës sociale tek studentët sipas shtetit të prejardhjes, ndërsa kjo në raport me komunikimin social me studentët të përkatësisë tjetër nacionale dhe religjioze është dhënë në përgjigjet për pyetjet që vijojnë:

A pajtoheni të punoni në projekte të përbashkëta me studentët të cilët janë me përkatësi tjetër nacionale dhe religjioze?

Përgjigjet e dhëna në kuadër të shkallës së Likertit me pesë përgjigje të mundshme të ofruara: Në tërësi pajtohem, Pajtohem, Krejt një,

Nuk pajtohem dhe Aspak nuk pajtohem, janë paraqitur në grafikonin numër 1.

Grafikoni nr. 1



Përgjigjet rreth pyetjes e cila ka të bëjë me pajtimin për pjesëmarrje në projekte të përbashkëta me studentë të përkatësisë tjetër nacionale dhe fetare paraqesin qëndrimin që ka të bëjë në një nivel shumë të ulët të distancës sociale në kuadër të relacioneve ndërmjet studentëve të të njëjtit universitet.

Vërehet se studentët nga Maqedonia në 12,2% nuk pajtohen ose aspak nuk pajtohen të punojnë në projekte të përbashkëta me studentë të përkatësisë tjetër nacionale ose fetare. Kjo përqindje tek studentët e shteteve të tjera është gjithashtu e lartë dhe atë 14,2%, por tek studentët kroat kemi nivelin e shprehur prej 0%. Në këtë kontekst nga ana tjetër me pajtim të plotë dhe pajtim janë 55,4% e studentëve kroat ose 71,4% tek studentët të shteteve të tjera dhe 70,1% tek studentët në Maqedoni. Në këtë nivel të distancës sociale sjellja indiferente është më e shprehur tek Maqedonasit me 17,1%, ndërsa mospërcaktimi më i vogël është tek studentët e shteteve të tjera me 14,3%.


Duke marrë parasysh rezultatet e hulumtimit mund të konstatojmë se në këtë nivel të komunikimit të përbashkët profesional tolerancë

më e madhe ekziston tek studentët e Kroacisë, ndërsa studentët nga Maqedonia dhe të shteteve të tjera paraqesin një përqindje të dukshme të mos tolerancës. Megjithatë, kjo përqindje e masës kritike të mos tolerancës paraqet substratin për krijimin e radikalizmit religjioz dhe nacional si vegël për radikalizmin politik.

Pyetja e dytë nëpërmjet të së cilës e përcaktuam distancën sociale ka të bëjë me shkallën më të lartë të komunikimit social, ndërsa në nivel të jetës së përbashkët gjatë studimeve.

A do të banonin në të njëjtën dhomë gjatë studimeve me studentë të cilët janë me përkatësi tjetër nacionale, religjioze dhe kulturore? Rezultatet e pyetjeve të kësaj përgjigje të prezantuara në kuadër të shkallës së Likertit me shkallë të pesë përgjigjeve të ofruara, mund të shihen në grafikonin nr. 2.

Grafikoni nr.2



Përgjigjet e marra janë karakteristike me indiferencën tek 41,5% e studentëve maqedonas, që është përafërsisht dyfish më shumë se sa tek studentët kroat dhe të shteteve të tjera. Gjithashtu, karakteristike janë mospajtimet dhe mospajtimet e tërësishme për të banuar bashkërisht me studentë të përkatësisë tjetër nacionale dhe religjioze tek studentët maqedonas me 26,8% ose ¼ e studentëve. Kjo përqindje tek studentët e Kroacisë është në

nivelin e 4,9 %, ndërsa tek studentët e shteteve të tjera është 0 %. I theksuar është dallimi edhe në pajtimin dhe pajtimin e plotë për jetesë në të njëjtën dhomë, me ç'rast 20,2 % e studentëve maqedonas pajtohen, ndërsa me këtë pajtohen 68,3% e studentëve kroat, dhe 71,4 % e studentëve të shteteve të tjera.


Mund të konkludojmë se indiferenca për jetë të përbashkët studentore me studentë të përkatësisë tjetër nacionale dhe religjioze është e shprehur tek të tre grupet e të anketuarve. Gjithashtu, vërehet se përqindja e lartë e studentëve maqedonas paraqesin mos tolerancë evidente, gjë që tregon se në Republikën e Maqedonisë ekziston masa kritike e të rinjve tek të cilët mund të bëhet ndikim në drejtim të përkrahjes së radikalizmit nacional dhe religjioz.

Në kuadër të nivelit të dytë të hulumtimit lidhur me perceptimin e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë për nivelin e rrezikimit të sigurisë nga radikalizmit religjioz mund të themi se bëhet fjalë për perceptim subjektiv të qytetarëve maqedonas, që njëkohësisht na tregon se si perceptohet për radikalizmin religjioz në korrelacion me përkatësinë etnike të të anketuarve.

Rezultate të hulumtimit për nivelin e rrezikimit në shkallë prej 0 deri 10 për numrin e përgjithshëm të të anketuarve është paraqitur në grafikonin nr.3.

Perceptimi në nivel të rrezikut ndaj sigurisë nga radikalizmi religjioz tek qytetarët e Republikës së Maqedonisë.

Grafikoni nr.3



Është e dukshme se të anketuarit me përkatësi fetare ortodokse nivelin e rrezikimit nga radikalizmi religjioz e vënë në gjysmën e sipërme të shkallës prej 0 deri në 10, përkatësisht 30,2 ose përafërsisht 1/3 e të anketuarve konsiderojnë se janë në një nivel mesatar ndërsa 10% konsiderojnë se vërehet nivel i lartë i rrezikimit. Në gjysmën e poshtme të shkallës janë përcaktuar gjithsej 34,2% e përgjigjeve. Tek të anketuarit me përkatësi fetare myslimane përgjigjet janë në nivele mesatare në shkallën me 44,4% ose 1/2 e të anketuarve të cilët konsiderojnë se radikalizmi religjioz në Republikën e Maqedonisë paraqet nivel të mesëm të rrezikimit të sigurisë. Është karakteristikë fakti se vetëm 11,1 % e të anketuarve mysliman kanë dhënë perceptim për nivel të lartë të rrezikut në pjesën e sipërme të shkallës, përkatësisht për nivelin më të lartë janë përgjigjur 0%. Si nivel të ulët të rrezikimit, radikalizmin religjioz e konsiderojnë 1/3 e të anketuarve mysliman.

Mund të konkludojmë se radikalizmi religjioz në Republikën e Maqedonisë perceptohet si rrezik me nivel të mesëm në shkallën prej 0 deri 10. Ky perceptim është i përgjithshëm por sipas përkatësisë religjioze të të anketuarve vëmendje tërheqin përgjigjet e të anketuarve mysliman të cilët radikalizmin religjioz nuk e perceptojnë

si shprehje rrezikimi ndaj sigurisë të Republikës së Maqedonisë dhe rrezikim të sigurisë personale dhe publike.

Pikërisht rezultatet e fituara nga ky segment i hulumtimit dhe krahasimi i tyre mund të na vënë në dukje ekzistimin e një mase kritike të rinjsh në Republikën e Maqedonisë të cilit për shkak të distancës së tyre të shprehur sociale mund të përdoren për të zbatuar mos tolerancën politike të mbështetur në identitetin religjioz. Në këtë drejtim edhe dallimi i perceptimit të nivelit të rrezikimit të sigurisë personale dhe publike nga radikalizmi religjioz në Republikën e Maqedonisë paraqet ndikimin e fuqishëm në krahasim me iluzionin e krijuar për sigurinë në raport me një rrezikim global bashkëkohor, dhe që lidhet me përkatësinë religjioze të të anketuarve. Kjo na çon në përfundim se ndaj perceptimit të rreziqeve dhe kanosjeve nga radikalizmi religjioz ndikon përkatësia religjioze të të anketuarve.

Shqyrtime përfundimtare nga zbatimi i hulumtimit

Manifestimi i radikalizmit të formave të ndryshme paraqet një indikator të fortë në relacionet bashkëkohore politike – të sigurisë në nivelin global. Në këtë kontekst edhe Republika e Maqedonisë nuk bënë përjashtim. Paraqitja e kombinuar e radikalizmit religjioz dhe politik, por edhe e atij etnik është shprehur fuqishëm në Republikën e Maqedonisë.

Nga të dhënat me të cilat erdhëm gjatë hulumtimit tonë me të cilat duam të vëmë në dukje në cilin nivel përdoret radikalizmi religjioz si mjet për realizimin e qëllimeve politike të shprehura nëpërmjet radikalizmit politik, erdhëm në përfundim se pikërisht koncepti i realizimit të qëllimeve politike dhe frustrimeve të përjetuara gjatë mosrealizimit të tyre e prodhojnë radikalizmin politik, i cili nga ana e vet, paraqet potencial shtytës për krijimin e llojeve të tjera të

radikalizmit. Me këtë rast është e pamohueshme se radikalizmi religjioz mund të jetë jashtëzakonisht mjet i fuqishëm. Kjo është karakteristike për Ballkanin si rajon, nëse kemi parasysh kryesisht se identitetet nacionale në fakt janë identitete religjioze, dhe kjo e shtonë potencialin për përdorimin e radikalizmit religjioz.

Nëpërmjet paraqitjes së perceptimit për nivelin deri ku radikalizmi religjioz paraqet faktorin rrezikues për sigurinë e Republikës së Maqedonisë në hulumtim bëme një analizë krahasuese me të dhënat e fituara hulumtuese dhe se si qytetarët e Republikës së Maqedonisë i perceptojnë ato, sipas nivelit të perceptimit të radikalizmit politik dhe religjioz. Duke u nisur nga ky perceptim u përqendruam në analizën dhe në krijimin e konceptit për perceptimin real për lidhshmërinë dhe ndikimin e tyre reciprok.

Në kombinim me të dhënat e hulumtimit dhe me analizën e tyre bëme një model nëpërmjet të cilit duhet qasur njohjes së rolit të radikalizmit religjioz si mjet i radikalizmit politik.

Biografite e pjesëmarrësve në projekt



Doc. Dr. Ivanka Dodovska ligjeron në Fakultetin Juridik "Justiniani i Parë", në Universitetin "Shën Cirili dhe Metodi" në Shkup, në studimet politike dhe studimet për gazetari. Ajo është ligjëruese për lëndët: Historia bashkëkohore maqedonase dhe evropiane (Shekulli XIX- XX), historia e diplomacisë, historia e shteteve të Ballkanit, lëvizjet religjioze në Evropën Juglindore dhe statusi i jo myslimanëve në shoqërinë Osmane. Është autore e nja 30 punimeve shkencore dhe profesionale të botuara në revista dhe buletine te vendit dhe të huaja. Është anëtare e Këshillit redaktorial të revistës elektronike – Buletini i punimeve, në edicion të Forumit politik maqedonas, Shkup.



Ivan Ivanov është lindur më 20.09.1991 në Shkup. Në vitin 2013 ka diplomuar në Fakultetin Juridik "Justiniani i parë" në Shkup në studimet politike. Aktualisht është magjistrant në master studime të Fakultetit Juridik në Shkup në drejtimin e politikës aplikative. Ai është njëri nga themeluesit e Institutit për zhvillim civil dhe analiza politike "ResPublika", qëllimi parësor i së cilës është përparimi i shoqërisë civile. Nga themelimi i Institutit deri tani, ka marrë pjesë në organizimin e shumë panel-dikutimeve nga të cilët si projekt më i rëndësishëm deri tani është "Muaji i Shoqërisë Civile". Në vitin 2013 është zgjedh për anëtar të Këshillit drejtues të Institutit "Konfuçi" në Shkup. Aktualisht punon në projekte lidhur me sfidat e shoqërisë civile në botën bashkëkohore.



Stanislav Cvetkovski është lindur më 21.01.1985 në Shkup, Republika e Maqedonisë. Ka diplomuar në Fakultetin Juridik "Justiniani i parë" në Universitetin "Shën Cirili dhe Metodi", në Shkup, në drejtimin e studimeve politike në vitin 2007. Aktualisht është magjistrant në ciklin e dytë të studimeve – Master studime të studimeve politike - moduli Politika aplikative në Fakultetin Juridik "Justiniani i parë" në Universitetin "Shën Cirili dhe Metodi", në Shkup. Nga viti 2009 është punësuar në Ambasadën e Republikës së Sllovakisë në Shkup.



Sara Al-Bander është lindur më 26.04.1992 në Shkup. Politikologe e diplomuar në studimet politike në Fakultetin Juridik "Justiniani i parë". Është anëtare e Institutit për zhvillim civil dhe analiza politike "ResPublika" si pjesë e Fakultetit juridik. Në vitin 2013 punon në projektin "Civil Lyceum – Muaji i Shoqërisë Civile", i cili u realizua në bashkëpunim me ambasadën e SHBA në Shkup.



Martin Buzallkovski është lindur më 11.03.1992 në Shkup. Është apsolvent në Fakultetin juridik "Justiniani i parë" në studimet e shkencave politike. Themelues dhe anëtar i Institutit për zhvillime civile dhe analiza politike "ResPublika" si pjesë e Fakultetit juridik. Në vitin 2013 punoi në projektin e quajtur "Civil Lyceum- Muaji i Shoqërisë Civile", i cili u realizua në

bashkëpunim më ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shkup. Përveç kësaj ka punuar edhe në projekte më të vogla siç janë: Fjalët e trupit, Hyrje në politikën kineze, si dhe në krijimin e disa filmave dokumentar për nevojat e katedrës së shkencave politike.



Mr. Ivana Atanasovska është lundur më 27.03.1987 në Shkup. Diplomoi në Fakultetin Juridik "Justiniani i parë" në Shkup, në studimet politike. Titullin e magjistratit të shkencave politike e fitoi pasi mbrojti me sukses punimin e magjistraturës me titull: Raoul Girardes's Myth of Conspiracy Theory in forming national identities: is it applicable to the Macedonian case?" në Fakultetin juridik "Justiniani i parë", në vitin 2013. Që nga filmi i studimeve është përfshirë aktivisht në sektorin OJQ edhe përkundër aktiviteteve të shumta në këtë sferë, ajo ka qenë kryetare e Shkollës për liderë të presidentit Ivanov dhe kordinatore për marrëdhënie me publikun në kuadër të Forumit politikolog Maqedonas (FPM). Përvoja e saj e rëndësishme në kuadër të sektorit civil është vërejtur edhe nëpërmjet pjesmarrjes së saj në një numër të madh seminaresh, tryezash, simpoziumesh, konferencash akademike nacionale dhe nderkombëtare.



Liljana Ljzarevska lindi më 14.02.1989 në Shkup. Diplomoi në studimet politike në Fakultetin Juridik "Justinian i parë" në vitin 2011, ndërsa aktualisht është magjistrante në Fakultetin ekonomik në Shkup. Punon në Qendrën Memoriale të Holokaustit të Ebrenjve të Maqedonisë si bashkëpunëtoresh shkencore.



Katerina Neshkova, gazetare në "Dnevnik" është lindur në vitin 1982 në Shkup, ku jeton edhe sot. Neshkova ka një përvojë pune dhjetëvjeçare si gazetare dhe redaktore në disa medime të shkruara në Maqedoni: e përditshmja "Vreme", javorja "Forum", gazeta "Nova Makedonija", dhe së fundi në gazetën "Dnevnik". Ishte redaktore në portalin informativ mjaft të suksesshëm të parë "forum.com.mk". Si gazetare më shumë punon në tema të skenës së politikës së brendshme, por ka edhe disa përvoja në sektorët e shëndetësisë dhe politikës së jashtme. Neshkova është juriste e diplomuar me provimin e dhënë të jurisprudencës dhe në studime posdiplomike në Katedrën e të drejtës ndërkombëtare dhe politikës ndërkombëtare të Fakultetit Juridik "Justiniani i parë"-Shkup. Si juriste ka punuar në Gjyqin themelor Shkupi 2 në Shkup dhe në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë.



Mr. Marjan Vučković është lindur në Manastir në vitin 1988, ku e kreu shkollën fillore dhe arsimin e mesëm. Në vitin 2007 u regjistrua në studimet politike në Fakultetin juridik "Justiniani i parë" në Shkup ku magistroi në lëmin e menaxhmentit politik dhe shoqërisë civile. Nga viti 2009 është Kryetar i Forumit Politikologjik Maqedonas dhe ka botuar shumë punime në e-buletinin të punimeve.



Xhenur Iseini është lindur në Kumanovë në vitin 1989, ku e kreu shkollën fillore dhe të mesme. Në vitin 2007 u regjistrua në studimet politike në Fakultetin Juridik "Justiniani i parë" në Shkup ku momentalisht është magjistrat në master studimet për "Diplomaci dhe Marrëdhënie ndërkombëtare" në Fakultetin Juridik "Justiniani i parë"- Shkup. Është anëtar i Këshillit ekzekutiv të Forumit Politikologjik Maqedonas.



Doc.dr. Oliver Andonov është lindur në vitin 1971 në Shkup. Diplomoi në Universitetin "Shën Cirili dhe Metodi" në Shkup në fakultetin filozofik në Institutin e studimeve mbrojtëse, të sigurisë dhe paqes, ku bëri magjistraturën dhe doktoroi në drejtimin Paqja dhe zhvillimi. Punon në Universitetin MIT në Fakultetin e sigurisë, kriminologjisë dhe kontrollit financiar dhe njëkohësisht është drejtues i kancelarisë të Erazmus dhe të bashkëpunimit ndërkombëtar të universitetit. Është ligjërues i lëndëve: siguria nacionale, politika e sigurisë, zgjidhja e konflikteve, teoria e paqes dhe konflikteve dhe intelogjenca kriminale. Fusha themelore e interesimit të tij është studimi i konflikteve, rreziqeve dhe kanosjeve ndaj sigurisë dhe zbatimi i politikës së sigurisë. Në punën e tij shkencore ka botuar dy libra, "Paralajmërime të hershme –përvojat e BE-së dhe RM-së" dhe "Bazat e inteligjencës kriminale dhe analiza", si dhe shumë punime të tjera.

Biographies of the project participants



Ivanka Dodovska, PhD, is assistant professor at the Faculty of Law "Iustinianus Primus", University "Ss. Cyril and Methodius" in Skopje, at the Political studies and the Studies of Journalism. She teaches the following subjects: Contemporary European and Macedonian History (XIX – XX century), History of Diplomacy, Political History of the Balkans, Religious Movements in Southeast Europe and the Status of the non-Muslims in the Ottoman Society. She is the author of more than 30 international papers published in national and international journals and textbooks. She is a member of the editorial board of the electronic journal – Proceedings, published by Macedonian Political forum - Skopje.



Ivan Ivanov is born on 09.2.1991 in Skopje. In 2013 he graduated in Political Sciences, at the Faculty of Law "Iustinianus Primus" in Skopje. Currently he is on postgraduate master studies at the Faculty of Law "Iustinianus Primus" in Skopje - Applied Policy. He is a founding member of the Institution of Civil development and analysis "Respublika", whose primary purpose is to promote civil society. Since the establishment of the institute to the present, he has participated in organizing several panel discussions, including the most important project so far "Month of Civil Society." In 2013 he was elected to the board of the Institute "Confucius" in Skopje. Currently, he works on projects related to the challenges of civil society in the modern world.



Stanislav Cvetkovski is born on 21.01.1985 in Skopje, Republic of Macedonia. He graduated at the Faculty of Law "Iustinianus Primus" at the "St. Cyril and Methodius" University in Skopje at the Department of political science in 2007. Currently, he is a postgraduate student at the Department for Political Science – Applied Politics. Since 2009 he has been working at the Embassy of the Republic of Slovakia in Skopje.



Sara Al-Bander is born on 26.04.1992 in Skopje. At the Faculty of Law "Iustinianus Primus" in Skopje she received her bachelor degree in Political Sciences. She is a member of "Respublika - Institute for Civil Development and Political Analysis" as part of the Law School. In 2013 she worked on a project called "Civil Lyceum - Month of Civil Society", realized in collaboration with the Embassy of the United States in Skopje.



Martin Buzalkovski was born on 11.03.1992 in Skopje. He is a student of Political Science at the Faculty of Law "Iustinianus Primus" in Skopje. Founder and member of the Institute for Civil Development and Political Analysis "Respublika" within the faculty. In 2013 he worked on a project called "Civil Lyceum – Month of Civil Society" realized in collaboration

with the embassy of the United States of America in Skopje. He has also worked on smaller projects like: Body Language, Introduction to Chinese Politics, as well as the making of a couple documentaries for the needs of the Department of Political Science.



Ivana Atanasoska, MA in Political Science, was born on 27.03.1987 in Skopje. She holds a Bachelor's degree in Political Science attained at the Faculty of Law "Iustinianus Primus"-Skopje. She has also received a masters degree in Political Science at the Faculty of Law "Iustinianus Primus'-Skopje; her thesis was titled "Raoul Girardet's Myth of Conspiracy Theory in Forming National Identities: Is It Applicable to the Macedonian Case?" She has been active in the NGO sector during the past decade, and among other activities, she served as a President of Ivanov's School of Leaders Alumni Association and Public Relations coordinator for the Macedonian Political Science Forum (MPF). Her significant experience in the NGO sector can be shown through her active participation in organizing as well as attending many national and international events such as seminars, trainings, workshops, academic conferences etc.



Liliana Lazarevska was born on 14 February, 1989 in Skopje, Republic of Macedonia, and has received a bachelor's degree in Political Sciences on the "Sts. Cyril and Methodius" University – the Faculty of Law "Iustinianus Primus" in 2011. Currently, she is a student at master studies on the Faculty of Economics at the same University. She works in the Holocaust Memorial Center for the Jews of Macedonia as a research associate.



Katerina Neskova was born in 1981 in Skopje where she lives. She works as a journalist in the daily newspaper "Dnevnik". Neskova has a long experience working as a journalist and as an editor in a couple of Macedonian media: the daily newspapers "Vreme" and "Nova Makedonija", as well as the weekly magazine "Forum". She was also the editor of one of the first successful web portals "forum.com.mk". As a journalist, she works mostly on internal politics, as well as the health and foreign policy

sectors. Neskova has graduated in law and currently she is a postgraduate student of international law and politics at the Law Faculty "Iustinianus Primus" in Skopje. She has a certain working experience in the Primary Court in Skopje and as well as in the Macedonian Parliament.



Marjan Vuchkovikj, M.Sc. was born in 1988 in Bitola. In 2007 he enrolled the Law Faculty "Iustinianus Primus" in Skopje, the Department of Political Sciences. In 2009 he was elected for a President of the Macedonian Political Science Forum. In 2010 he enrolled master studies in the field of Civil Society and Management of Interethnic Relations.



Djenur Iseni, B.A was born in 1989 in Kumanovo. In 2007 he enrolled the Law Faculty "Iustinianus Primus" in Skopje, Department of Political Sciences. Since 2009 he has been a member of the executive board of the Macedonian Political Science Forum. In 2012 he enrolled master studies in the field of Diplomacy and International Relations.



Doc. d-r Oliver Andonov was born in 1971 in Skopje. He earned his BA degree from the Institute of Defense at the Faculty of Philosophy, the University of "Ss. Cyril and Methodius" in Skopje. He works at the MIT University in Skopje, Faculty for Security, Criminology and Financial Control and at the same time he is in charge of the Erasmus program and the international collaboration at the university. He teaches the following subjects: National Security, Defense Politics, Conflict Resolution, Theories of Peace and Conflicts, and Criminal intelligence. His primary field of interest is the study of conflicts, defense risks and threats and the implementation of defense politics. He is the author of two published books: Early-warning - the Experiences of the EU and the Republic of Macedonia and Basics of the Criminal Intelligence and Analysis, as well as a large number of other writings.

FRAGMENTE NGA RECENSIONET

...Projekti "Krizat e botës moderne (sfidat rajonale dhe globale të demokracisë liberale kundrejt fundamentalizmit religjioz)", ka karakteristika të një raporti shkencor (studim shkencor). Këtë karakteristikë, kjo vepër e fiton me qasjen e autorëve drejt përpunimit të problemeve që janë temë e interesit të tyre shkencor: kërcënimeve ndaj njerëzimit. Qasjen metodologjike që e kanë zgjedhur dhe të cilën e zbatojnë po karakterizohet me një qasje shumë aspektesh ndaj të gjitha çështjeve, që e përbëjnë esencën e veprës... Në kushtet bashkëkohore të zhvillimit organizativ, të konceptit dominues për garantimin dhe krijimin e kushteve për një realizim konsekuent të të drejtave dhe lirive të garantuara të qytetarëve përmes funksionimit të shtetit ligjor (shteti i sundimit të të drejtës) përcaktohet edhe vendi i organeve që i njohin krizat dhe angazhimin e bashkësisë shoqërore si kategori politike, juridike, sociale, ekonomike dhe socio-kulturore në funksion të zvogëlimit të ndikimit të tyre në konotacionin negativ...

Doc. D-r Lupço Todorovski
Prof. D-r Zllate Dimovski

...Projekti akademik i titulluar si "Krizat e botës moderne (sfidat rajonale dhe globale të demokracisë liberale kundrejt fundamentalizmit religjioz)", redaktuar nga d-r Ivana Dodovska, paraqet një mësim shumë i rëndësishëm në fushën e studimeve politike dhe të sigurisë. Në këtë projekt janë dhënë shtatë pikëpamje të rëndësishme në lidhje me temën qendrore, të punuara nga ana e gjeneratës më të re të politikologëve në Republikën e Maqedonisë, të cilit tregojnë konstatimin se shkencat politike që studjohen në Fakultetin Juridik "Justiniani i Parë" në Universitetin "Shën Cirili dhe Metodi" në Shkup, paraqesin një bazë e vërtet për zhvillimin dhe mbindërtimin e kuadrove solide që në mënyrë të përgatitur dhe profesionale punojnë në fushën shkencore...

Prof. D-r Zoran Ilievski

...Publikimi e reflekton klimën politike të Ballkanit dhe lëvizjet e reja ndikimi i të cilave është komplekse dhe njëherit e jep përgjigjen e demokracive të reja në aspektin e këtyre sfidave. Për këto arsye ky publikim është unikal për nga percepticioni i vetë në lidhje me këto dukuri dhe aspektet që i merr si pikë nisëse për analizën politike, religjioze dhe juridike. I njëjti na ofron një opinion shumë të qëndrueshëm për gjendjen aktuale dhe njëherit një parashikim shumë realist të zhvillimeve të mëtejshme të kësaj gjendjeje në Ballkan në kontekstin e zhvillimit të demokracisë dhe të drejtave të njeriut...

Prof. D-r Bistra Netkova

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент
Охридски", Скопје

321.7:[2:323.12

KRIZAT e botës modernr : sfidat rajonale dhe globale të demokracisë liberale kundrejt fundamentalizmit religjioz / [redaktore e botimit Ivanka Dodovska ; pjesëmarrësit në projekt Ivan Ivanov ... и др.]. - Shkup : Fondacioni Konrad Adenauer, 2014. - 129 стр. : илустр. ; 21 см

Фусноти кон текстот. - Биографитë e pjesëmarrësve në проект ;
Biographies of the project participants: стр. 120-129. - Abstract
кон трудовите

ISBN 978-608-4648-16-1

а) Демократски општества - Фундаментализам б) Демократија
- Шовинизам - Споредбени аспекти

COBISS.MK-ID 97747722

